

Mars 2013
Numri: 60
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den

ETIKA



LUKMANI (A.S.)
OSMAN NURI TOPBASH



FILLIMI I MUAJVE
HENORË
MUHAMED EL-GAZALI



MUHAMEDI (A.S.)
ALTIN TORBA



ALIJA IZZETBEGOVIÇ
SI DUHET TA
LEXOJMË KURANIN?



IDHUJT
E KOHËVE MODERNE
NUREDIN NAZARKO



PROF. DR. HASAN K. JËLLMAZ
SI ARRIVET XHENETI?

XHËNËHU Xhenet

ISSN 2227-3611



03

9 772227 361004

Njeriu është një udhëtar mes dy xheneteve. Qëllimi është të gjehet pikëprerja e këtyre dy skajeve: "Siratul mustekim", Rruga e drejtë që në fakt është një urë mes këtyre dy xheneteve. Pra çështja është: A do të arrijë njeriu ta përfundojë në xhenet udhëtimin e tij? Atë udhëtim që ka nisur prej xhenetit. Sepse gjatë këtij udhëtimi njeriu ndeshet me një sërë rrugicash qorre e të shtrembëra, që i fsheh hija joshëse e dynjasë, e fundi i të cilave është xhehenemi...

...vetëm "Fjala" e vesh njeriun... Fjala e Zotit i jep njeriut vendin që meriton dhe i takon. Prandaj, braktisja e fjalës të shpie në fundosje brenda baltovinës së harresës. Mysliman është njeriu që i vlerëson fjalët e Zotit, kur gjendet në shtëpi, në arë, në fshat, në qytet..., mysliman është njeriu te i cili "Fjala" gjen përjetimin e saj të vërtetë. A nuk është Fjala e Allahut sekreti i ekzistencës sonë?

Zoti foli me njeriun në *botën e shpirtërave* dhe pas këtij bashkëbisedimi, njeriu u krijua me mish dhe me kocka. Zoti e pyeti njeriun rreth emrave të sendeve dhe pastaj e vendosi atë në xhenet. Pastaj ngjau ajo që ngjau. Nisi udhëtimi në vendin e provës, që ndryshe quhet, dynja. Zoti foli sërish me njeriun nëpërmjet të dërguarve. Ai i foli njeriut edhe nëpërmjet shenjave të tjera, nëpërmjet bletës, vesës, reve, flokëve të borës... pra Zoti bashkëbisedon me ne në çdo moment. Mjafton

që njeriu t'ua vërë veshin shenjave të Tij dhe t'i dëgjojë ato pa bërë zë. Zoti na urdhëron të dëgjojmë dhe të heshtim kur Ai flet, sepse vetëm ata që dëgjojnë dhe heshtin, kanë për t'u mëshiruar prej Zotit. **"Kur të lexohet Kurani, dëgjojeni dhe ndërprisni çdo bisedë! Vetëm këshu mund të fitoni mëshirën e Zotit!"** (Araf, 204.) Siç shihet, më parë njeriu ftohet të dëgjojë dhe më pas të heshtë, sepse vetëm ata që dëgjojnë për të mësuar diçka, nuk flasin. Njeriu nuk mundet që, në të njëjtën kohë edhe të dëgjojë edhe të flasë. Nëse ai bën këtë, atëherë nuk bën tjetër përveç se bie në kundërshtim me vetveten.

...njeriu modern bën shumë zhurmë, sepse beson në hegjemoninë dhe pushtetin e saj. Ai përpiqet të qëndrojë larg fjalës së Zotit në shtëpi, në shkollë, në treg..., duke folur në tym. Ai pandeh se gënjeshtria do të konsiderohet e vërtetë, sa më shumë zhurmë të krijohet rreth saj mendon se do të arrijë hegjemoninë e zhurmës që krijon. Porse "e gabuara nuk bëhet e saktë" me forcë. **"Ajo që e bën fjalën të fortë dhe të saktë, nuk është fakti se sa i lartë është zëri, por cilësia e saj."** E vërteta nuk zhduket dhe nuk humbet për shkak të mospërfilljes. Mosmbajtja e fjalës së dhënë, nuk është në dëm të fjalës, por të njeriut që e ka dhënë atë fjalë. Njeriu i edukuar në mësonjëtores e sekularizmit duke braktisur sot "Fjalën", nuk ka braktisur vetëm të kaluarën, por edhe të ardhmen.

Mars 2013

VITI: VII
NUMRI: 60

BOTUESI
Shtëpia botuese Progresi

DREJTOR
Alban Kali

KRYERADAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

KORREKTORE
Dr. Irida Hoti

PËRKTHYES
Albert Halili
Arjan Ymeraj
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
L: Vasil Shanto; Rr: Çajupi
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 208 6767

E-MAIL
revistaetika@progresibotime.com

WEBSITE
www.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese Progresi ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja



Dr. Kemir Bulladë
Aktualizimi i namazit, hetim rreth ndërgjegjes sociale

18



8

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz
Si arrihet xheneti?



Osman Nuri Topbash
Lukmani (a.s.)

34



10



26

Alija Izzetbegović
Si duhet ta lexojmë Kurandin?

- 5 Ahmet Tashgetiren
Rruga për në xhenet
- 10 Altin Torba
Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!)
- 13 Muhamed El-Gazali
Fillimi i muajve hënorë
- 14 Nuredin Nazarko
Idhujt e kohëve moderne
- 16 Prof. dr. M. Jashar Kandemir
Besimi në Allahun
- 20 Osman Sëkëxhë
Fjala dhe dëgjimi
- 22 Dr. Murat Kaja
Veprat që të shpien në xhenet
- 28 Zybejir Jetik
Shehadet do të thotë Aksion
- 30 Sadik Dana
Të duash



48

Një Ajet - Një Hadith 32

Edison Çeraj 44

Mbi ligjërimin politik

Idris Arpat 48

Tehexhudi, namazi i natës

Xhafer Durmush 50

Ngrihu dhe paralajmëro

Librari Progresi 52

Vargu i profetëve

Ferid Piku 54

Besimi në Zot, burim shprese

Dr. Mustafa Ullusoj 57

Motivi i ekzistencës së njeriut

Zani i s'kaluemes 58

Martesa asht ma i vërteti sigurim në botë

Shëndet 60

Zbulohet ana e errët e trurit



Teknologji 61

Telefoni transparent në fund të vitit 2013

40

Musa K. Jëllmaz

Qytetërimi i dashurisë dhe tolerancës



13

Rruga për në XHENET

Ahmet Tashgetiren

Jeta është një udhëtim. Njeriu e fillon atë qysh me lindjen. Vjen në këtë botë, nuk qëndron këtu përgjithmonë dhe ecën drejt fundit. Jeta jetohet, shijohet e konsumohet. Çdo hap që hedhim na çon drejt fundit.

E vërteta është jeta e botës së përjetshme. Periudha e jetës së kësaj bote, nuk është gjë tjetër veçse përgatitje për tjetrën. Çështja e parë që duhet të kuptojë njeriu, është përkohshmëria e tij në këtë botë dhe lidhja e saj me botën e përjetshme.

Rëndësia e përgatitjes, përmbledhet në pikën se çdo gjë që bëhet në këtë botë, ka një kuptim për tjetrën. Atë ditë, kur të mbarojë rrugëtimi në këtë botë, do të na hapet dera e përjetësisë dhe qëndrimi ynë atje do të lidhet drejtpërdrejt me mënyrën se si ne jetuam.

Jeta e përjetshme ndahet në... botën e lumturisë dhe botën e humbjes... Në zjarr ose kopsht me trëndafila... Jo më kot është thënë: "Njeriu e sheh Xhenetin dhe Xhehenemin që në këtë botë".

Ai që ecën drejt Xhenetit në këtë botë, do ta gjejë atë. Por ai që ecën përmes Xhehenemit në këtë botë, në botën e përjetshme rruga e tij do të ndalë atje.

Atëherë, le të udhëtojmë drejt Xhenetit që në këtë botë... Le të ndërtojmë Xhenete këtu... Le të jetojmë në Xhenet sa jemi në kohë...

Çdo veprim i njeriut në këtë botë, nënkupton vendosjen e një tulle në vendbanimin e tij të ardhshëm, në Xhenet ose në Xhehenem. Kjo do të thotë se mënyra e jetesës në këtë botë, është një lloj "mjeshtërie" Xheneti ose Xhehenemi. Prandaj, maturia është çelësi i së ardhmes.

Kaktimin dhe vlerësimin e sjelljeve të njeriut, e bën vetë Krijuesi. Ai përcakton etikën e sjelljeve që na shpien në Xhenet ose në Xhehenem... sepse edhe rregulli i kësaj bote,





edhe ai i botës tjetër varen prej Tij... Edhe aventurën ardhje-vajtje midis dy botëve, e ka organizuar Ai. Allahu e ka krijuar edhe jetën edhe vdekjen me qëllim që të dalë në pah sjellja e njeriut në sprovën e veprave.

Njeriu nuk ka të drejtë zgjedhjeje as në lindje e as në vdekje. E drejta e zgjedhjes fillon dhe mbaron, mes këtyre dy ngjarjeve të mëdha. Janë vënë disa kritere, ato për udhëtimin në Xhenet dhe ato për në Xhehenem. Zgjidh kë të duash...

MOS U BËJ I SHKUJDESUR...

Mos humb kohë me pyetjet nëse do të ndodhin me të vërtetë këto apo jo! Mos e turbullo mendjen. Ti ke ardhur dhe po i sheh ata që po ikin. A mund të jenë të pakuptimta ardhja jote dhe këto ikje? Fuqia që të ka nisur, të ka njoftuar edhe pse të ka sjellë, edhe pse do të të marrë përsëri, edhe fundin me të cilin do të përballesh në vendin ku do të shkosh së shpejti...

DËGJOJE ME VËMENDJE ATË!

Kurani është udhëzuesi kryesor, libri i Allahut dhe korniza e parimeve hyjnore... Profeti (a.s.), është Udhëzuesi, i cili e bën njerëzore këtë kornizë parimesh në dobi të njeriut, e konkretizon atë dhe lehtëson vënien e tyre në jetë... Dhe kjo që njeriuun të mos e zërë paniku dhe të habitet me pyetjet: Si vihen në jetë këto parime? Si gjendet rruga e Xhenetit?.. Allahu Teala ka dërguar një Njeri si prijës. Ai do të presë tek dera e Xhenetit. Ai do të jetë edhe

në krye të burimit të Keutherit. Dhe kush ecën duke marrë shembull këtë prijës, është në rrugën drejt Xhenetit. Kush ecën duke ia shtrirë dorën atij, duke shkëlur në gjurmët e tij, me zemër të lidhur pas tij dhe i shkrirë me të, do të takohet me Profetin tek dera e Xhenetit...

Allahu është Rrahim (i Mëshirshëm)

Allahu është Rauf (i Dhembshur, i Butë)

Allahu është Uedud (i Dashur)

Allahu është Gafur (Falës)

Allahu është Hadi (Udhëzues në rrugën e vërtetë)

Allahu nuk e lë pas dore atë që krijon.

Mëshira e Tij e pafundme, vë një prijës si "Mëshirë" në krye të njerëzimit...

Pastaj i thërret njerëzit:

"Vraponi për në Xhenet"...

Ja, shikoni! Ky ajet paraqet thirrjen e Krijuesit **"Vraponi për në Xhenet"** dhe vendos para njeriut modelet e sjelljes si shenja të rrugës për atje...

"O besimtarë! Mos pranoni kamatë të shumëfishtë mbi kamatë! Kijeni frikë Allahun, që të shpëtoni dhe ruajuni zjarrit, i cili është përgatitur për jobesimtarët! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, për të shpresuar mëshirën e Allahut). Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.

Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre - e kush i fal gjynahet përveç Allahut? - dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë, pra, për këta do të ketë si shpërblim falje madhështore (të gjynaheve) nga ana e Zotit të tyre dhe kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë. Sa shpërblim i bukur është ky për ata që punojnë (vepra të bukura)!" (Al'Imran, 130-136.)

Mos e kundërshto Allahun, mos e ha kamatën, mos shko në kufër (mohim), dhuro nga ajo që të ka dhuruar Allahu, përmbaje zemërimin, fali njerëzit, bëju mirë atyre, bëhu njeri i mirë, mos bëj vepra të shëm-

tuara, mos i bëj padrejtësi askujt, madje as vetvetes, përkujto Allahun dhe mos këmbëngul në gjynah. Dhe mijëra parime të tjera jetësore si këto...

Pra, duke u bazuar në këto parime, organizoje zemrën, mendjen dhe gjymtyrët e tua për në Xhenet. (Këto parime janë përmbledhur vetëm në 6 ajete. Por i gjithë Kurani është një udhëzues i vërtetë i rrugës për në Xhenet.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka qëndruar gjithmonë në krye të njerëzve si një udhëzues Xheneti... Njerëzit shkonin tek ai dhe i thoshin: **"Më thuaj një vepër e cila do të më çojë drejt e në Xhenet!"**

Ndonjëherë, i pyeste vetë: **"A t'ju tregoj një vepër që nëse e bëni do t'ju çojë në Xhenet?"**

Edhe pse Islami është një "Udhëzues Xheneti" që i është paraqitur i plotë njeriut, i Dërguari i Allahut, nëse mund të shprehemi kështu, ka nënvizuar disa sjellje dhe veprime.

Duke i treguar udhëzimin për në Xhenet, ai e ka këshilluar kështu një beduin:

"Të adhurosh Allahun pa i shoqëruar asnjë ortak. Të falësh namazet farz. Të japësh zekatin dhe të agjërosh Ramazanin."

- Nuk do të bëj as më shumë dhe as më pak..., tha beduini dhe iku.

Duke e parë të largohej, i Dërguari i Allahut (a.s.), u tha të pranishmëve: *"Nëse doni të shihni një banor të Xhenetit, shiheni atë njeri"*.

Sa formulë e thjeshtë, apo jo? Vendose marrëdhënien me Zotin tënd në një pozitë të sigurt, drejtohu për nga Xheneti, pra mos u largo nga vetëdija për botën tjetër, pastaj, ty do të të mjaftojnë si devotshmëri namazi, agjërimi dhe zekati... Sa hartë e thjeshtë për në rrugën e Xhenetit...

"Nëse nuk besoni, nuk mund të hyni në Xhenet. Nëse nuk e doni njëri-tjetrin nuk keni besuar me të vërtetë", ka thënë i Dërguari i Allahut (a.s.)... Ai e ka lidhur udhëtimin për në Xhenet me dashurinë për njëri-tjetrin.

Dikush përgatitet për në Xhenet duke u bërë prijës i drejtë, dikush duke qenë i mëshirshëm dhe zemërbutë me të afërmit dhe myslimanët, ndërsa dikush tjetër duke u ruajtur nga harami dhe duke mos i kërkuar gjë askujt edhe pse është i varfër dhe

nevojtar...

Për të gjetur rrugën e drejtë të Xhenetit, janë vënë disa shenja "rrugore":

Të kesh kujdes gjurmët që ndjek dhe të ruhesh nga ndjekja e gjurmëve të shejtanit.

Arsyeja: **"Ai është armiku juaj i hapët."** (el-Bekare, 168.)

Atëherë: **"O besimtarë! Mos ndiqni gjurmët e shejtanit! Kush ndjek gjurmët e shejtanit, do të nxitet nga ai të bëjë vepra të këqija e të shëmtuara..."** (en-Nur, 21.)

Po, nëse ecën dorë për dorë me shejtanin duke shkelur në gjurmët e tij, duke qëndruar në një hap me të dhe duke hyrë në krah të tij, në fund të asaj rruge, padyshim që gjendet humbja e përvetshme.

Kurani është i mbushur plot me ajete që e paralajmërojnë njeriun në lidhje me shejtanin. Shejtani ia zbukuron njeriut veprimet e mbrapshta... Sa bashku dhëtar i keq është ai. Mos e bëj ortak shejtanin në pasurinë, shtëpinë dhe fëmijët e tu! Kape përdore Rasulallahun (a.s.), përqafoje Kurandin, qëndro afër me robërit e mirë të Allahut dhe lidhe zemrën tënde me ta.

Shtëpinë, vendin e punës, rrugicat, shkollat dhe zemrën tënde pajise me atmosferën e Xhenetit dhe

jeto së bashku me familjen tënde në këtë atmosferë. Ngarkoje Xhenetin mbi supet dhe merre me vete kur të shkosh...

Allahu na e priftë mbarë udhën për në Xhenet!...

"Nëse nuk besoni, nuk mund të hyni në Xhenet. Nëse nuk e doni njëri-tjetrin nuk keni besuar me të vërtetë."



Si arri Xhenet

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Njeriu është një udhëtar që ka ardhur nga Allahu për t'u rikthyer përsëri tek Ai. Ademi (a.s.) u krijua në Xhenet dhe u vendos po aty për të jetuar së bashku me bashkëshorten.

Ndërsa Allahu i vendosi në Xhenet, i porositi: **"O Adem, ti dhe gruaja jote jetoni në Xhenet dhe aty hani sa të doni e kur të doni, por mos iu afroni kësaj peme, se ndryshe do të bëheni të padrejtë"**. (Bekare, 35) Ademi dhe Havaja pasi hëgrën nga pema e ndaluar u zbritën pikërisht në tokë për një qëllim të caktuar hyjnor.

Destinacioni përfundimtar i njeriut është Ahireti dhe nëse përmes besimit e veprave të mira fiton mëshirën e Allahut, vendi i tij në Ahiret do të jetë Xheneti. Mevlana e përshkruan kështu fuqinë dhe forcën e Ademit në Xhenet dhe zbritjen e tij në tokë:

"Ademi ndërsa ishte në Xhenet, ishte i fuqishëm sa një luan, kur ra në kurthin e shejtanit dhe u vendos në këtë botë, u ndje si një pjesë e shkëputur prej trupit mëmë. Kaderi e lëshoi në kthetrat e maceve. Macet tani janë shndëruar në copa mishi që e tërheqin luanin sa nga njëra anë në tjetrën. Sa fatkeqësi e madhe është rënia e njeriut në këtë gjendje! Sa trishtim i madh është ta humbasësh Xhenetin!"

Gjetja e Xhenetit për Ademin dhe pasardhësit e tij, është një premtim hyjnor. Njerëzit fatlumë që ndjekin rrugën e Muhamedit (a.s.) duke u mbajtur me moralin e Tij të bukur dhe duke përjetuar sekretin e "Vdekjes pa vdekur" do ta gjejnë xhenetin e humbur qysh në këtë botë. Sepse ai që vdes dhe ai që zhvishet krejtësisht nga veset e këqija, pra "Shpirti i personit që vdes pa vdekur" i kupton sekretet e Xhenetit dhe Xhehenemit.

Njeriu digjet nga malli për atdheun e tij të parë e të vërtetë, Xhenetin. Ky mall mbaron me rikthimin e tij në Xhenet, ku sos edhe udhëtimi i tij. Por si çdo gjë, edhe hyrja në Xhenet, ka

çmimin e vet. Çmimi i Xhenetit është përballimi me sukses i tundimeve të kësaj bote, kryerja pa përtim e detyrimeve dhe fitimi i lirisë së vërtetë duke shpëtuar nga kurthet e dynjasë.

Shejtani, armiku i përbetuar i njeriut, ishte shkaku i largimit të Ademit nga Xheneti dhe mërgimit të tij në dynja. Shejtani, i mallkuar dhe i privuar nga mëshira hyjnore për shkak të Ademit, i është përveshur punës për ta penguar njeriun drejt rrugëtimit të tij për në Xhenet. Bashkëpunëtori më i madh i shejtanit në këtë çështje, padyshim se është vetë egoja e njeriut. Egoja e njeriut prej dobësisë ndaj jetës tokësore, bie lehtë në kurthin e shejtanit duke e larguar në këtë mënyrë njeriun nga Xheneti. Pejgamberi (a.s.) në një porosi të Tij e shpreh kështu prirjen e egos ndaj kënaqësive të kësaj bote. "Xhehenemi është i rrethuar nga kënaqësitë dhe epshet, kurse Xheneti është i rrethuar nga gjëra që nuk i pëlqejnë njeriut." (el-Xhamius-Sagir, I, 123)

Në lidhje me shpëtimin e njeriut, poeti i famshëm Mevlana mendon se personi që bën një ose dy hapa në përpjekjen për t'u larguar epshit dhe kënaqësive mondane, mund të kalojë në një pozitë të nderuar dhe dinjitoze, sipas tij ndotja e zemrës është një papastërti që mund të lahet dhe pastrohet vetëm përmes ibadeteve dhe dhikrit të vazhdueshëm e të rregullt. Vetëm ata që e mbajnë të pastër zemrën nga ndotësit e kësaj bote, meritojnë të shijojnë kënaqësitë dhe lumturitë e jetës së amshuar.

Mevlana në një vend tjetër e konsideron nefsin si një kafshë që nuk mendon për gjë tjetër veç ushqimit, prandaj thotë ai, duhet që me përpjekje dhe luftë kundër nefsit t'i japim përsëri jetë shpirtit duke e çuar drejt përsosmërisë.

Njeriu arrin përsosmërinë duke heshtur nefsin dhe duke lënë zemrën të flasë. Njerëzit e arrirë heqin dorë nga dëshirat



dhe shpresat, i përvishen punës dhe vetëm atëherë vetë-ndërgjegjësohen plotësisht për madhësinë e Krijuesit. Për ta, braktisja e dëshirave dhe kënaqësive është udhërrëfyes i sigurt drejt Xhenetit.

Mënyra më e mirë për pastrimin e zemrës është dashuria, sepse zemra e dashuruar pas Krijuesit përballon me kënaqësi vuajtjet dhe vështirësitë që i vijnë për t'i provuar. Në këtë mënyrë zemra përfshihet nga qetësia. Është e pamundur të arrihet pjekuria dhe përsosmëria pa kaluar përmes sitës së vuajtjeve, sprovave dhe sfidave. Ai që arrin pjekurinë shpëton nga pyetjet "përse, si dhe pse?" dhe fillon të përjetojë Xhenetin qysh në këtë botë.

Nuk i ka hije njeriut të pretendojë Xhenetin pa përbushur detyrimet fetare dhe pa rendur pas veprave të mira. Për të qenë robër të denjë të Allahut, duhet të strehohemi tek dera e pendimit siç bëri babai ynë, Ademi (a.s.), të kthehemi tek Allahu siç bëri Ibrahim Et'hemi, i cili për hir të dashurisë ndaj Allahut braktisi kurorën mbretërore dhe hodhi tej kënaqësitë e kësaj bote, duke u kthyer tek Krijuesi i Gjithëpushtetshëm. Vetëm në këtë mënyrë është i mundur rikthimi në Xhenet. Allahu e ka përcaktuar qartë se Xheneti është një premtim hyjnor, të cilin besimtarët mund ta arrijnë përmes sakrificave në jetë dhe pasurisë së tyre.

Në të vërtetë, besimtarët në vend të mirësive të Xhenetit do të preferonin të shihnin bukurinë e më të Bukurit të Bukurive, vetë Krijuesit, Allahut. Shprehja Kuranore "...do të kenë kënaqësinë e Allahut..." bën fjalë pikërisht mundësinë e të parit të Allahut në Xhenet. Të gjithë evlijatë kanë kërkuar këtë gjë. Siç shprehet Junus Emre:

*Në xheneti është disa saraje dhe disa vasha të bukura
Jepja atij që i dëshiron, kurse mua më duhesh Ti dhe vetëm Ti.*

Për të arritur këtë nivel ndjeshmërie, duhet që ibadetet të

mos kryhen për përfitime të ulta të kësaj bote, por të kryhen me zemër dhe sinqeritet të plotë. Ata që bëjnë ibadet për qëllime tokësore bëjnë gabim të madh, sepse çdo adhurim kushtuar dikujt tjetër përveç Allahut përbën faj. Namazi që falet për hipokrizi, megjithëse mund të duket i pastër, në brendësi është i ndotur me politeizëm.

Ibadeti, bindja dhe dhikri janë mënyrat e vetme për të triumfuar mbi nefsin dhe në themel të tyre qëndron durimi. Mevlana, durimin e ka përngjasuar me urën e siratit. Përmes kësaj ure kalohet në anën tjetër, ku ndodhet Xheneti. Xheneti është vendi i bukurive. Mirëpo përpara Xhenetit është ura e durimit, e cila është mjeti i vetëm që të çon në Xhenet.

Besimtarët e vërtetë duke triumfuar mbi dëshirat dhe kënaqësitë, për hir të dashurisë ndaj Allahut, të gjitha shfaqjet e caktimit të Allahut i presin me kënaqësi.

Një mysliman që beson në gjykimin e botës tjetër duhet të bëjë kujdes që të mos lëndojë asnjë zemër. Sepse pengesa më e madhe në rrugëtimin drejt Xhenetit është grindja midis njerëzve. Ashtu siç ishte egoja ajo që ia mbylli shejtanit derën e Xhenetit, është po ajo që ia ndërpret edhe njeriut rrugën drejt tij. Egoja është bota e ngushtë e dëshirave dhe e interesave vetjake. Egoist është personi që do vetëm veten dhe nuk shqetësohet për të tjerët. Kurse tek besimtarët e vërtetë nuk ekziston "Unë dhe Ti".

Rruga që të çon në xhenet është përmblodhur në suren Asr, një nga suret më të shkurtra të Kuranit, e cila konsiderohet si formulë për shpëtimin e njeriut. Allahu e përmbledh shpëtimin e njeriut në vlerësimin e duhur të kohës dhe botës. Njeriu është në humbje të sigurtë pa plotësimin e katër kushteve:

1. Besimi i drejtë.
2. Puna dhe vepra e mirë.
3. Thirrja për drejtësi dhe kapja fort pas të vërtetës.
4. Vetëpërmbytja dhe inkurajimi i të tjerëve për durim.

Këto janë vetëm parimet kryesore. Por pas plotësimit të këtyre kushteve themelore, për të hyrë në Xhenet, njeriu ka nevojë për mëshirën e pakufishme dhe gjithëpërfshirëse të Allahut. Për të fituar mëshirën e Allahut, duhet të strehohemi tek lutja dhe ndërmjetësimi i Pejgamberëve.

Mëshira hyjnore nuk dihet se prej nga mund të vijë. Ajo nganjëherë gjendet në gjëra shumë të mëdha kurse nganjëherë fshihet në gjëra që ne mund t'i konsiderojmë shumë të vogla dhe të parëndësishme. Prandaj duhet të vlerësohet çdo mjet. Sipas një transmetimi, qeni që shoqëronte djelmohat e shpellës, hyri në Xhenet për shkak të shoqërimit me ta. Në këtë mënyrë shoqërimi me besimtarë të sinqertë e të mirë bëhet shkak për të hyrë në Xhenet. Janë shumë kuptimplotë fjalët: "O i Dërguari i Allahut! Sikur të shoqërohem edhe unë me sahabët e tu dhe të hyj në Xhenet, siç hyri qeni i djelmohave të shpellës! Si mund të hyj unë në Xhehenem, kur qeni i djelmohave të shpellës hyri në Xhenet? Ai ishte qeni i djelmohave të shpellës, kurse unë dua të jem 'qeni' i sahabëve të tuaj".

Pra, për të hyrë në Xhenet së pari duhet besimi, pastaj kryerja e detyrimeve që obligon besimi dhe qëndrimi me durim mbi këtë rrugë deri në vdekje.

MUHAMEDI

Paqja qoftë mbi të!

GENEALOGJIA E MUHAMEDIT (A.S.)

Emri i tij është Muhamed ibën (i biri i) Abdullah, ibën Abdulmutalib, ibën Hashim, ibën Abdumenefi, ibën Kusijji, ibën Murra, ibën Keab, ibën Luejje, ibën Galib, ibën Fihri, ibën Malik, ibën Nadri, ibën Kinene, ibën Khuzejme, ibën Mudrike, ibën Iljas, ibën Mudar, ibën Nizar, ibën Muad, ibën Adnani); teksa brezat e gjenealogjisë para Adnanit, përfundojnë tek profeti Ismail, i biri i profetit Ibrahim (Paqja qoftë mbi ta!).

JETËSHKRIMI I MUHAMEDIT (A.S.)

Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), lindi në Mekë, në ditën e hënë, më 12 të muajit Rabia el Eulu/22 prill, në vitin e Ngjarjes së Ushtrisë së Elefantit/571 diellor dhe ndërroi jetë më 12 Rabia el Eulu/8 maj 632.

Babai i Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!), quhej Abdullah. Ai ndërroi jetë në qytetin e Medinës, në moshën 25-vjeçare nga një sëmundje. Kur ai ndërroi jetë, djali i tij, Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), kishte vetëm pak muaj që gjendej në barkun e së ëmës, Emine bintu Uehebit. Pak pas lindjes së Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!), sipas traditës së liderëve të Mekës, ai do të mëkohej përkundrejt shpërblimit nga një grua e zonës nomade, Halimja, e cila i përkiste fisit Benu Sead, ku ai do të rritet deri kur arrin moshën 4- vjeçare, në të cilën Xhebraili (Paqja qoftë mbi të!), i urdhëruar nga Allahu i Lartësuar vjen t'ia hapë dhe pastrojë kraharorin, teksa Muhamedi i vogël po luante.

Pas kësaj ngjarjeje sa të mahnitshme, aq edhe të frikshme, Halimja e kthen Muhamedin e vogël tek nëna e tij Eminja. Paskëtaj, Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), jeton me të ëmën deri në moshën 6-7 vjeçare, në të cilën Eminja ndërroi jetë në rrugën e kthimit nga Medina, ku kishin shkuar për të vizituar dajallarët e Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!). I mbetur pa babanë dhe pa nënën, Muhamedi

(Paqja qoftë mbi të!), merret në përkujdesje nga gjyshi i tij Abdul Mutalibi, i cili ndërroi jetë kur Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), ishte vetëm 8 vjeç, ndërsa pas kësaj, përkujdesjen e Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!), e merr përsipër xhaxhai i tij, Ebu Talibi.

Në moshën 12- vjeçare Ebu Talibi e merr Muhamedin (Paqja qoftë mbi të!), me vete me karvanin tregtar që nis për në Sham, ku në rrugë e sipër ata takojnë murgun Buhajra, i cili i tregon Ebu Talibit se ky djalosh do të ishte personazh i një çështjeje madhështore, pasi tek ai ishin të pranishme shenjat e profetit që pritej të vinte edhe nga ana e hebrenjve, edhe nga ana e të krishterëve, gjë të cilën ia argumenton ndër të tjera edhe me renë që po i bënte hije Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!), gjatë këtij rrugëtimi. Buhajra insistoi që Ebu Talibi të kthehej në Mekë, pasi ai frikësohej se mos hebrenjtë i bënin ndonjë të keqe Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!).

Në moshën 15 vjeçare Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!) merr pjesë në Betejën e Fihxharit, në të cilën Kurejshët që kishin në anën e tyre fisin e Kinenes, i kundërvihen Kajs el Ajlanit, betejë në të cilën Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), u përgatiste shigjetat xhaxhallarëve të tij. Gjithashtu Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), para se t'i zbritej Shpallja, bëhet anëtar i Aleancës së Fudulit, që bëhet nga disa fise mekase, për t'u ardhur në ndihmë njerëzve që u shkeleshin të drejtat dhe që shtypeshin nga tiranët.

Puna bazë që bëri Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), në rininë e tij, ishte përkujdesja për bagëtitë, profesion ky që padyshim i shërbeu shumë atij në aspektin e medimit, durimit dhe më gjerë.

Sinqeriteti dhe besnikëria e Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!), ishte një fakt gjerësisht i njohur në popullin e tij, saqë ata i kishin vënë atij pseudonimet "Es Sadik-Besniku", "El Emin-i Sinqertë"...

Një grua e ve, fisnike dhe e pasur mekase, që quhej Hadixhe bintu (e bija e) Khuejlid, dëgjon për sinqeritetin, besnikërinë dhe moralet e Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!), ndaj ajo i ofron Muhamedit 25-vjeçar, që në shoqëri të skllavit të saj Mejseras, të bëjë tregti në Sham me kapitalin e saj tregtar. Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), e pranon ofertën e saj, bën një tregti shumë të suksesshme dhe me t'u kthyer prej tregtisë, Mejsera i tregon Hadixhes për moralet e mrekullueshme të Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!), gjë që nxiti tek zemra fisnike e Hadixhes (Allahu qoftë i kënaqur me të!), dëshirën që Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), të ishte shoku i saj i jetës. Mejsera, e nxitur nga Hadixhja, e pyet Muhamedin (Paqja qoftë mbi të!), nëse do të që dakord të martohej me Hadixhen, gjë mbi të cilën Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), pasi merr mendimin e të afërmeve të tij, bie dakord. Familja e Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!) dhe ajo e Hadixhes (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ishin prej fisit Kurejsh, i cili ishte një fis i njohur mekas, për të cilin gëzojnë respekt mbarë arabët e kohës.

Populli i Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!), në kohën para se atij t'i zbriste Shpallja, ishte një popull injorant, që adhuronte idhujt dhe ku dominonte analfabetizmi, pasi mësimi i shkrim-këndimit ndër ta ishte dukuri tepër e rrallë. Kur Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), u rrit, u bë i njohur për zgjuarsinë, besnikërinë, bujarinë, sinqeritetin, ndershmërinë, sjelljen dhe guximin e tij; për këtë, kur ai ishte vetëm rreth 35 vjeç, populli i tij i besoi atij zgjidhjen e çështjes së vendosjes së gurit të zi në kulmin e Qabes.

Kur Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), mbush dyzet vjeç, gjen në vetvete dëshirën e veçimit në shpellën e Hirasë për të adhuruar Zotin e tij për net të tëra. Pikërisht në një nga këto net, ditën e hënë, në natën 21 Ramazan/10 gusht, të vitit 610 Hixhri, në shpellën Hira në periferi të Mekës, Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), i paraqitet engjëlli Xhibril (Paqja qoftë mbi të!), me Shpalljen Hyjnore prej Zotit të botëve, që zbret mbi të pesë thëniat e para të sures "Ikra-Lexo"... Ai (Paqja qoftë mbi të!), shkon me Hadixhen tek xhaxhai i saj, Uereka ibën Neufel, një prift i krishterë, i cili konfirmon se Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), i kishte zbritur po ai engjëll që i kishte zbritur Musait (Paqja qoftë mbi të!)... Për gjashtë muaj rresht kemi një vakje të Shpalljes dhe në to engjëlli nuk i zbriste Shpallje të re Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!), por vetëm i shfaqej, duke i thënë: "O Muhamed, ti je vërtet i Dërguari i Allahut". Kjo vakje e Shpalljes ndodhi me qëllim që Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), të përmallohej për Shpalljen dhe të mësohej në mënyrë të përshtatshme që ta mbante rëndesën e saj. Pas kalimit të gjashtë muajve, Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!) vijon t'i vijë Shpallja, duke u zbritur mbi të surja "El Mudethir-i Mbuluari", përmes së cilës ai urdhërohet ta kumtojë Shpalljen e cila do të vijojë t'i zbresë për njëzet e tre vjet.



Hadixhja (Allahu qoftë i kënaqur me të!), bëhet jo vetëm besimtarja e parë që i beson Shpalljes së zbritur mbi bashkëshortin e saj, por edhe mbështetësja e tij në përhapjen e Fjalës së Zotit të botëve, me gjithë sa ajo zotëronte. Karvanit të besimtarëve të parë, krahas Hadixhes i bashkëngjiten shumë shpejt edhe Ebu Bekri, Aliu ende fëmijë dhe Zejd ibën Harithe prej robërve. Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), në tre vitet e para të profesisë së tij, urdhërohet nga Zoti i botëve ta kumtojë fshehurazi Mesazhin që i zbriste, periudhë gjatë së cilës ai mblidhej me myslimanët e parë fshehurazi tek shtëpia e Erkam ibën Ebi el Erkamit, një djaloshi 17-vjeçar, që ishte një nga shtatë të parët që pranuan Islamin, që ishte njeri me pozitë në Mekë dhe që shtëpia e tij kishte një pozicion strategjik, pasi gjendej mbi kodrën Safa.

Sapo Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), filloi të thërriste popullin e tij në Rugën e drejtë të Allahut të Madhëruar. Ai dhe grupi i vogël i pasuesve të parë të tij u persekutuan nga idhujtarët e Mekës, porse Kumtimi i tij (Paqja qoftë mbi të!), u shtri tek banorët e Medinës përmes tri besëlidhjeve të Akabesë, respektivisht në vitet 11, 12 dhe 13 të profesisë, ku besëlidhësit rriten në numër nga rreth 8 në të parën, në 12 në të dytën dhe 75 në të fundit.

Ndërkaq, persekutimi ndaj myslimanëve bëhet aq i ashpër, sa që ata detyrohen të emigrojnë tri herë: dy herë drejt Abisinisë, fillimisht 12 burra dhe 2 gra, në vitin e 5-të të profesisë, pastaj 82 burra dhe 18 gra në vitin e 7-të të profesisë, ndërsa emigrimi i tretë ishte drejt Medinës në vitin e 12-të pas zbritjes së Shpalljes, teksa mosha e Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!), ishte 53 vjeç. Emigrimi i fundit vjen pas embargos së rreptë trevjeçare, me të cilën përballen myslimanët e parë dhe fisi i Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!), në lagjen e tij Benu Hashim, embargo e cila do të mbaronte në vitin e 10-të të profesisë/620 diellor, të cilin Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), do ta quante Viti i Hidhërimit, pasi në të ndërron jetë xhaxhai i tij Ebu Talibi, i cili edhe pse ndërron jetë jobsimtar kishte qenë një fortesë e fuqishme për nipin e tij Muhamedin (Paqja qoftë mbi të!) dhe gjithashtu vetëm pak ditë më pas ndërron jetë edhe bashkëshortja e tij e devotshme Hadixhja (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

Në këto rrethana, për 10 ditë rresht, Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), nisat ta kumtojë Mesazhin hyjnor tek banorët e zonës së Taifit, ku jo vetëm pritët me sharje dhe refuzim, por çështja shkon deri aty sa ata e gjakosin. Teksa Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), lë pas territorin e Taifit, atij i vjen engjëlli i malit, i gatshëm për t'u hakmarrë kundër banorëve abuzues të këtyre viseve, përmes shembjes mbi kryet e tyre të dy maleve të Mekës, por Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), zgjedh që t'i falë ata aspirues se në mos ata vetë, pasardhësit e tyre do ta përqafojnë Islamin...

Në vitin e 12-të të profecisë, zgjuar, me trup dhe me shpirt, Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), bëhet personazh i udhëtimit të Israsë dhe Miraxhit, ku flet direkt me Zotin e botëve dhe ku i shpallet obligimi i faljes së pesë namazeve...

Do të ishte pikërisht viti i 13-të i profecisë/622 diellor, në të cilin Allahu i Madhëruar urdhëron që myslimanët të emigronin në masë nga Meka për në Medine, 400 km ne veri, vit ky që shënon edhe fillimin e kalendarit islam Hixhri, që nis pikërisht me kohën e këtij emigrimi. Dasha-keqësia e idhujtarëve të Mekës shkon deri aty, sa që liderët e tyre, të paaftë për ta përballuar vibracionin gjithmonë në rritje të Thirrjes së Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!), planifikojnë ta vrasin, gjë që e bën të pashmangshëm emigrimin e vetë Muhamedit (Paqja qoftë mbi të!). Në emigrimin për në Medinë, Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), shoqërohet nga shoku i tij i devotshëm Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Në këtë emigrim, që rrjedh sipas një plani të përkryer profetik, pjesë e të cilit ishte edhe fshehja në shpellën e Theurit, Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), arrin t'i shpëtojë lukunisë që i ishte vënë pas, e ndjellë nga çmimi që ishte vënë për kapjen e Profetit (Paqja qoftë mbi të!) dhe shokut të tij, gjallë ose vdekur...

Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), fillimisht do të vinte në zonën e Kubasë dhe prej këtu do të nisej për në Medinë, ku do të pritej shumë përzemërsisht prej banorëve të saj. Ai (Paqja qoftë mbi të!), vendoset në Medinë, ku ndërton xhaminë profetike, vëllazëron mekasit me medinasit dhe vendos themelet e shtetit të parë islam. Ky shtet do të konsolidohet më tej me institucionin e Zekatit dhe Agjërimin, në vitin e 2-të Hixhri, me ndalimin e alkoolit, në vitin e 3-të Hixhri, me institucionin e Haxhit, në vitin e 5-të Hixhri dhe do të arrijë kulmin e tij në vitin e 8-të Hixhri/629 diellor, në të cilin Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!) dhe pasuesit e tij, edhe pse do të ktheheshin në Mekë çlirimtarë, do t'i falnin armiqtë e tyre, duke e shndërruar Mekën në vatrën e dytë më të rëndësishme të Shtetit islam.

Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), Profeti i mëshirës, merr pjesë në rreth 27 beteja dhe nga dora e tij nuk mbetet i vrarë askush, përveç Ubej ibën Khalefit, i cili ndërroi jetë i ndikuar nga plaga e heshtës me të cilën e goditi Profeti (Paqja qoftë mbi të!), pasi Ubeji në Betejën e Uhudit, duke klithur "O unë, o Muhamedi!", tentoi ta vriste Profetin (Paqja qoftë mbi të!).

Në vitin 10 Hixhri, Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), do të kryente haxhin e vetëm të tij, të njohur në histori si Haxhi i Lamtumirës. Një vit më pas, në ditën e hënë, më 12 të muajit Rabia el Euel/8 maj, të vitit 11 Hixhri/632 diellor, Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), ndërroi jetë në moshën 63-vjeçare dhe varrosët të nesërmen në dhomën e bashkëshortes së tij Aishes (Allahu e mëshiroftë!).

Kur ai (Paqja qoftë mbi të!), ndërroi jetë, pjesa më e madhe e Gadishullit Arabik e kishte pranuar Islamin dhe vetëm një shekull më pas, Islami u përhap nga Spanja në perëndim e deri në Kinë në lindje. Shkaku kryesor i përhapjes së shpejtë të Islamit ishte vërtetësia dhe qartësia e thirrjes në një Zot të Vetëm që Islami predikon dhe drejtësia e ligjeve të tij.

PËRSHKRIMI I MUHAMEDIT (A.S.)

Në përshkrim të fizionomisë së profetit Muhamed (Paqja qoftë mbi të!), transmetuesit përmendin se:

Ai (Paqja qoftë mbi të!), kishte lëkurë të bardhë të hijshme, as të bardhë të theksuar dhe as ezmere; kishte fytyrën më të hijshme dhe të ndritshme njerëzore, ishte fytyrërrumbullakët dhe buzëqeshja e tij ia ndriçonte ballin si të ishte një copë hëne; koka e tij ishte e bëshme, me ballë të gjerë, me sy të zinj, të gjerë, të bukur dhe me një të kuqe fare të lehtë në të bardhën e syrit; flokët e tij

ishin me onde dhe jo shumë të dendura, as kaçurrela të theksuara dhe as të drejta, shumica e tyre arrinin deri tek tulet e veshit, para se t'i qethte arrinin deri tek supet dhe kur i qethte, arrinin tek mesi i veshëve; edhe pse ndërroi jetë në krye të të gjashtëdhjetave ai në kokën dhe mjekrën e tij nuk kishte as njëzet thinja, të cilat ishin të përqendruara në zonën midis buzës së poshtme dhe majës së mjekrës; kishte një mjekër të dendur që mbushte kraharorin e tij; vetullat e tij ishin qartësisht të ndara, të shtrira dhe me hark; kishte qerpikë të gjatë; hundë të bëshme, të hijshme, të harkuar në

mes dhe me majë pakëz të ngritur; dhëmbët i kishte të ndarë; ishte me një shtat mesatar, jo shumë të lartë, por as të shkurtër; shpatullgjerë, me trup të lidhur dhe të bëshëm; me pëllëmbë të gjera, të fuqishme, por të buta si mëndafsh; me këmbë të mëdha dhe të fuqishme; aroma e lagështisë së trupit të tij ishte më e këndshme se parfumi; kur ecte, anonte përpara dhe kur kthehej, kthehej i tëri. Ai ishte njeri me sedër, fisnik, bujar, guximtar, i matur dhe falës; i edukuar nga vetë Zoti, gjë në lidhje me të cilin ai (Paqja qoftë mbi të!), thotë: "Më edukoi Zoti im më së miri" dhe bashkëshortja e tij Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!), thotë: "Morali i tij ishte Kurani"; shkurt tek ai (Paqja qoftë mbi të!), tuboheshin cilësitë më të bukura trupore dhe morale.

Muhamedi (Paqja qoftë mbi të!), që nga preludi i rritjes së tij dhe më pas edhe në maturimin e tij, ishte mësuar t'i urrente idhujtarinë dhe shthurjen e asokohshme të shoqërisë ku jetonte.

Ai (Paqja qoftë mbi të!), kishte disa emra, ku dominojnë emrat e tij Muhamed, Ahmed dhe Mustafa, si dhe pseudonimi i tij Ebu (babai i) el Kasim.





Fillimi I MUAJVE HËNORË

Muhamed El-Gazali

Debati i myslimanëve rreth fillimit të muajve hënorë është kthyer pothuajse në një shfaqje komike! Kështu, Fitër Bajrami i kaluar, në disa vende ishte në ditën e shtunë, të dielën dhe të hënën në disa vende të tjera.

Luhatjet e rezultateve të matjeve dhe përcaktimit të hënës së re me dy apo tri ditë diferencë kryekëput bie ndesh me unitetin islam! Neglizhimi i gjithë kësaj është barrë shumë e rëndë...

Lexova se një grup shkencëtarësh kishin llogaritur se hëna e re, shkencërisht do të lindte në filan ditë, filan orë dhe se vëzhgimi i saj para këtij çasti është i pamundur! Pa kaluar vetëm pak kohë, lexova se disa dëshmitarë e kishin parë me sy të lirë hënën e re!!

Atëherë thashë me vete, njëra prej të dyjave: ose dëshmitarët janë të paqartë, ose astronomët kanë gabuar... dhe nuk ka supozim tjetër të tretë!

Pa dyshim që hëna në orbitën e saj ecën me një shpejtësi konstante, e cila nuk rritet dhe as nuk ngadalësohet. Ajo nuk e ul hapin e shpejtësisë për të pritur ndokënd dhe as nuk e rrit hapin në padurim të takimit me të! Kjo punë është ashtu siç e ka thënë Zoti ynë: **"Ai është, i Cili e bëri diellin dritë dhe hënën shkëlqyese dhe i caktoi asaj fazat që të llogarisni numrin e viteve dhe përlllogaritjen. Këtë Allahu nuk e krijoi, përveçse me saktësi, hak..."**¹

1. Sureja Junus, ajeti: 5

Fjalja e fundit e ajetit është vendimtare... lëvizja e hënës kryhet me saktësi, dhe se kjo lëvizje, në qoftë se arrihet zbulimi i saj me metoda bindëse e të sigurta, nuk lë vend për debate të kota.

Lind pyetja: "Nga ta marrim këtë bindje dhe siguri?" Përgjigjja: "T'i kërkojmë komisionit të zbulimit të vërtetësive t'u telefonojnë observatorëve në Uashington, Moskë, Londër, Paris dhe të njihemi me kohën, kur arrihet bashkimi mes hënës, tokës dhe diellit, e të marrim një përgjigje të prerë rreth mundësisë së shikimit të këtij bashkimi. Atëherë, në qoftë se është e pamundur, ne refuzojmë çdo dëshmitar që pretendon se ka parë hënën e re, duke u bindur se ky njeri e ka imagjinuar ose është ngatërruar."

Bindja dhe siguria shkencore patjetër duhet të respektohet dhe çdo gjë përveç kësaj të mënjanohet. Në të vërtetë, unë ndjej konfuzion kur lexoj nëpër gazeta se astronomët janë të sigurt se është e pamundur të shikohet hëna e re, pastaj dëgjoj pas kësaj se hëna e re është parë në këtë apo atë vend!!

Unë kërkoj një hetim shkencor dhe botëror të kësaj tragjedie! Ose të ndryshojmë observatorët dhe shkencëtarët tanë për mungesë vërtetësie, ose të procedojmë dëshmitarët, sytë e të cilëve kanë parë çfarë nuk ka lindur në horizont! Heshtja ndaj kësaj kontradikte nuk lejohet.

Përktheu
Lavdrim Hamja



INDHUIT

E KOHËVE MODERNE

Nuredin Nazarko

Qysh nga kohërat më të hershme njerëzimi ka qenë i lidhur me ushtrimin e praktikave religjioze. Sipas hermeneutikës materialiste të historisë, format e hershme të religjiozitetit të njeriut janë praktikat politeiste, të cilat derivuan nga pamundësia e shpjegimit shkencor të dukurive e fenomeneve me të cilat përballlej njeriu i atyre kohërave. Nisur nga kjo pamundësi shpjeguese e asaj çka ngjante në natyrë apo në qiellin plot yje, njeriu primitiv ia atribuonte këto lëvizje dhe ndryshime fuqive të caktuara, të cilat ndikonin mbi ecurinë e jetës së njeriut dhe ngjarjeve që ndodhnin në tokë e në qiell. Me rrjedhën e kohës, praktikat religjioze filluan t'i përkushtoheshin jo më shumë fuqive përtejnjerezore apo zotave, por një Zoti të Vetëm. Kësisoj lindi besimi monoteist. Sipas kësaj hermeneutike edhe monoteizmi është produkt i mendjes njerëzore të pandriçuar nga iluminizmi shkencor. Sipas hermeneutikës religjioze të universit, botës, njeriut dhe statusit që ka ky i fundit në botë, njeriu në hershmërinë e tij ka qenë monoteist dhe praktikat politeiste nuk janë gjë tjetër vetëm se devijim dhe shtrembërim i monoteizmit fillestar. Për t'i rikujtuar njeriut politeist monoteizmin e pastër dhe rikthimin drejt tij, ngrihen dhe shfaqen përballë njerëzve, njerëz të caktuar që pranojnë "institucionin" e Profetit. Njeriu Profet, jo i vetëcilësuar i tillë, transmeton dhe kumton atë që i zbulohet nëpërmjet zbulësës. Thelbi i kumtimit qëndron në rikthimin drejt monoteizmit të pastër dhe braktisjen tërësore të besimit dhe praktikave politeiste. Nga ky këndvështrim, monoteizmi

është pamundësisht i derivueshëm nga politeizmi, i cili është derivat i shtrembërimit të monoteizmit nga mendja njerëzore. Në rrjedhën e kohës gjithmonë ka pasur një vijë ndarëse, tërësisht të qartë, midis monoteizmit dhe politeizmit, të cilët kanë kundërshtuar dhe kundërshtojnë katërcipërisht njëri-tjetrin. Monoteizmi në cilëndo etapë të historisë njerëzore mbi sipërfaqen e tokës, ka qëndruar plotësisht monotesit. Monoteizmi nuk ka as të shkuar e as të ardhme, as forma klasike e as forma bashkëkohore. Ai është konsekuent.

Politeizmi, duke derivuar nga shtrembërimi i monoteizmit prej mendjes njerëzore, ka ndryshuar në rrjedhën e kohës format dhe praktikat e tij, herë në mënyrë eksplicite e herë në mënyrë implicite. Mund të flasim për forma klasike dhe moderne të politeizmit, por edhe në kohët moderne përhasemi me forma klasike të politeizimit. Në klasicitetin e vet, politeizmi ngre dhe ndërton tempuj, që u dedikohen zotave dhe perëndive që kanë kompetenca dhe fuqi për të kontrolluar rrjedhën e ngjarjeve dhe jetën e njeriut. Secili prej zotave është i mëvetësuar në zotërimin dhe fuqitë e tij, shpeshherë në konflikt dhe rivalitet me zotat e tjerë. Për të qëndruar më afër zotave dhe për të qenë më i lidhur me ta, njeriu politeist, përmes imagjinatës dhe përfytyrimit, i ktheu imazhet e zotave në vepra konkrete, nëpërmjet ndërtimit të statujave. Për të fituar bekimet dhe mëshirën e zotave apo për të frenuar inatin dhe zemërimin e tyre, njeriu politeist u blatonte sakrificat dhe përnderime, nëpërmjet kryerjes

së ritualeve të caktuara në vazhdimësi, apo në ditë dhe sezone të caktuara. Rituale marrin kuptim vetëm duke u ngritur përmbi themelin e dashurisë dhe nënshtrimit ndaj zotave. Përlujta ndaj zotave, frika ndaj tyre, lutjet drejtuar atyre, sakrificat dhe blatimet e kryera për ta, ishin shpërfaqje e dashurisë dhe nënshtrimit të zemrës së njeriut politeist ndaj politeizmit. Në këtë mënyrë, adhurimi si fjalë dhe vepër merr kuptim vetëm në qoftë se zemra pranon dashurinë e plotë dhe nënshtrimin e plotë ndaj atij që adhuron. Në monoteizëm dashuria dhe nënshtrimi i plotë me frikë dhe shpresë është vetëm për Një Zot të Vetëm, me emra dhe cilësi absolute, ndërsa në politeizëm është për zota të përzier ose jo, me cilësi njerëzore. Prej këtej kuptojmë se esenca e adhurimit nuk është rituali, por dashuria dhe nënshtrimi i plotë ndaj atij që adhurohet dhe kushdo që gjendet në këtë gjendje, gjendet i implikuar në adhurim.

Sikundërse e përmendëm, politeizmi shfaqet në forma të ndryshme në kohë dhe hapësirë, edhe pse në thelbin e tij është shtrembërim i monoteizmit, pavarësisht formave dhe larushive me të cilat shfaqet. Në formën e tij klasike, politeizmi shfaqet si adhurim i idhujve, qofshin statuja, gurë, drurë, kafshë apo varre të vdekurish. Por çfarë ndryshoi në kohët moderne nga forma klasike e politeizmit dhe idhujtarisë? Me daljen në dritë të modernizmit shpjegimi për universin, botën, njeriun dhe statusin e tij në botë, u ngrit mbi themelin e mohimit të shpjegimit tradicional. Modernizmi duke u bazuar tek racionalizmi, individualizmi dhe eksperimentalizmi, tërësisht njerëzake, dhe jo mbi truallin e metafizikës, ndjente neveri jo vetëm ndaj monoteizmit, por edhe ndaj formave klasike të idhujtarisë. Në këtë mënyrë, modernizmi synonte çlirimin e arsyes njerëzore ndaj çdo lloj forme idhujtarie dhe nga prangat e tradicionalizmit, po nëpërmjet arsyes. Në këtë betejë të hapur ndaj obskurantizmit mesjetar dhe atij primitiv, modernizmi anashkaloi tërësisht një çështje tejet të rëndësishme tek njeriu, çështjen e zemrës. Esenca e adhurimit është e pamundshme pa hapjen e zemrës me dashuri dhe nënshtrim të plotë ndaj atij apo atyre që adhuron. Sipas këtij përcaktimi, duke qenë se zemra njerëzore gjendet gjithmonë në gjendje adhurimi, konkludojmë se zemra është krijuar posaçërisht për të adhuruar dhe për asnjë çast të vetëm nuk mund të jetojë pa adhurim. Adhurimi është ajri i saj. Në qoftë se nuk adhuron Krijuesin do të adhurojë diçka tjetër. Vërtet



modernizmi hodhi poshtë me neveri format klasike të idhujtarisë, por nuk preku thelbin e tyre, shtrembërimin e monoteizmit dhe devijimin prej tij. Format dhe ritualet klasike të idhujtarisë u hodhën poshtë, madje u luftuan ashpër, por idhujtaria mbijetoi duke marrë forma të reja e duke mbetur në thelb po e njëjta. Format e reja të idhujtarisë janë meritë e modernizmit, që nuk bëri as më shumë e as më pak sesa hutoi njeriun modern me shkëlqimin e jashtëm të gjërave, duke e lënë peng të idhujtarisë, edhe pse me të madhe trumbeton suksesin në çrrënjosjen e formave klasike të saj. Duke qenë se esenca e adhurimit është hapja e zemrës me dashuri e nënshtrim të plotë, nuk ka më rëndësi nëse përballë njeriut duhet të qëndrojnë objektet klasike të idhujtarisë. Në shoqërinë moderne ato janë zëvendësuar me narcizmin, paranë, komoditetin material, suksesin, makinat, femrat, meshkujt, paraardhësit, pasardhësit, sportistët, këngëtarët dhe aktorët, pushtetin, fuqinë, shkencën, teknikën, natyrën. Idhujt e kohëve moderne

janë më joshës, më rrëzëllitës, më tërheqës për ata që kanë zemra dhe nuk mendojnë. Rrëshqitja drejt formave moderne të idhujtarisë mund të ndodhë në çdo moment dhe askush nuk mund të pohojë me siguri shpëtimin prej tyre, në qoftë se sinqeritetin dhe pastërtinë e zemrës së tij ndaj pranimit të monoteizmit nuk i ka bashkudhëtarë të pandarë. Simptomat e idhujtarisë së kohëve moderne janë lehtësisht të konstatueshme. Mjaft të shohësh turma njerëzish që ulërijnë kur shfaqet idhulli i tyre nën fanfarat e spektaklit, njerëz që zalisen e alivanosen

në përpjekje për të prekur idhujt e tyre, njerëz që turren si të ndërkyer vetëm e vetëm ta ndjejnë nga afër praninë fizike të idhullit të tyre e të rrëmbejnë diçka prej tyre për ta ruajtur si talisman të shenjtë. Këto dhe plot shembuj të tjerë që mund të na ofrojë përditshmëria jetësore tregojnë qartësisht se modernizmi jo vetëm që nuk e çrrënjosi idhujtarinë klasike, por thjesht e ëmbëlsoi duke i ndryshuar pamjen e jashtme, për ta bërë më të pranueshme për masat e gjera. Kjo rrjedhë zhvillimesh ka sjellë dekadencën e vlerave shpirtërore të gjithë atyre që i kanë lejuar vetes të zgjedhin implikimin në të tilla rrjedha. Pasojat e zgjedhjes nuk do të jenë asnjëherë në pritje, ato janë të pranishme.

“Mos ka ardhur vallë koha për të pushuar polemikat mbi Zotin dhe në vend të kësaj të bashkohemi, për të demaskuar format moderne të idhujtarisë?” (Erich Fromm, “Psikoanaliza dhe feja”, Tiranë 2002, faq. 109)

BESIMI NË

Allahun

Prof. dr. M. Jashar Kandemir

Allahu Teala, i ka urdhëruar të gjithë robërit e Tij, duke u thënë:

"...S'ka Zot tjetër përveç Meje, andaj vetëm Mua më adhuroni!" (el-Enbija, 25.)

Me anë të këtij urdhri të prerë, Allahu i Madhëruar na e bën të ditur se s'ka Zot tjetër përveç Tij'. Dhe na thotë se ai që i beson Atij, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë².

Ai thekson se çdo krijesë në qiej dhe në tokë, me dëshirë apo pa dëshirë, i përulet Atij dhe se njeriu nuk duhet të kërkojë fe tjetër përveç Islamit³.

SHKURTIMISHT:

Të gjithë duhet t'i kthehen Zotit të tyre dhe të gjithë duhet të nxjerrin në pah ndjenjën e fesë, të cilën Allahu Teala e ka vendosur brenda njeriut, qysh kur e ka krijuar⁴. Kjo, sepse ashtu siç ka thënë edhe Profeti ynë (a.s.), të gjithë kanë kapacitetin e duhur për të pranuar fenë e Allahut⁵.

Në shumë ajete të Kuranit Kerim thuhet:

Ata që i besojnë Allahut dhe bëjnë punë të mira, përgëzohen me mirësitë e pafundme të xhenetit⁶. Ndërsa, ata që nuk besojnë Allahun, do të përballen me fatkeqësi, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër⁷.

AJETI QË TREGON MË QARTË ALLAHUN

Allahu Teala, në Kuran, ka treguar për Veten e Tij, aq sa ka dëshiruar që ne të dimë për Të. Ajeti që jep informacione më të qarta dhe më të organizuara në lidhje me besimin

1. Shih. Muhammed, 19.

2. Shih. El-Bekare, 256.

3. Shih. Ali Imran, 83.

4. Shih. Er-Rum, 30.

5. Shih. Buhari, Xhenaiz 79, 92; EbuDaud, Sunnet 17; Tirmidhi, Kader 5.

6. Shih. El-Bekare, 25, 62, 82, 277; Al-i Imran 57; Nisa 57, 122, 173; Maide 9, 93.

7. Shih. El-Bakare 24, 90, 104, 161-162, 191, 257, 264; el-Maide 36, 67; el-En'am 31; el-Enfal 50; Junus 4; en-Nahl 107; Kehf 50, 103-15; el-Enbija 39-40, 98; Sebe' 31-33; Zumer 71; Muhammed 27.



në një Zot të vetëm, është "ajetu'l-Kursi". Profeti ynë (a.s.), ka thënë se ai është ajeti më rëndësishëm i Kuranit⁸.

Ajeti është si më poshtë:

"Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursi-u i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t'i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!" (el-Bekare, 255.)

FORMULA E TEUHIDIT

Si do ta dëshmojë një besimtar besimin në Allahun? Sipas asaj që ka thënë Profeti ynë (a.s.), besimi ka deri në gjashtëdhjetë ose shtatëdhjetë degë. Në krye të këtyre, zë vend fjala, "La ilaheil-lallah"⁹.

Ai që thotë "La ilaheil-lallah", ka thënë se **"Nuk ka zot tjetër, përveç Allahut"**. Këtë shprehje e njohim ndryshe edhe si Formula e Teuhidit. Por le të dëgjojmë se çfarë ka

8. Muslim, Musafirin 258; EbuDaud, Vitr 60.

9. Buhari, Iman 3; Muslim, iman 58; EbuDaud, Sunnet 14; Nesai, iman 16; Tirmidhi, Birr 80; Muslim, Mukaddime 9, Edeb 7.



thënë i Dërguari i Allahut (a.s.), në lidhje me rëndësinë e Formulës së Teuhidit dhe se çfarë përfitojmë prej saj:

“Kush thotë La ilaheil-lallah, hyn në xhenet.”¹⁰

“Kush vdes duke besuar se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, hyn në xhenet.”¹¹

“Ai që thotë fjalën e fundit të tij: “La ilaheil-lallah”, hyn në xhenet.”¹²

“Ai që thotë “La ilaheil-lallah”, le të ketë bërë ç’të dojtë më parë, një ditë kjo fjalë do ta shpëtojë.”¹³

Profeti ynë (a.s.), kishte shumë dëshirë që xhaxhai i tij, Ebu Talibi, të bëhej mysliman. Dhe këtë dëshirë ia paraqiti shumë herë atij. Prandaj, kur xhaxhai i tij ishte në shtratin e vdekjes, ai i tha edhe njëherë:

“Xhaxha! Thuaj La ilaheil-lallah, që në Ditën e Gjykimit të dëshmoj pro teje”

Mirëpo, xhaxhai i tha:

“Nipi im! Sikur ta dija se kurejshët nuk do të më akuzonin duke thënë se “u bë mysliman nga frika”, do ta kisha plotësuar dëshirën tënde duke e thënë atë fjalë.”

10. Ahmed b. Hanbel, Musned, III, 131.

11. Muslim, iman 43; Ahmed b. Hanbel, Musned, I, 65, 69.

12. EbuDaud, Xhenaiz 15, 16; Tirmidhi, Xhenaiz 7; Hakim, el-Mustedrek, I, 503, 678.

13. Albani, Sahihu't-Tergibue't-terhib, II, 221; Albani, Silsiletu'l-ehadis'i's-sahiha, IV, 566-568.

Mbi këtë ngjarje zbriti edhe ajeti i mëposhtëm:

“Vërtet, ti (Muhamed) nuk mund të udhëzosh kë të duash, por është Allahu Ai që udhëzon kë të dëshirojë. Ai i njeh më mirë ata që janë të udhëzuar.”(el-Kasas, 56.)¹⁴

EMRAT E BUKUR TË ALLAHUT

Kur idhujtarët e Mekës i kërkuan Profetit tonë (a.s.), t’u tregonte për Zotin në të cilin besonte, zbriti surja el-Ihlas, e cila e prezantoi Allahun shkurt dhe me cilësitë më të spikatura:

“Thuaj: ‘Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amëshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Të!’”(el-ihlas, 1-4.)

Në Kuran janë përmendur **“Emrat më të bukur të Allahut”**.

Këta emra, të cilat quhen edhe *“esmau'l-husna”*, janë përmbledhur në këto tre ajete:

“Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër. Njohësi i së dukshmes dhe i së padukshmes, Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti!”

“Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër. Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqedhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!”

“Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që i jep trajtë çdo gjëje. Atij i përkasin emrat më të bukur; Atë e përleëndon gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”(el-Hashr, 22-24.)

Profeti ynë (a.s.), na ka përgëzuar, duke thënë: *“Allahu ka nëntëdhjetë e nëntë emra. Njëqind pa një. Kush i mëson përmendsh, duke ua ditur edhe kuptimin, hyn në xhenet. Allahu është tek dhe e do tekun.”*(Buhari, Muslim, Nesai, Tirmidhi, IbënMaxhe)

AI ËSHTË KRIJUESI I ÇDO GJËJE

Sipas atyre që kemi mësuar prej shumë ajeteve, Allahu Teala është i Vetmi që mban gjithçka në dorë, që merr dhe jep, që lartëson dhe poshtëron, që vdes dhe ngjall. Këtë e tregojnë më së miri këto dy ajete:

“Thuaj (o Muhamed): ‘O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë.’”

“Ti bën që nata të hyjë tek dita dhe dita të hyjë tek nata. Ti e nxjerr të gjallën prej së vdekurës dhe të vdekurën e nxjerr prej së gjallës. Ti i jep kujt të duash pa kufij.”(Ali Imran, 26-27.)

14. Muslim, iman 41-42; Tirmidhi, Tefsir 28; Ahmed b. Hanbel, Mu - ned, II, 434, 441.

AKTUALIZIMI I NAMAZIT

HETIM RRETH NDËRGJEGJES SOCIALE

Dr. Kerim Bulladë

Nuk ka dyshim se njëri prej farzeve më të rëndësishëm në fenë islame, pas dëshimit të shehadetit, është namazi. Po të lexohet Kurani, me qëllim që të nxjerrim prej tij një përfundim në lidhje me historikun e namazit, do të shohim se namazi si adhurim ekzistonte që nga krijimi i njeriut. Praktikën e sexhdes e shohim që me rastin e njeriut të parë, Ademit (a.s.), atëherë kur Allahu i urdhëroi melekët të bënin sexhde respekti ndaj njeriut. Kjo ngjarje mund të numërohet si një shenjë për të treguar se të gjithë njerëzit që do të vinin pas Ademit, do të kishin të bënin me sexhden.

Sipas vetë Kuranit, të gjithë profetët qenë urdhëruar të falnin namazin. Këtë të vërtetë e shpreh edhe ajeti, ku thuhet: **“Ne i dhuruam Ibrahimit Is’hakun dhe Jakubin si dhunti, dhe të gjithë i bëmë të drejtë. Ne i bëmë ata udhëheqës, që udhëzonin sipas urdhrin Tonë dhe i frymëzuam të bënin vepra të mira, të kryenin faljet dhe të jepnin zeqatin dhe ata vetëm Ne na adhuruan.”** (Enbija, 72-73) I njëjti urdhër i qe komunikuar edhe profetit Muhamed (a.s.) dhe umetit të tij. (Bakara, 43, 110; Nisa, 103; Ibrahim, 31; Isra, 78; Ta Ha, 132; Haxh, 78)

Profeti Ibrahim, i cili në përputhje me urdhrin e Allahut, i dërgoi personalisht, gruan e tij Haxheren dhe të birin Ismailin, nga Palestina në Mekë, ku i la pranë pusit të tharë të ujit zemzem, kur u nda prej tyre dhe kishte mbërritur te mali Kubejs, u kthye në drejtim të vendit, ku vite më pas, do të ndërtonte së bashku me të birin e tij Ismailin, Qaben dhe u lut me këto fjalë: **“O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit e mi,**

në një luginë që nuk mbillet, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin...” (Ibrahim, 37) Sikurse shihet, profeti Ibrahim (a.s.), kishte lënë aty një pjesë të pasardhësve të tij, që ata të falnin aty namazin. Ky fakt tregon se Qabja u ndërtua, që aty të falej namazi. Qabja është simboli i dëshimit të besimit monoteist, si pasojë edhe namazi është shenjë e këtij besimi, pra e fjalës së dëshmisë në besimin monoteist dhe praktikimi me vepra i kësaj dëshmie. Namazi e ruan njeriun nga devijimi prej fjalës së dëshmisë së besimit monoteist. Për këtë arsye, namazi është vërtetim me vepra se një person është besimtar.

Shumë ajete të Kuranit si: **“Unë të kam zgjedhur ty, prandaj dëgjo atë që po të shpallet! Me të vërtetë, Unë jam Allahu, s’ka zot tjetër përveç Meje, prandaj, vetëm Mua më adhuro dhe kryej faljen për të më kujtuar Mua!”** (Ta Ha, 13-14) **“Me të vërtetë, Allahu mori besëlidhjen e bijve të Izraelit dhe nga mesi i tyre caktoi dymbëdhjetë mbikëqyrës dhe u tha: “Unë jam me ju! Në qoftë se do të kryeni namazin...”** (Maide, 12) **“O Merjeme! Bindju Zotit tënd! Bëj sexhde dhe përkulu në ruku, bashkë me ata që përkulen (duke adhuruar Allahun)!”,** (Al-i Imran, 43) tregojnë se edhe profetët dhe bashkësitë e mëparshme janë urdhëruar të falin namazin dhe se nuk ka pasur asnjë popull në historinë e njerëzimit që nuk ka qenë i informuar në lidhje me sexhden dhe rukunë.

Namazi është një obligim që përfshin të gjitha llojet e adhurimeve. Të qenët rob i Zotit kokë e këmbë, arrihet



në sajë të namazit. Një nga parimet e pandryshueshme të besimit islam është që çdo njeri që hyn në moshën e pubertetit, e ka detyrim faljen e namazit dhe duhet ta përmbushë këtë detyrë sublime, deri sa ta dorëzojë shpirtin e tij te Zoti i gjithësisë.

Profeti Muhamed (a.s.), e ka shprehur me këto fjalë rëndësinë e namazit: "...Dijeni mirë se vepra më e mirë, që mund të kryejë një njeri, është namazi." (Ibn Maxhe, Taharet, 4) Ky hadith sqaron faktin se namazi është akti më i rëndësishëm në mesin e të gjitha llojeve të adhurimeve dhe të veprimtarive të lejuara fetarisht. Besimtari duhet të veprojë në atë mënyrë, që të tregojë se është i ndërgjegjshëm që asnjë punë apo detyrë nuk është më e rëndësishme se namazi.

Namazi është një adhurim shumë i rëndësishëm. Ashtu siç shprehet qartë edhe në hadithin, ku thuhet: "Mes njeriut dhe shirkut e kufrit qëndron braktisja e namazit" (Muslim, Iman, 134), namazi është akti kryesor që e mban një besimtar larg kufrit dhe shirkut. Namazi është edhe faktori bazë, që e dallon besimtarin nga mohuesi i fesë. Namazi është pengesa më e madhe kundër çdo lloj shirkut, mosbindjeje ndaj mësimave të fesë, presionit dhe padrejtësisë.

Aq i rëndësishëm është namazi si adhurim, sa edhe në luftë nuk lejohet braktisja e tij. Kurani tregon se si duhet falur namazi farz, në rast kërcënimi nga një sulm i mundshëm nga ana e armikut, duke theksuar në këtë mënyrë faktin që namazi nuk mund të lihet pa u falur. Kjo është arsyeja përse komandantët dhe ushtarët myslimanë nuk e kanë lënë pa falur namazin, kur kanë qenë në front të luftës. Ata nuk e patën braktisur vijën e luftës asnjëherë, derisa patën rënë dëshmorë të fesë (shehid), në sajë të emocioneve, pasionit, aksionit dhe trimërisë që u jepte falja e namazeve.

Mua personalisht më ka ndodhur të shkoja me autobus në vendlindje, me rastin e festës së Kurban Bajramit. E pyeta shoferin e autobusit se ku mendonte të

ndalej, për faljen e namazit të sabahut. "Mos u bëj merak!" – më tha shoferi. "Edhe unë e fal namazin, kështu që do të ndalim në një vend të përshtatshëm." Që nga ajo ditë, nuk harroj të bëj dua për shoferin e autobusit. Ai e ndali autobusin në një vend të përshtatshëm për të falur namaz. Në autobus ishin afërsisht gjashtëdhjetë vetë, së bashku me personelin. Afërsisht njëzet pasagjerë, ishin gra dhe vajza të reja myslimane, që praktikonin mbajtjen e mbulesës. Të gjitha këto po i shkruaj, që të kuptohet më mirë situata e asaj dite. Kuptohej shumë mirë se të gjithë po shkonin për të festuar Kurban Bajramin. Dita e nesërme, që dita kur haxhilerët do të shkonin në Arafat për të përmbushur njërin nga kushtet më të rëndësishme të adhurimit të haxhit. Fillonte periudha e kohës së vyer, kur këndohen tekbirot teshrik. Periudha kur pranohen duatë dhe lutjet që i bëhen Allahut. Megjithatë, ata që falën namazin qenë vetëm pesë vetë. Ky fakt më la një shije të hidhur në zemër. Umeti mysliman po përballet me problemin e moskorrektësisë në faljen e namazeve. Duket se dëshirat vetjake, puna, veprimtaria ditore kanë filluar t'u duken më të rëndësishme se namazi.

Namazi është adhurimi më i rëndësishëm, nisur edhe nga fakti që gjëja e parë, për të cilën ka për të dhënë llogari njeriu në botën tjetër është pikërisht vetë ky adhurim. Në lidhje me këtë çështje, profeti Muhamed ka thënë: "Gjëja e parë, për të cilën ka për të dhënë llogari njeriu në Ditën e Kiametit, është namazi. I lumi ai që i ka kryer me rregull namazet farz! Në qoftë se ai nuk i ka falur rregullisht namazet farz, atëherë do të shihet në regjistrin e punëve, në qoftë se ka falur namaze nafile. Ato namaze do të llogariten për t'iu plotësuar namazet farz, që ka lënë pa falur." (Ebu Davud, Salat, 149) Pra, namazi është shenja e besimtarit të vërtetë në këtë jetë dhe llogaria më e rëndësishme dhe më e vështirë që ka për t'u dhënë në jetën tjetër. Nëse mund të shprehemi edhe kështu, imani dhe namazi do të jenë pragu për të kaluar provimin e jetës tjetër.



FJALA

dhe dëgjimi

Osman Sëkëxhë

Kohët moderne janë kohët, ku “sundimi” i takon shifrës dhe jo kuptimit. Janë kohët ku fizika sundon mbi metafizikën. Për këtë arsye, gjuha dhe sytë e zemrës janë lënë pas dore duke ua lënë përparësinë gjuhës së sjelljes dhe syve të mendjes. Qëllimi nuk është të zmadhohet zemra, por stomaku. Vetëm ato gjëra, që sytë e mendjes i konsiderojnë gjëra të mëdha, meritojnë interesimin e njerëzve. Çdo gjë ndërtohet mbi atë që syri e quan të madhe dhe jo mbi atë që zemra e quan të tillë. Më parë, faltoret bëheshin gjigante, ndërsa sot janë apartamentet dhe qendrat tregtare që bëhen të mëdha. Madje i quajnë edhe qiellgërvishtës, si shenjë mburrjeje ndaj Zotit të vërtetë të qiellit. Me pak fjalë, njeriu modern sikur thotë për ditë: “Kur flas unë, të tjerët duhet të më dëgjojnë, se çdo gjë është e imja.” A thua se botën e ka grabitur prej Zotëruesit të vërtetë të tokës dhe të qiejve. Vetëm se e Vërteta flet dhe buçet, do apo nuk do njeriu, e Zoti bën atë çka dëshiron, duke e lënë njeriun nën gërmadhat e rreptencës së tij.

Çdo gjë flet me gjuhën e Hakut (të Vërtetit), dhe nuk flet gjëra të kota dhe pa kuptim, siç mund të ndodhë të flasë njeriu. Njeriu mund të gënjejë, të fyejë dhe të shpifë... Sorrat nuk gënjejnë, milingonat nuk përgojnë, bimët nuk shpifin... Atëherë, çdo

krijesë, me përjashtim të njeriut, thotë të vërtetën. Edhe njeriu është ftuar të flasë të vërtetën, por më parë duhet t’ia vërë veshin të Vërtetës Absolute. Kur i thuhet të meditojë, në të vërtetë prej tij kërkohet të dëgjojë gjuhën e krijesave përreth tij. Njeriu mund të dëgjojë me veshë, por më shumë do ta kuptojë këtë gjuhë me veshët e zemrës. Pra, meditimi është në një kuptim zemra që flet.

Njeriu duhet të dëgjojë. Ai duhet të dëgjojë, që të gjejë rehatinë. Pra, fjalët që duhet të dëgjojë njeriu, duhet të jenë të tilla, që ai të gjejë paqen dhe të marrë frymë i lehtësuar nga ato që dëgjon. Por kë duhet të dëgjojë njeriu dhe pse duhet ta dëgjojë atë? Kjo pyetje është e rëndësishme. Njeriu dëgjon atë gjë që e konsideron me vlerë. Ai dëgjon atë që dëshiron të bëjë. Atëherë ai duhet të dëgjojë atë që i jep vlerë njeriut dhe të cilit i ka borxh ekzistencën.

Njeriu duhet të dëgjojë para së gjithash fjalën e madhe. Ai duhet të dëgjojë fjalën e më të Madhit dhe të Atij që flet i Pari. Pra, fjalën e Allahut. Ai foli fjalën më të madhe, kur tha: **“Bëhu!”** Dhe çdo gjë u krijua me këtë Fjalë. Prandaj edhe njeriu ka nevojë për fjalën **“Bëhu!”** të Allahut. Në mënyrë që të ekzistojë, duhet që para së gjithash ta dëgjojë fjalën e të Gjithëdijshmit. Në bashkëbisedimin e parë mes nesh

dhe Allahut ne thamë fjalën "Po". Pra kemi një pohim që kemi bërë në lidhje me borxhin që kemi për të shlyer. Të qenët rob i Zotit arrihet duke përmbushur siç duhet këtë pohim që kemi bërë, sepse fjala më e madhe është fjala që i jepet më të Madhit. **Ata e mbajnë fjalën që i kanë dhënë Allahut dhe nuk e shkelin atë.** (Rad, 20.)

Ai që nuk e mban fjalën, është gati të tradhtojë në çdo situatë. Madje shkon deri aty, sa të mohojë edhe vetveten. Pra, tradhtia ndaj fjalës, në një kuptim do të thotë tradhti ndaj vetvetes, pasi ishte fjala **"Bëhu!"**, që të solli në ekzistencë. Po të mos kish-te thënë Krijuesi **"Bëhu!"**, ti nuk do të kish dalë në skenën e krijesave. Atëherë, të pasosh një fjalë, do të thotë të ekzistosh. Ata që duan të ekzistojnë, e mbajnë fjalën.

Zoti foli me njeriun në *el est bezmi'* dhe pas këtij bashkëbisedimi, njeriu u krijua me mish dhe me kocka. Zoti e pyeti njeriun rreth emrave të sendeve dhe pastaj e vendosi atë në xhenet. Pastaj ngjau ajo që ngjau. Nisi udhëtimi në vendin e provës, që quhet ndryshe dynja. Zoti foli sërish me njeriun nëpërmjet të dërguarve që zgjidhte nga mesi i njerëzve. Ai i foli njeriut edhe nëpërmjet shenjave të tjera, nëpërmjet bletës, vesës, reve, flokëve të borës... pra Zoti bashkëbisedon me ne në çdo moment. Mjafton që njeriu t'ua vërë veshin shenjave të Zotit dhe t'i dëgjojë ato pa bërë zë. Zoti ynë na urdhëron të dëgjojmë dhe të heshtim kur Ai flet, sepse vetëm ata që dëgjojnë dhe nuk bëjnë zë, kanë për t'u mëshiruar prej Zotit. **"Kur të lexohet Kurani, dëgjojeni dhe ndërprisni çdo bisedë! Vetëm kështu mund të fitoni mëshirën e Zotit!"** (Araf, 204.) Siç shihet, më parë njeriu ftohet të dëgjojë dhe më pas të heshtë, sepse vetëm ata që dëshirojnë të dëgjojnë për të mësuar diçka, nuk flasin. Njeriu nuk mundet që, në të njëjtën kohë edhe të dëgjojë edhe të flasë. Nëse ai e bën këtë gjë, atëherë nuk bën tjetër përveç se bie në kundërshtim me vetveten. Të mos harrojmë se edhe mushrikët flisnin dhe bënin zhurmë, sepse nuk dëshironin të dëgjonin fjalët e Profetit.

Edhe njeriu modern bën shumë zhurmë, sepse beson në hegjemoninë dhe pushtetin e zhurmës. Ai përpiket të qëndrojë larg fjalës se Zotit në shtëpi, në shkollë, në treg..., duke thënë fjalë pas fjale. Ai pandeh se gënjeshtria do të konsiderohet e vërtetë, sa më shumë zhurmë të krijohet rreth saj dhe mendon se do të arrijë hegjemoninë e zhurmës që krijon. Por-se "e gabuara nuk bëhet e saktë" me forcë. *"Ajo që e bën fjalën të fortë dhe të saktë, nuk është fakti se sa i lartë është zëri, por cilësia e saj."* E vërteta nuk zhduket dhe nuk humbet për shkak të mospërfilljes së saj. Mosmbajtja e fjalës së dhënë nuk është në dëm të fjalës, por të njeriut që e ka dhënë atë fjalë. Njeriu i edukuar në mësonjëtoaren e sekularizmit nuk ka braktisur vetëm të ardhmen duke braktisur fjalën, por ka braktisur edhe të kaluarën.

Njeriu mund të veshë çdo lloj petku. Kur ballafaqohemi me njerëz të ndryshëm në një dhomë të mbushur me njerëz, ne nuk e dimë se me kë kemi të bëjmë. Ata mund të jenë evlija, katilë apo qafirë. Vetëm **"Fjala"** e vesh njeriun me petkun e njerzillëkut përpara Zotit të tij. Fjala e Zotit i jep njeriut vendin që meriton dhe i takon në Ahiret. Prandaj, braktisja e fjalës të shpie në fundosje brenda baltovinës së *"esfeli safilin"*². Mysliman është njeriu që i vlerëson fjalët e Zotit të tij kur gjendet në shtëpi, në arë, në fshat, në qytet..., mysliman është njeriu tek i cili **"fjala"** gjen përjetimin e saj. A nuk është Fjala e Allahut ajo që e ka bërë njeriun mëkëmbësin e Zotit në tokë?

Njeriu është një udhëtar mes dy xheneteve. Qëllimi është të shkohet tek ndërprerja e këtyre dy skajeve. *"Siratul mustekim"*, në fakt është një urë mes këtyre dy xheneteve. Problemi për njeriun është nëse ai do të arrijë ta përfundojë në xhenet udhëtimin e tij, që ka filluar prej xhenetit, sepse në këtë udhëtim njeriu do të ndeshet me një sërë rrugicash të shtrembëra që i mbulon hija e dynjasë, fundi i të cilave është xhenemi në vend të xhenetit. Zoti na bëftë nga ata që e mbajnë fjalën dhe ecin në rrugën e drejtë!

Amin!

1. Bota ku Zoti i pyeti njerëzit: A nuk jam Unë Zoti juaj?

2. Në gjendjen më të ulët.



VEPRAT QË TË SHPIEN NË XHENET

Dr. Murat Kaja

TË MOS I BËSH SHIRK ALLAHUT

"Ai që vdes pa i bërë shirk Allahut, hyn në xhenet. Ndërsa ai që vdes duke i bërë shirk Allahut, hyn në xhehenem." (Muslim, Iman, 151)

Transmetohet se Ata Ibn Ebi Rebah, radijallahu anhu, ka thënë:

"Abdullah ibn Abbasi, radijallahu anhuma, më tha:

-A të të tregoj një grua që është prej banorëve të xhenetit?

Unë i thashë:

-Po, ma tregoj!

-E shikon këtë grua? Ja, kjo grua erdhi një ditë te i Dërguari i Allahut, (a.s.), dhe i tha:

-Unë jam e sëmurë me epilepsi dhe më hapen rrobat kur më zënë krizat. Lutjuni Allahut të më shërojë!

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

-Nëse duron, do të hysh në xhenet. Por sidoqoftë, nëse ti do, unë mund t'i lutem Allahut të të japë shërim.

Pastaj gruaja i tha:

-Unë e duroj sëmundjen, por lutu që të mos më hapen rrobat kur të më zënë krizat!

I Dërguari i Allahut, (a.s.), bëri dua për të. (Buhari, Merda 6; Muslim, Birr 54.)

TË MOS NXEHESH

"Mos unxeh dhe do të hysh në xhenet!" (Buhari, Edeb, 76.)

NDERSHMËRIA

"Ndershmëria në fjalë dhe në punë, të drejton drejt hajrit dhe mirësisë. Ndërsa mirësia të shpie në xhenet. Njeriu regjistrohet si i sinqertë te Allahu, duke thënë gjithmonë të vërtetën. Mashtrimi të zvarrit drejt devijimit. Ndërsa devijimi të shpie në xhehenem. Kur njeriu e përvetëson mashtrimin, te Allahu shkruhet si mashtrues." (Buhari, Edeb 69)

PESË BAZAT

"Kini frikë nga Allahu! Falni pesë kohët e namazit! Agjëroni muajin e Ramazanit! Jepni zekatin e pasurisë tuaj! Bindjuni prijësve tuaj! (Në këtë mënyrë) do të hyni në xhenetin e Zotit tuaj." (Tirmidhi, Xhuma 80)

"Më janë treguar popujt (e mëparshëm). Kam parë një peygamber që kishte pranë një grup të vogël prej tre deri në pesë vetash. Kam parë një peygamber tjetër, pranë të cilit gjendeshin një deri në dy veta. Kam parë një peygamber, që nuk kishte pranë asnjë. Në ato momente, më doli përpara një kallaballëk i madh. Pandeha se ishte umeti im. Mua më thanë: 'Ky është umeti i Musait. Ti shiko në horizont!' Pashë, ishte një siluetë (shumë) e madhe. Më thanë:

'Ja, ky është umeti yt. Ndërmjet tyre ka shtatëdhjetë mijë vetë, që do të hyjnë në xhenet pa llogari dhe pa unëshkuar. Ata janë njerëzit që nuk bëjnë magji, që nuk urdhërojnë për magji, që nuk i besojnë fatit të keq dhe që i besojnë Zotit.' (Muslim, Iman 374)

ZEMRA E BUTË

"Ka disa prej njerëzve që do të hyjnë në xhenet, zemrat e tyre janë të buta (dhe i mbështeten Allahut)." (Muslim, Xhenet, 27.)

Rebia Ibni Ka'b el-Eslemi, radijallahu anh, ka thënë:

"E kaloja natën bashkë me të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Ujin e abdesit dhe nevojat e tjera ia plotësoja unë. Si shpërblim për këtë, një herë më tha:

-Kërko (nga unë çfarë të duash)!"

Unë i thashë:

-Dua të jem me Ty në xhenet.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), më tha:

-A nuk dëshiron diçka tjetër?

Unë i thashë:

-Kjo është dëshira ime.

Pejgamberi, (a.s.), më tha:

"Atëherë më ndihmo për veten tënde duke falur shumë namaze dhe duke bërë shumë sexhde!" (Muslim, Salat, 226.)

SHKUARJA NË XHAMI

"Për atë që shkon në xhami në mëngjes apo në mbrëmje, për çdo rrugë Allahu përgatit për të një gosti në xhenet." (Buhari, Ezan 37; Muslim, Mesaxhid 285.)

"Atë që pret një pemë mbi rrugë, e cila shqetëson myslimanët, e kam parë duke notuar në mirësitë e xhenetit." (Muslim, Birr 129.)

"Një burrë pa një pemë mbi rrugë dhe tha: 'Betohem në Allahun se do ta heq nga këtu, në mënyrë që të mos shqetësojë myslimanët.' E hoqi atë dhe për këtë arsye u fut në xhenet." (Muslim, Birr 128.)

"Një burrë po ecte në rrugë dhe pa një degë ferre. E largoi atë nga rruga. Për këtë arsye, Allahu u kënaq nga ai dhe e faloi." (Buhari, Ezan 32)

"Ka dyzet sevape, më i larti prej të cilëve është t'i japësh dikujt amanet një dhi me qumësht për ta mjellë. Kush bën ndonjëren prej këtyre dyzet mirësive, duke shpresuar sevapin dhe duke u besuar premtimeve për to, Allahu e fut në xhenet." (Buhari, Hibe 35)

TË DOBËTIT, MENDJEMËDHENJTË

"A t'ju tregoj se kush janë prej banorëve të xhenetit? Janë ata njerëz që nuk u jep vlerë askush, për shkak se janë të dobët dhe se shihen si të tillë nga njerëzit, por nëse ata betohen se do të bëhet kështu, Allahu ua plotëson atë që thonë."

A t'ju tregoj se kush janë prej banorëve të xhehenemit? Janë ata njerëz me zemër të ngurtë, të ashpër dhe mendjemëdhenj, që ecin duke u mburrur." (Buhari, Ejman 9)

JETIMI

I Dërguari i Allahut, (a.s.), nxori gishtin tregues dhe gishtin gjatë, i hapi pak dhe tha:

"Unë dhe ai që përkujdeset për jetimin, do të jemi kështu në xhenet." (Buhari, Talak 25, Edeb 24.)

"Nëse dikush merr një jetim, që gjendet ndërmjet myslimanëve dhe e çon në shtëpinë e tij për ta ushqyer, përderisa të mos bëjë ndonjë mëkat të pafalshëm, Allahu Teala e fut atë në xhenet." (Tirmidhi, Birr 14.)

TRI VAJZA

"Kush përkujdeset dhe rrit tre fëmijë vajza, i edukon mirë ato, i marton dhe e vazhdon mirësinë e tij ndaj tyre, ai është prej banorëve të xhenetit." (Ebu Davud, Edeb 121)

"Gruaja që vdes, duke qenë bashkëshorti i kënaqur prej saj, është prej banoreve të xhenetit." (Tirmidhi, Rada 10.)

"Prindërit bëhen shkak, për të hyrë në xhenet nga dera kryesore." (Tirmidhi, Birr 3)

"Nëse një njeri shkon për të pyetur një të sëmurë për gjendjen e tij apo shkon për të vizituar dikë për hir të Allahut, një engjëlli i thotë kështu:

"Lum ti! Ke bërë një udhëtim të mirë. Vetes i ke përgatitur një vend strehimi në xhenet!" (Tirmidhi, Birr 64)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"Kur një mysliman shkon për të vizituar një vëlla të sëmurë mysliman, ai është afër një hurfe të xhenetit derisa të kthehet."

E pyetën:

-O i Dërguari i Allahut! Çfarë është hurfeja e xhenetit?

I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

"Është një frut i xhenetit." (Muslim, Birr 40-42)

VIZITA E TË SËMURIT

"Nëse një mysliman shkon në mëngjes dhe viziton një vëlla mysliman të sëmurë, shtatëdhjetë mijë engjëj i kërkojnë Zotit mëshirë për të deri në mbrëmje. Nëse e viziton në mbrëmje, shtatëdhjetë mijë engjëj kërkojnë falje për të deri në mëngjes. Dhe për atë njeri ka fruta të mbledhura në xhenet." (Tirmidhi, Xhenaiz 2. Çeçanërisht shih Ebu Davud, Xhenaiz 3; Ibn Maxhe, Xhenaiz 2.)

DASHURIA E NDËRSJELLTË

"Betohem në Allahun, në dorën e të cilit është shpirti im se nuk do të hyni në xhenet, përderisa të mos besoni. Ju nuk do të besoni, përderisa të mos doni njëri-tjetrin. A t'ju tregoj diçka që, nëse e bëni, do ta doni njëri-tjetrin? Përhapni selamin ndërmjet jush!" (Muslim, Iman, 93-94.)



Sevbani, radijallahu anhu, ka thënë:

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"Kush më jep fjalën se nuk do të kërkojë gjë nga njerëzit, unë i garantoj xhenetin."

I thashë:

-Unë ta jap fjalën.

Transmetuesi thotë se Sevbani nuk kërkonte gjë prej askujt. (Ebu Davud, Zekat 27)

XHENETI

E pyetën të Dërguarin e Allahut, (a.s.):

-Cila është ajo gjë që i shpie më shumë njerëzit në xhenet?

I Dërguari i Allahut, alejhissalatu ves-selam, tha:

"Respekti ndaj Allahut dhe morali i lartë."

XHEHENEMI

Ndërsa kur e pyetën:

-Cila është ajo gjë që i shpie më shumë njerëzit në xhenem, - i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

"Goja dhe organi gjenital!" (Tirmidhi, Birr 62)

TRICILËSI

"Unë i jam garant se atij që e lë debatin, edhe pse është në të drejtë, do t'i jepet një shtëpi në qoshe të xhenetit. Unë i jam garant se atij që nuk gënjen qoftë edhe me shaka, do t'i jepet një shtëpi në mes të xhenetit. Unë i jam garant se atij që është i dashur, do t'i jepet një shtëpi në vendin më të lartë të xhenetit." (Ebu Davud, Edeb 7)

TRE GRUPE

"Banorët e xhenetit janë tre grupe:

Kryetari i shtetit, që është i drejtë dhe i suksesshëm.

Ai që është i mëshirshëm dhe zemërbutë kundrejt të afërmeve dhe myslimanëve.

Ai që largohet nga fitimi haram dhe nuk kërkon gjë prej askujt, edhe pse familja e tij është e madhe." (Muslim, Xhenet 63.)

"Nëse dikush dëshiron të shpëtojë nga xhehenemi dhe të hyjë në xhenet, duhet të vdesë duke i besuar Allahut dhe Ditës së Gjykimit. Gjërat që kërkon t'i bëhen atij, edhe ai duhet t'ua bëjë të tjerëve..." (Muslim, Imare, 46)

"O njerëz! Përhapeni selamin, ushqeni të tjerët dhe vazhdojeni lidhjen e ndihmën me të afërmit tuaj. Falni namaz kur flenë njerëzit, në mënyrë që të hyni në xhenet me paqe." (Tirmidhi, Kijamet 42)

SUREJA IHLAS

Një burrë tha:

-Unë e dua suren "kul huvallahu ehad".

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

"Dashuria ndaj saj, do të të fusë në xhenet." (Buhari,



Ezan 106)

"Nëse dikush prej jush merr abdest bukur duke e plotësuar atë dhe pastaj thotë: Esh'hedu en la ilahe illallahu vahdehu la sherike leh ve esh'hedu enne Muhammeden abduhu ve rasuluh, atij i hapen tetë dyert e xhenetit. Ai mund të hyjë nga cila derë të dëshirojë." (Muslim, Taharet 17)

"Kush shkon në xhami në mëngjes e mbrëmje, për çdo rrugë Allahu i përgatit atij një gosti në xhenet." (Buhari, Ezan 37)

"Nëse një mysliman fal çdo ditë dymbëdhjetë rekate nafile për hir të Allahut përveç farzeve, Allahu Teala i bën një shtëpi në xhenet" ose "atij i bëhet një shtëpi në xhenet." (Muslim, Musafirin 103)

PESË ÇËSHTJE

Një burrë i tha të Dërguarit të Allahut, (a.s.):

-Më thuaj një punë që do të më fusë në xhenet!

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

"Adhuroje Allahun dhe mos i bëj shirk asgjë. Fale namazin, jepe zekatin dhe kujdesu për të afërmit!" (Buhari, Zekat 1, Edeb 10)

FSHATARI ARAB

Një fshatar arab erdhi te i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe i tha:

-O i Dërguari i Allahut! Më trego një vepër me të cilën mund të hyj në xhenet.

I Dërguari i Allahut (s.a.s.), i tha:

"Adhuroje Allahun pa i bërë shirk asgjë! Fali namazet farz! Jepe zekatin që është farz dhe agjëro Ramazanin!"

Beduini i tha:

-Beto hem në Allahun, në dorën e të cilit është jeta ime, se këtyre që më the nuk do t'u shtoj asgjë.

Kur fshatari u largua, Pejgamberi alejhisselam, tha:



"Kushdo që kënaqet duke parë një banor të xhenetit, le të shikojë këtë burrë!" (Buhari, Zekat 1)

"Umreja është kefaret për mëkatet që bëhen deri në umren tjetër. Ndërsa, shpërblimi i haxhit të pranuar, është vetëm xheneti." (Buhari, Umre 1; Muslim, Haxh 437.)

"Kush thotë: "Subhanallahi ve bihamdih (Unë e lartësoj Allahun nga cilësitë që nuk i kanë hije pozitës së Tij si Zot dhe e falënderoj Atë), për të mbillet në xhenet një pemë hurme." (Tirmidhi, Daavat 60.)

Ebu Musa, radijallahu anhu, ka thënë:

"I Dërguari i Allahut, (a.s.), më ka thënë:

-A të të tregoj për njërin nga thesaret e xhenetit?

Unë i thashë:

-Po, o i Dërguari i Allahut. Më tregoj!

Ai (s.a.s.), më tha:

"La havle ve la kuvete illa billah" (Nuk ka vullnet dhe as fuqi përveç se me Allahun). (Buhari, Megazi 38)

GJUHA DHE TURPI

"Kush më jep fjalën se do ta mbrojë gjuhën dhe nderin, unë i premtoj xhenetin." (Buhari, Rikak 23)

"Kush dëshiron të largohet nga xhehenemi dhe të futet në xhenet, le ta presë vdekjen duke i besuar Allahut dhe Ahiretit. Po ashtu, le të sillt ndaj të tjerëve siç dëshiron të sillen të tjerët ndaj tij." (Muslim, Imare 46.)

Një ditë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), u tha atyre që kishte pranë:

-Kush prej jush është agjërueshëm sot?

Ebu Bekri, radijallahu anhu, tha:

-Unë jam agjërueshëm, o i Dërguari i Allahut.

Pejgamberi, alejh-is-selam, tha:

-Kush ka marrë pjesë sot në një namaz xhenazeje?

Ebu Bekri, radijallahu anhu, tha:

-Unë, o i Dërguari i Allahut.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), i pyeti:

-Kush ka ushqyer sot ndonjë jetim?

Ebu Bekri, radijallahu anhu, tha:

-Unë, o i Dërguari i Allahut.

Krenaria e Gjithësisë, (a.s.), i pyeti:

-A ka ndonjë prej jush që ka vizituar ndonjë të sëmurë?

Përsëri Ebu Bekri, radijallahu anhu, tha:

-Unë, o i Dërguari i Allahut.

Pastaj i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

"Kush i bën në të njëjtën kohë këto vepra të mira, patjetër do të hyjë në xhenet." (Muslim, Fedailu's-Sahabe, 12.)

"Besimtari nuk ngopet me asnjë mirësi derisa të hyjë në xhenet." (Tirmidhi, Ilim 19.)

MËSIMI I DIJES

"Kush merr rrugën për të mësuar dije, Allahu Teala ia lehtëson atij rrugën për në xhenet. Engjëjt për shkak se i pëlqejnë, i mbulojnë ata me krahët e tyre. Krijesat që janë në qiej dhe në tokë, madje edhe peshqit në ujë, i përgjyrosen Allahut për t'i falur dijetarët. Epërsia e një dijetari kundrejt dikujt që merret vetëm me ibadet, është si epërsia e hënës katërmbëdhjetëshe ndaj yjeve të tjerë. Dijetarët janë trashëgimtarët e pejgamberëve. Pejgamberët nuk kanë lënë flori e argjend si trashëgimi, por dije. Ja pra, ai që e trashëgon këtë dije, ka fituar një kësmt shumë të madh." (Ebu Davud, Ilim 1; Tirmidhi, Ilim 19.)

SEXHDJA

Sevbanit, radijallahu anhu, i kishin kërkuar t'u tregonte një vepër që e shpie njeriun në xhenet dhe këtë kërkesë ia kishin shprehur tri herë. Pastaj Sevbanit, radijallahu anhu, transmetoi këtë hadith:

"Mundohu të bësh shumë sexhde, sepse Allahu të ngre një gradë dhe të fshin një gabim si shpërblim për sexhden që ke bërë." (Muslim, Salat 225)

ATA QË DUAN DHE QË NUK DUAN TË HYJNË NË XHENET

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

"Umeti im do të hyjë në xhenet, përveç atyre që nuk duan."

Sahabët e pyetën:

-O i Dërguari i Allahut! Kush nuk do të hyjë në xhenet?

Pejgamberi, (a.s.), tha:

"Ata që më binden mua, do të hyjnë në xhenet, ndër-sa ata që më kundërshtojnë, do të thotë se nuk e duan xhenetin." (Buhari, l'tisam 2.)

SHEHADETI

"Kush thotë si fjalë të fundit "La ilaha illallah (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut), do të hyjë në xhenet." (Ebu Davud, Xhenaiz 20)

Si duhet ta lexojmë **Kuranin**?

Allja Izzetbegović

Në fakt, Kuranin e kisha lexuar shumë herë, por asnjëherë më parë nuk e kisha pyetur veten se si duhet ta lexojmë në të vërtetë Kuranin. Kjo pyetje më nxiti të reflektoj. Prandaj vendosa që mendimet e mia t'i ndaj me ju.

Së pari, duhet të dimë se Kurani nuk mund të copëtohet në fragmente. Çdo ajet diskret i shkëputur nga konteksti nuk mund të na zbulojë plotësisht të vërtetën, ai mund të na japë vetëm një pjesë të saj. Nëse Kurani vlerësohet si i tërë, atëherë Ai e shpreh qartë të vërtetën. Është mëse normale të merren vetëm disa ajete për shqyrtim, por duhet të dimë që kjo është e mundur vetëm për një numër të caktuar ajetesh. Këtë mund ta krahasojmë me një mozaik. Në një mozaik copëzat e kuqe apo të zeza fitojnë kuptim vetëm kur bashkohen me copëzat e tjera. Shkëputja e një copëze nga mozaiku nuk mund të na japë një ide mbi bukurinë e gjithë mozaikut. Për ta kuptuar më mirë do të jap disa shembuj.

Ajeti **"O besimtarë! Është caktuar për ju kisasi' si shpagim për vrasje"** (El-Bekare, 178) mbështet si shpazim për krimin e vrasjes dënimi me vdekje. Kurse në një ajet tjetër këshillohet për falje e amnisti. **"Dënimi për të keqen është i njëjtë me atë të keq. Por, atë që fal dhe pajton, e pret shpërblimi i Allahut. Ai, në të vërtetë, nuk i do të padrejtët."** (Shura, 40)

1. Kisasi në të drejtën juridike islame është ligji i barazisë në ndësim.

Në një ajet tjetër **"O besimtarë! Mos ia ndaloni vetes gjërat e mira, të cilat Allahu ju ka lejuar dhe mos e kaloni kufirin! Vërtet, Allahu nuk i do ata që e kapërcejnë kufirin"** (El-Maide, 87) shembuj të tillë mund të shtohen më tepër.

Një personi që lexon Kuran, disa ajete mund t'i duken sikur janë në kundërshtim me njëri-tjetrin, por në fakt një gjë e tillë është e pamundur. Përkundrazi, e vërteta është krejt ndryshe. Disa urdhëresa të Kuranit, megjithëse janë në një harmoni të plotë me njëra-tjetrën, në pamje të parë, mund të duken kontraditore. Sepse Kurani nuk kërkon prej nesh të bëjmë vetëm një veprim të caktuar, përkundrazi kërkon të bëjmë dy veprime njëherësh ose thënë ndryshe. Kurani nuk kërkon prej nesh të punojmë vetëm për botën tjetër, në të njëjtën kohë kërkon që ne të punojmë edhe për këtë botë. Pra, thekson se nuk mund të ekzistojë asnjëra pa tjetrën. Prandaj, ashtu si Myslimanët, që megjithëse me të drejtë, nuk mendojnë asgjë përveç ndëshkimit nuk mund të arrijnë në nivelin e imanit të përsosur, edhe myslimanët që mendojnë vetëm mëshirën nuk mund të arrijnë këtë nivel. Kështu pra, mysli man i pjekur është individi i vetëdijshëm dhe i matur për të dyja, ndëshkimin dhe mëshirën.

Arritja e përfundimeve të sakta është e mundur vetëm përmes qasjes në tërësi të Kuranit dhe jo duke marrë në konsideratë një fragment të vetëm. Kjo është metoda më e mirë dhe e saktë për të kuptuar Islamit dhe mesazhin Islam.

Një tjetër çështje që dua të prek këtu është domosdoshmëria e leximit periodik dhe të vazhdueshëm të Kuranit. Mendoj se kjo është mënyra më e mirë për të zbuluar dritën dhe rrezet e Kuranit. Sepse çdo lexim i tij na ndihmon për të kuptuar diçka të re. Kurani ka ardhur deri

tek ne pa pësuar as ndryshimin më të vogël. Por përballë Kuranit qëndron ndryshimi që kemi pësuar ne, bota dhe mjedisi që na rrethon. Këto ndryshime u bënë shkak për përqendrimin tonë në fusha të tjera, duke i hapur rrugë neglizhencës së plotë ndaj Kuranit. Dhe papritur kuptuam se ishim bërë plotësisht gafil ndaj jehonës që lëshonte leximi i Kuranit në zemrat tona.

Çdo mysliman mund ta vërtetojë këtë nga përvoja e vet që ka përjetuar me Kuranin. Por unë këtu dua të jap disa shembuj nga përvoja ime personale.

Shumë kohë më parë, gjatë leximit të Kuranit përqendroheshin më shumë në ajetet që trajtonin xhihadin, drejtësinë dhe veprat. Kisha një fletore të vogël shënimesh të mbushur plot me ajete. E kujtoj shumë mirë se një nga ajetet që trajton personalitetin e individit mysliman në lidhje me refuzimin dhe kundërshtimin e armiqve dhe despotizmit ishte ajeti: **“Kur ata i godet ndonjë padrejtësi e madhe rezistojnë duke ndihmuar njëri tjetrin.”** (Shura, 39)

Ndërsa në çdo rast, gjatë për-siatja mbi ajetet e lartpërmendura, më tërhoqin vëmendjen ajetet që flisnin për Allahun, dhe karakterin kalimtar e të përkohshëm të jetës së kësaj bote. Këto ajete e nxisin njeriun të mendojë, jo të veprojë... Edhe sot e kujtoj shumë mirë ndikimin e fortë dhe pushtimin që më bënë ajetet që deklarorin se përveç Allahut çdo gjë tjetër do të zhduket. Sepse premtimi i Allahut është i vërtetë. **“Çdo gjë në tokë do të zhduket, e do të mbetet vetëm Zoti yt plot Madhëri dhe Nder”**

(Er-Rrahman, 27/28) Pra, Allahu ishte para se të krijohet universi, është tani që po flasim dhe do të jetë edhe mbasi të shkatërrohet universi. Kjo është e vërteta e pandryshueshme. Kur nëna ime udhëtoi për në botën tjetër isha i mbuluar me hidhërim dhe pikëllim. Ajetet **“O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!”** deri atëherë nuk i kisha dalluar. Por pikërisht në këto gjeta çuditërisht ngushëllimin e vërtetë.

Kurani në një gjendje lartëson shariatën, në një gjendje xhihadin, kurse në një gjendje tjetër është ngushëllim përballë vështirësive pazgjidhje që të përball jeta. Pra Kurani tërheq vëmendjen sipas gjendjes sonë shpirtërore. Ndërsa në një rrethanë na tërheq vëmendjen në një kah, në një tjetër na tërheq vëmendjen në një drejtim tjetër.

Kjo rezonancë e përmbajtjes së Kuranit siç është e lidhur me gjendjen individuale të personit është po aq e lidhur edhe me gjendjen e shoqërisë dhe kushtet historike. Atëherë gjendet që kanë lidhje me shoqërinë dhe kushtet historike, si: përçarja e shoqërisë për shkak të ndarjes etnike, barazia dhe të drejtat e gruas, etj, na bëjnë

t'i japin përparësi dhe të përqendrohemi në disa ajete të caktuara. Në rastet kur shkelet e drejta e besimit, menjëherë bëhet aktual një ajete i shkurtër dhe i qartë **“Nuk ka dhunë në fe.”**

Në si myslimanë nuk bëjmë dallime mes ajeteve. Por jomyslimanët janë këmbëngulës për ta shfaqur ajetin e mësipërm, si ajetin më të mrekullueshëm në shprehjen e tolerancës fetare. Kjo është një temë që mund të trajtohet më gjatë, por është përtej qëllimit të këtij artikulli.

Duhet të përcaktojmë qartë çfarë kemi për qëllim nga leximi dhe dëgjimi i Kuranit. Meqenëse në përgjithësi myslimanët nuk e kuptojnë Kuranin, disa njerëz e kanë konsideruar shumë pak të dobishëm leximin e tij. Unë nuk jam i këtij mendimi dhe në lidhje me këtë mendoj se është rasti të kujtoj një ngjarje që nuk do ta harroj kurrë. Shumë vite më parë mora pjesë në një konferencë islame ndërkombëtare. Konferenca organizohej në një nga qytetet më të mëdha të Evropës. Në konferencë merrnin pjesë shumë dijetarë dhe intelektualë për të paraqitur mendimet dhe kërkimet e tyre në lidhje me

rindërtimin e mendimit Islam. Çdo ditë në fillim dhe mbarim të konferencës këndohej Kuran nga hafizë të njohur nga e gjithë bota islame. Pjesëmarrësit dëgjonin me një interes të jashtëzakonshëm fjalimet e dijetarëve dhe mendimtarëve Islam. Por gjatë fjalimit dëgjonim dhe shikonim qindra pjesëmarrës në konferencë ndërsa pëshpëritnin me njëri-tjetrin, lëviznin karriget dhe merreshin me gjëra të vogla. Kur fillonte leximi i Kuranit papritmas ndalonin së foluri dhe çdo gjë e mbulonte qetësia. Të gjithë ishin të përqendruar në dëgjimin e këndimit të Kuranit. Leximi i Kuranit i ngjasonte një lumi që rrjedh i qetë dhe në hesh-

tje nëpër shtratin e tij. Pastaj Kurani i dërgonte larg në kreshtën e një ujëvare. Por kulmi i ngjarjes ishte Dita e Fundit, e cila nuk mund të tregohet, ajo vetëm mund të përjetohet. Për të mbyllur konferencën, hafizi kishte zgjedhur si dhuratë suren Rrahman. Kjo është një sure shumë e njohur e Kuranit, e cila me bukurinë e stilit dhe harmoninë midis ajeteve e mrekullon njeriun. Veçanërisht ajete që përsëritet **“Cilën të mirë të Zotit tuaj po mohoni?”**, i cili sikur i tërhoqi në fund të oqeanit dëgjuesit.

Kurse unë ndjeva që ajetet që po këndoheshin i kuptoja tërësisht. Gjatë konferencës e ndjeva më afër veten dhe pjesëmarrësit. E njëjta gjë dukej edhe në fytyrat e të tjerëve. “Sikur donin të thoshin: A nuk e shikoni? A nuk jemi të gjithë vëllezër në Islam?”

Pas kësaj ngjarjeje kuptova rëndësinë e leximit të Kuranit duke e kuptuar. Zemrat e besimtarëve në një mënyrë apo në një tjetër mund ta kuptojnë Kuranin. Myslimanët janë përgjegjës për ta kuptuar atë.



Shehadet do të thotë Aksion

Zybejlr Jetik

Shehadeti është një aksion individual, i cili sjell përgjegjësi që përfshijnë të gjithë jetën. Secili prej nesh, "si një individ" beson se "nuk ka zot tjetër përveç Allahut të Madhëruar" dhe dëshminë tonë e shprehim me "një theks individual". Përsëri dëshmojmë si një individ edhe të vërtetën se i Nderuari ynë, alejhis-salatu ves-selam, Muhamedi, i cili kishte emër të bukur dhe vetë ishte i bukur, është "rob dhe i Dërguar" i Allahut të Madhëruar.

Pas kësaj dëshmie individuale, në axhendën tonë hyn "besimi në Allahun" dhe "pranimi i të Dërguarit të Tij". Ne besojmë me këtë dëshmi individuale. Pastaj ndërtojmë veten dhe jetën tonë mbi këtë bazë besimi. Pas kësaj faze, bashkë me Allahun e Lartësuar, i Cili është dëshmitar për secilin dhe për çdo gjë, edhe i Dërguari i Tij i Nderuar, sallallahu alejhi ve sellem, do të jetë dëshmitar për ne.

Nëse ngjarja studiohet në kontekstin e përgjithshëm, vihet re se në fillim të këtij procesi zhvillimi ka një "individ" i cili vepron dhe zgjedh si një "person". Ndërsa para dëshmisë së tij nuk ka person në aspektin e procesit.

Individi nuk e fillon punën duke thënë se "unë kam besuar kështu e ashtu sipas filanit". Zgjedhjen e bën vetë drejtpërsëdrejti, i vetëm dhe vetvetiu. Kështu që përcakton Qenien që do të adhurojë, e zgjedh atë dhe dëshmon për këtë zgjedhje që ka bërë.

Edhe nëse në rrjedhën e ngjarjes është dikush që e këshillon, në të vërtetë nuk ka ndonjë që i prin apo që i tregon rrugën. Ai e zgjedh vetë atë, e përcakton dhe këtë e shpreh me një lloj dëshmie si një dëshmitar. Pastaj çdokush që mund të ketë zgjedhur, bëhet prijës për të dhe fillon t'i tregojë rrugën.

"Aksionisti" apo më drejt, përcaktuesi i procesit nuk është ai që këshillon, por ai që përvetëson, i cili përfaqëson, atë gjë që i sugjerohet, -ose përkundër të gjithave- refuzon. Zgjedhjen nuk e bën sugjeruesi,

por ai që pranon sugjerimin si pozitiv ose që e refuzon atë. Pra, "individi".

Çështja është kështu: Këtu nuk zgjedh prijësi pasuesit e tij, por pasuesit zgjedhin prijësin e tyre. Ajo që mund të bëjë prijësi është vetëm një propozim i hapur për pranimin dhe refuzimin. Vetëm kaq.

Për këtë arsye, individ i nuk mund të fajësojë askënd për zgjedhjen që ka bërë dhe përgjegjësinë e zgjedhjes nuk mund t'ia hedhë askujt. Në rast të kundërt, ai lidhet me personin që ka zgjedhur duke menduar se është konsekuent në zgjedhjen që edhe ai ka bërë. Për shkak të kësaj lidhjeje ndjen respekt ndaj "tij". Ndërsa nga ana tjetër fillon të besojë, të sillet dhe të jetojë sipas këshillave dhe kënaqësisë së atij që ka zgjedhur.

Në Ditën e Gjykimit, në atë ditë të madhe, kur njerëzit do të merren në llogari, disa do të mundohen të justifikohen duke thënë: "Ne kemi pasuar prijësit tanë..." Për këtë arsye, ata të cilët kanë bërë një zgjedhje të pavlefshme dhe të gabuar do të hidhen në zjarrin e xhehenemit bashkë me prijësat që kanë zgjedhur.

Shprehja e dëshmisë së myslimanëve me "fjalën e shehadetit" në të njëjtën kohë është edhe një akt. Një akt që bëhet me Krijuesin. Zbatimi i dispozitave të aktit nga ana e myslimanit bën që edhe Allahu i Madhëruar të krijojë realitete sipas kërkesës së aktit.

Dëshmia bëhet duke theksuar dy pikat e shehadetit, i cili formalisht shprehet : Ekzistimi i Allahut të Lartësuar, e jo i zotave të tjerë dhe fakti se i Nderuari ynë, alejhis-salatu ves-selam, është i Dërguari i Tij...

Pranimi i të Nderuarit tonë, alejhissalatu vesselam, si "Lajmëtar", automatikisht lind përfundimin se duhen pranuar edhe ato që sjell Lajmëtari, pra Lajmin. Ja në këtë pikë "Libri" hyn në axhendën tonë. "Libri" do të jetë mes nesh deri në Kiamet si një Dritë nga i cili mund të shikojmë, mësojmë dhe ndjekim mesazhin e të "Dërguarit" pasi ai të ndahet nga mesi ynë.

Tashmë ne jemi dëshmitarët e Librit. Kështu edhe Libri do të jetë dëshmitari ynë. Dëshmia e të Dërguarit për ne do të vazhdojë në kontekstin e librit. Me Librin... Sepse ai Libër është amaneti i vetëm që na është lënë nga i Dërguari. Libri është lënë në sigurinë tonë. Siguria jonë dhe siguria e besimit tonë arrihet me anë të librit.

Tashmë "prijësi", domethënë imami, do të jetë Libri Fisnik.

Ky është një amanet i dyanshëm.

Në njërën anë ndodhet shtrirja e përcaktimit të shkaqeve të rezultateve. Shtrirja ku myslimani në kontekstin individual dhe masiv heton nga dhe pse burojnë "fatkeqësitë" me të cilat përballet... Domethënë një orientim që e drejton atë për t'u pënuar, për të kërkuar falje dhe për të rregulluar veten...

Ndërsa në anën tjetër është "irshadi", ndriçimi, përcaktimi i drejtimit dhe mësimi i dispozitave të dëshmisë... Kjo është shtrirja që ne mund ta quajmë harta e fetarisë së myslimanit.

"Irshad", domethënë orientim në rrugën e drejtë, pjekuri, arritje e përsosmërisë, edukim i njeriut, realizim i veçorive, domosdoshmërive për të qenë njeri i vërtetë.

Për këtë arsye, rrugët e jetës pa probleme gjenden në atë Libër. Po ashtu edhe mënyrat e zgjidhjes së problemeve... Historitë në lidhje me kohët e shkuara, veçanërisht, hedhin dritë mbi kontekstin e dytë, ndërsa për kontekstin e parë mbartin të dhënat paralajmëruese.

Për këtë arsye, myslimani që ka lidhje amaneti me "Librin Fisnik", nën dëshminë e Allahut të Madhëruar, të Dërguarit dhe të Librit, e ka për detyrë t'u dëshmojë popujve të tjerë. Pra, ai ka një përgjegjësi specifike të tillë.

Ky pozicion apo obligim nuk është thjesht një problem që i përket një aksh personi nga umeti, por është çështja dominuese e çdo myslimani në kontekstin individual. Për këtë, myslimani nuk ka të drejtë apo arsye që të thotë: "A nuk ka njeri?" Sepse ai është vetë.

Të jesh dëshmitar e bën të domosdoshme këtë. Pra, të gjendesh në shoqërinë për të cilën do të dëshmosh, t'i kryesh si një "dëshmitar" aksionet në lidhje me parimet që do të dëshmosh dhe t'ia dalësh t'i realizosh ato.

Sikundër hapjes së derës së thirrjes së të shtypurve "A ka njeri?", gjëja që duhet të bëjë myslimani në nuancën e dëshmisë është që të thotë: "Po, urdhëro, unë jam këtu!..."

Të jesh shpëtimtar dhe jo të presësh shpëtimtarin...

Kur ta praktikojmë në jetë parimin, "Ai që vret

një njeri është sikur të ketë vvarë të gjithë njerëzit dhe ai që shpëton një njeri është sikur të ketë shpëtuar të gjithë njerëzit", me të vërtetë do ta kuptojmë se vetë ne jemi shpëtimtari, se mbi të gjitha kemi këtë detyrë dhe do të shpëtojmë së kërkuari e së prituri për shpëtimtarin.

Shpëtimi i myslimanëve do të realizohet vetëm me këtë mënyrë.

Myslmani nuk pret, por është një njeri që e përjeton dëshminë si një dëshmitar.

Dëshmia në fillim është një aksion "individual". Kur të shtohen dhe shumohen aksionet individuale, popullarizohet edhe dëshmia.

Myslmanët nuk duhet të presin dikë për t'u prirë njerëzve, por duhet të nxjerrin prijësa nga mesi i tyre që t'u prijnë ngjarjeve me aksionet e tyre.

"Domethënë se urdhëri: "Unë jam i pari i myslimanëve!" mendoj se është i mjaftueshëm që të kuptojmë nevojën dhe obligimin e këtij qëndrimi. Çdo mysliman është i detyruar që të jetë i pari dhe të sillet si i tillë. Vess-elam...





Të duash

Sadik Dana

Ebu Hurejra, radijallahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

“Rreth arshit të Allahut ka frone prej drite. Në to do të ulen njerëz, rrobat dhe fytyrat e të cilëve do të ndriçojnë. Këta nuk janë as peygamberë dhe as dëshmorë, por peygamberët dhe dëshmorët do t'i kenë zili.”

E pyetën të Dërguarin e Allahut, sallallahu alejhi ve sellem:

-Kush janë këta o i Dashuri i Allahut?

Ai (s.a.s.), tha:

“Ata janë njerëzit që janë dashur për hir të Allahut, janë takuar për hir të Tij dhe e kanë vizituar njëri-tjetrin për hir të Allahut.” (Nga Nesaiu.)

Pastaj shtoi:

“Atij që shkon të vizitojë një (vëlla mysliman) për hir të Allahut, një engjell i thërret nga mbrapa: ‘Ti je i mirë dhe vizita jote është e mirë. Edhe xheneti është përgatitur për ty si një vend i mirë.’”

Abdullah bin Umer, radijallahu anhuma, ka thënë:

“Nëse agjëroj përgjatë gjithë jetës, nëse e kaloj natën me adhurim pa fjetur fare, nëse e jap pjesë-pjesë pasurinë time në rrugë të Allahut dhe, nëse vdes në këtë gjendje, por në zemrën time nuk ka ndjenjë dashurie ndaj atyre që i binden Allahut dhe ndjenjë urrejtjeje ndaj atyre që nuk i binden, nuk mund të kem asnjë dobi nga të gjitha ibadetet e lartpërmendura.”

Ibn Mes'udi, radijallahu anhu, thotë:

“Edhe nëse njeriu bën ibadet shtatëdhjetë vjet ndërmjet ruknit dhe makamit Ibrahim në Qabe, Ditën e Gjykimit përsëri do të tubohet me ata që do.”

Dikush erdhi te i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem dhe i tha:

-Kur do të ndodhë Kiameti?

Krenaria e Gjithësisë, sallallahu alejhi ve sellem, i tha:

-Çfarë ke përgatitur për Kiametin?

Ai iu përgjigj:



-Kam përgatitur dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij.

Pejgamberi, sallallahu alejhi ve sellem, i tha:

"Njeriu është bashkë me atë që do."

Shenja e dashurisë së pastër për hir të Allahut Teala është mungesa e dëshirave të ulëta të kësaj bote, pa pretendimin për të përfituar prej saj. Kur dashuria është njollosur me një sëmundje të tillë, mund të pastrohet vetëm me eliminimin e njollës. Nëse dikush nuk e mbështet miqësinë dhe shoqërinë në interesa të kësaj bote, atëherë shoqëria e tij vazhdon pafundësisht.

Kushdo që i kryen plotësisht detyrat ndaj Allahut, Ai e furnizon atë me dijen për të njohur veten dhe gabimet e tij. Atë e njeh me moralin e lartë dhe edukatën e bukur. Në këtë mënyrë, i jep sukses për të paguar çdo detyrim dhe obligim që ka borxh.

Hazreti Abdulkadir Gejlani, kuddise sirruhu, thotë:

"Kur robi njeh Allahun, njerëzit nuk bëjnë vend në zemrën e tij, dalin dhe bien siç bien gjethet e thata nga

pemët. Në këtë mënyrë, zemra e tij ngelet e pastër plotësisht nga njerëzit. Njeriu që arrin në këtë gradë, është shpirtërisht vetëm me Allahun dhe i verbër e i shurdhër kundrejt njerëzve, nuk i shikon ata dhe nuk ua dëgjon atyre fjalët."

Në një hadith fisnik thuhet:

"Më i dashur dhe më i afërt me Allahun është ai njeri që mban lidhje me të tjerët dhe që të tjerët duan të lidhen me të. I tillë është edhe besimtari, mik me të tjerët dhe me të cilin mund të lidhet natyrshëm miqësi..."

Personi që ka zgjedhur vetminë dhe asketizmin për hir të Allahut në rastet kur krijon miqësi me njerëz të tjerë nuk duhet ta humbasë natyrën e personalitetit të tij miqësor.

Më të lumtur në Ahiret janë ata që e duan më shumë Allahun, sepse Ahiret do të thotë t'i drejtohesh Allahut Teala dhe të arrish lumturinë e takimit me Të.

Ç'gëzim më të madh mund të ketë, se qëndrimi i vazhdueshëm me të dashurin, pa pasur asnjë pengesë dhe duke e arritur Atë përgjithmonë pas një mallëngjimi të gjatë?

Por këto mirësi maten me fuqinë e dashurisë së të dashurit. Sa më e fortë të jetë dashuria, aq më shumë shtohet edhe kënaqësia. Robi mund ta fitojë kënaqësinë e Allahut të Madhëruar vetëm në këtë botë.

O Zot! Na bashko me të dashurit e Tu dhe mos na ndaj prej tyre! Ata janë banorë të xhenetit, ndërsa ata që nuk i duan të dashurit e Tu, janë banorë të xhehenemit.

Mos na ndaj nga ata, në mënyrë që të marrim sa më shumë prej nurit të tyre.

Kënaqësia jote arrihet duke të adhuroar vetëm Ty.

Kushti i adhurimit është zbatimi i përpiktë i urdhrave me dashurinë që na ke falur e me orientimin e Islamit dhe largimin nga ndalesat e Tua.

O Zot! Na bëj t'i duam të dashurit e Tu! Na bëj të duam çdo mik Tëndin, që meriton të duhet, ashtu siç na ke bërë të duam të dashurin tënd, Muhamedin, sallallahu alejhi ve sellem! Na bëj t'i duam me radhë, ehli bejtin, sahabët e nderuar dhe të gjithë ata që duan Islamin e i shërbejnë atij!

O Zot! Mos na privo nga mirësia e dashurisë!

Amin!



Një Ajet

Çdo periudhë e historisë së njerëzimit ka pasur kushtet e veta karakteristike në të cilat besimtarët gjithmonë janë përballur me një sërë pengesash dhe vështirësish. Por me gjithë këtë, besimtarët gjithmonë i ka karakterizuar këmbëngulja për ta adhuruar Allahun dhe përpjekja për një jetë të ndershme dhe fisnike. Vlen të theksohet se edhe në ditët tona, ata që adhurimin ndaj Allahut e kanë kthyer filozofinë e jetës së tyre, përballen me shumë vështirësi.

Orvajtjet për të formuar një identitet islam pasiv dhe për ta zhveshur Islamin nga jeta reale nuk kanë të sosur. Jeta shpirtërore e njerëzve vazhdimisht është e cenuar dhe nëpërkëmbur. Të gjitha zhvillimet negative që ndodhin në botën e jashtme, krejt natyrshëm pasyrohen në botën e brendshme të njeriut përmes pavendosmërisë, dyshimeve dhe për pasojë, ndodh një ftohje shpirtërore. Në këtë proces, ndjenjat e besimit dobësohen dhe ndjeshmëria ndaj normave morale ulet.

Të gjendur përballë rënies së personalitetit njerëzor dhe humbjes së vlerave shpirtërore një pjesë e besimtarëve kanë shfaqur një qëndrësë të lartë, kurse pjesa tjetër ka mbajtur një pozicion krejt indiferent. Allahu me një bujari të papërshtuar ka shfaqur para njeriut të gjitha mirësitë dhe bukuritë, kurse njeriu në vend që të falenderojë, zhytet gjithnjë e më shumë në vorbullën vetëshkatërruese të rebelimit.

Atëherë cila është rrugëzgjdhja? Përgjigjet mund të jenë nga më të shumtat, por një gjë është thelbësore dhe e sigurt, "rishikimi i vetes sonë". Parë nga ky këndvështrim, gjëja e parë që duhet të bëjmë është të rishikojmë

"...shpejtoni për tek Allahu..."

(Dharijat, 50)

marrëdhëniet tona me Allahun e Lartësuar. Sepse kjo është thelbësore dhe të gjitha çështjet e tjera varen prej kësaj. Koncepti bazë në marrëdhëniet e njeriut me Allahun është padyshim *takvaja* (devocioni). Në një kuptim *takva-ja* shpreh strehimin tek Allahu, sepse nga ana etimologjike kjo fjalë do të thotë mbrojtje, ruajtje. Mbrojtja e vërtetë dhe ruajtja më e sigurt, më e fortë dhe e vetmja është mbrojtja që vjen prej Allahut. *Takvaja* është ushqimi kryesor i shpirtit në rrugën e jetës.

Gjatë rrugës së jetës, me uljet dhe ngritjet e saj, besimtari për asnjë moment nuk e shkëput lidhjen që ka me Krijuesin, pra vazhdimisht i drejtohet dhe gjen strehë tek Ai. Në këtë mënyrë nuk e humbet për asnjë çast gjallërinë shpirtërore, por i frymëzuar nga fjala e Allahut vazhdon me gjithë përpjekjet për t'u ngjitur në majat më të larta. Siç shprehet edhe në ajetin kuranor, strehimi tek Allahu shpreh përpjekjen për të arritur sa më shpejt te Ai, dhe kjo është shumë e arsyeshme sepse, fundja, vendqëndrimi i përhershëm është vetëm pranë Allahut. Ky vendqëndrim duhet të jetë synimi i çdo besimtari. Meqenëse kjo rrugë të çon tek Allahu, besimtari duhet përgatitur për të arritur qëllimin, si mysliman i palëkundur e i vendosur, pa u ndikuar aspak nga zhvillimet negative rreth tij apo nga joshjet e përkohshme të kësaj bote. Siç u shpreh Jusufi (a.s.) në lutjen e tij drejtuar Allahut xh.sh. **"O Krijues i qiejve dhe i Tokës, Ti je Mbrojtësi im në këtë botë, dhe në botën tjetër! Bëj që të vdes si mysliman dhe më shoqëro me punëmirët!"**

Transmetohet nga Aishja (r.a.),
se Pejgamberi -sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem-, ka thënë:

*"Allahu është i kënaqur me atë që kur kryen një punë,
e kryen atë në formën më të mirë të mundshme."*

Besimtarët janë urdhëruar t'i kryejnë detyrat shpirtërore apo materiale qofshin, në mënyrë cilësore. Ai që e kryen punën e ngarkuar në mënyrën më cilësore dhe të mirë ka çuar në vend përgjegjësinë që ka para Allahut dhe para shoqërisë. Kush e kryen punën si duhet në çfarëdo lloj fushe qoftë, ai është i fituar si në këtë botë, ashtu edhe në tjetrën. Kurse një person që anashkalon punën dhe nuk e bën siç duhet, së pari ka gënjyer veten.

Zhvillimi dhe përparimi në çdo fushë, vjen kur secili bën siç duhet punën që i takon. Progresin dhe zhvillimin e meritojnë vetëm ata që e kryejnë detyrën e dhënë në mënyrën më cilësore dhe të mirë. Suksesin në këtë botë Allahu nuk ia jep askujt sipas përkatësisë fetare, por sipas përpjekjes dhe punës, pa dallim, në është mysliman, besimtar apo jo.

Suksesi i vërtetë u takon atyre që pas përpjekjeve të mundshme njerëzore, i mbështeten tërësisht Allahut (xh.sh.) Allahu nuk i jep sukses një popull pa bërë përpjekjet e duhura, vetëm se ky popull është besimtar. Gjendja e botës islame sot është shembulli tipik i kësaj të vërtete. Në të shkuarën, kur paraardhësit tanë, me të cilët mburremi sot, krijuan një qytetërim shembull për të gjithë njerëzimin, e arritën këtë sukses duke punuar me seriozitet, me bindje dhe sinqeritet. Suksesi i arkitekt Sinanit, i cili me kryeveprat e tij sfidon kohën, ka ardhur si pasojë jo vetëm

gjenialitet të tij, por edhe e dëshirës dhe përpjekjes titanike për të krijuar vepra cilësore. Niveli i zhvillimit të një shoqërie është i ngjashëm me një grup provëzash që komunikojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet gypave, kur hidhet ujë në një provëz, niveli i ujit ngrihet në të gjitha provëzat, e njëjta dukuri shfaqet edhe tek niveli i zhvillimit të një shoqërie, për shembull, mosfunksionimi siç duhet i institucioneve arsimore, ndikon negativisht te individët e veçantë, por edhe te institucionet e tjera. Për rrjedhojë, funksionimi i institucioneve në një shtet është i ndërvarur, nuk mundet që një pjesë e institucioneve të funksionojë mirë dhe pjesa tjetër keq. Pra funksionimi i institucioneve është i lidhur drejtpërdrejt me nivelin e shoqërisë sepse ata që punojnë në këto institucioneve janë individët e kësaj shoqërie dhe niveli i këtyre institucioneve nuk mund të jetë më lart se sa niveli i shoqërisë. Në një shoqëri të tillë është e shpeshtë dukuria, ku individët apo institucionet akuzojnë njëri-tjetrin për mosmbarëvajtjen e punëve. Kjo ndodh, sepse askush nuk e bën punën e vet siç duhet. Ngritja e nivelit të një shoqërie bëhet me përfshirjen e gjithë shoqërisë, duke filluar nga nivelet drejtuese e deri tek individit më i thjeshtë.

Një person që nuk e kryen punën e ngarkuar siç duhet nuk është i mirëpritur as nga Krijuesi as nga shoqëria.

Mjë Hadith

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Besimtari duhet ta kryejë në formën më të mirë punën e dhënë.
2. Prej një pune pa cilësi nuk mund të merret një frut i mrekullueshëm.
3. Allahu kënaqet kur njeriu e kryen detyrën e dhënë siç duhet.



Urtësi prej të dashurve të Allahut

LUKMANI (A.S.)

Lukmani (a.s.), ka thënë:

“Biri im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen dhe bëhu i durueshëm për çfarëdo që të godet! Me të vërtetë, ky është thelbi i patundur i të gjitha punëve!” (Lukman, 17)

Me këtë këshillë, Lukmani na tërheq vëmendjen në disa punë shumë të rëndësishme, të cilat Allahu i ka bërë farz, si: namazi, këshillimi në të mirë, pengimi i së keqes dhe durimi.

Namazi është shtylla e fesë dhe miraxhi i besimtarit. Ai është një përgjegjësi e pazëvendësueshme për robin dhe nuk braktiset as në luftë.

Përveç vazhdimit të tij, rëndësi të madhe ka edhe respektimi i të gjitha rregullave të namazit në mënyrën më të përsosur dhe falja e tij me përqendrim të lartë shpirtëror. Kjo, sepse namazi i pranuar, është ai që falet me ndjenja të thella dhe në harmoni mes zemrës dhe trupit. Allahu Teala ka urdhëruar:

“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlurur në namazin e tyre” (el-Mu’minun, 1-2.)

Njëri prej sahabëve, Abdullah bin Sihar (radijallahu anhu), na e tregon kështu gjendjen e përqendrimit të Profetit (a.s.), në namaz:

“Njëherë, kur shkova tek Rasulallahu (a.s.) e gjeta duke falur namaz. Prej të qarave, nga kraharori i tij vinte një zë që ngjante me vlimin e ujit në kazan.” (Ebu Daud, Salat, 158)

Namazi u bë farz gjatë ndodhisë së Miraxhit. Dhe, namazi i Rasulullahut (a.s.), ishte gjithmonë në gjendjen e miraxhit. Pra, ishte gjithmonë në një lidhje të papërshkrueshme me Allahun Teala. *“Faleni namazin ashtu*

siç më shihni mua...” (Buhari, Ezan, 18) Me këto fjalë Profeti (a.s.) urdhëron të gjithë umetin e tij që ta falë namazin sikur është i tëri në miraxh.

Profeti ynë (a.s.), e ka përkufizuar namazin me këto fjalë: *“...Namazi është përqendrim shpirtëror, modesti dhe përlulje...”* (Tirmidhi, Salat, 166.) Pra, besimtari duhet të jetë i vetëdijshëm se në namaz ndodhet në prani të Zotit të botëve. Ai duhet të shkëpusë lidhjet me çdo gjë tjetër përveç Tij, të kuptojë se është “asgjë” dhe të sillet me modesti, përlulje, respekt, dhe përqendrim të lartë. Në sexhde duhet të shkojë me ndjenjat e dobësisë, përlulësisë dhe pamundësisë, duke pranuar me gjithë shpirt se çdo gjë që ka, është mirësi e Allahut Teala. Në sexhde të takohet me Zotin e vet duke e bërë egon e tij njësh me tokën. Namazin duhet ta përfundojë me dëshirën për t’u nderuar me daljen përpara Allahut dhe për të arritur ëmbëlsitë shpirtërore.

Përveç këtyre, duhet që të përkushtohemi me gjithë shpirt në namaz, të përpiqemi të hyjmë në atmosferën e tekbirëve, dhikrit, ajeteve e duave që lexohen. Në këtë mënyrë, do të arrijmë të kryejmë këtë adhurim kaq të rëndësishëm me ndjenja të thella dhe me emocionet e miraxhit.

Es’ad Erbili (Allahu e mëshiroftë), në lidhje me mënyrën e këndimit të Tahijatit në namaz, shprehet:

“Lavdet dhe falënderimet që Profeti ynë (a.s.), ia shfaqti Allahut Teala në Miraxh, pra Tahijatin, çdo njeri duhet ta shfaqë për hesap të vet. Tahijati nuk duhet të lexohet si fjala e dikujt tjetër (duke e përjashtuar veten), ose sikur po tregon ndonjë ngjarje. Por duhet lexuar duke u shkrirë me kuptimin e tij dhe me të njëjtat ndjenja, sikur të ishe duke e përjetuar vetë mrekullinë madhështore të Miraxhit. Selamin që Allahu Teala ia

dha Pejgamberit (a.s.), marrja e selamit nga ana e Pejgamberit (a.s.) dhe Formula e Teuhidit, që shqiptoi Xhebraili (a.s.), gjithmonë duhen lexuar sikur lutësi të jetë vetë duke e marrë selamin.” (M. Es’ad Efendi, Mektubat, Fq. 33, Nr.10)

Ndërsa Mevlana i nderuar, në lidhje me të dashurit e Allahut, që falin namazin me përkushtim të madh dhe marrin kënaqësinë shpirtërore prej tij, shprehet:

“Merr një abdest të tillë, që të mos prishet kurrë. Fal një namaz të tillë, që të mos mbarojë kurrë. Ashikut nuk i mjaftojnë pesë vakte namaz, ai dëshiron pesëqind të tillë. A thua dëshiron ashiku i vërtetë që takimi me Allahun të mbarojë?”

Allahu Teala, e ka krijuar trupin e njeriut në formën më të përshtatshme për të rënë në sexhde, duke i dhënë mundësi atij që të përfitojë sa më shumë prej shijes së takimit me Të. Prandaj, Allahu i Lartmadhëruar, na ka urdhëruar të bëjmë sexhde me qëllim që t’i afrohem sa më shumë.

Allahu Teala, në lidhje me namazin, i cili falet në mënyrën e duhur, shprehet:

“...dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar. Vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe!..” (el-Ankebut, 45)

Për këtë arsye, namazi i falur me përpikmëri dhe i



Lakmitë dhe smirat që e mbysin njeriun në vorbullën e dëshirave të pafundme, vijnë për shkak se robi e harron botën tjetër dhe lidhet çmendurisht pas kësaj bote.

fthohen vetëm me shpëtimin e vetes, por kërkojnë të shpëtojnë edhe shpirtin të tjerë. Kjo, sepse ata jetojnë gjithmonë me vetëdijen, se shpëtimi i tyre varet prej përpjekjeve që bëjnë ata për shpëtimin e të tjerëve. Këtë detyrë, e konsiderojnë si përgjegjësinë më të natyrshme të besimit.

pranuar, është namazi i atij që ruhet nga gjynahet dhe paturpësitë. Kurse efekti i mbrojtjes nga gjynahet që ka namazi, varet nga vetëdija e devotshmërisë, e cila përjetohet konkretisht gjatë këtij adhurimi dhe vazhdimësisë së kësaj vetëdije edhe pas namazit.

Nëse dikush fal namazin, por vazhdon të bëjë padrejtësi e gjynahe të cilat e zemërojnë Allahun, do të thotë, se ai, në të vërtetë nuk po fal namaz. Në lidhje me ata që e falin namazin në këtë gjendje, Allahu Teala urdhëron:

“Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm ndaj namazeve.” (el-Ma’un, 4-5.)

Çështja e dytë që na tërheq vëmendjen në këshillat e Lukmanit, është EMR BI’L-MARUF, NEHI ANI’L-MUNKER, pra, këshillimi i gjërave të mira e të dobishme në përputhje me islamin dhe përpjekja në pengimin e të këqijave, gjynaheve dhe punëve të kota. Këto janë edhe dy prej detyrave kryesore të besimtarit.

Të gjithë besimtarët e sinqertë që kanë arritur një farë pjekurie shpirtërore, nuk mja-

Nga ana tjetër, puna dhe përpjekja e robit, që besimi dhe Kurani që i janë dhuruar atij prej Allahut Teala, t'i arrijë edhe atyre që ende nuk i kanë shijuar këto mirësi, është shprehja më e bukur e falënderimit të tij ndaj Zotit.

Ashtu siç shprehet edhe i nderuari Es'ad Erbili:

"Falënderimi, nuk duhet të bëhet thjesht me fjalët: "O Zot, falënderimet të takojnë vetëm Ty!". Falënderimi më i bukur, është kur rob i përdor në përputhje me qëllimin e krijimit të tyre dhe në rrugë të Allahut mirësitë (si syri, veshi, gjuha, zemra, mendja, shëndeti, jeta etj.) që ia ka falur Ai. Përveç kësaj, falënderimi më i pranuar është ajo punë, e cila ka dobi edhe për vëllezërit besimtarë." (M. Es'ad Efendi, Mektubat, fq. 67, nr. 38.)

Këshillimi në të mirë, ndalimi nga e keqja dhe e kota, janë nga adhurimet më të rëndësishme me dobi shoqërore. Mirëpo, besimtarët që do ta realizojnë këtë detyrë, duhet të shfaqin personalitet, karakter dhe sjellje të cilat përfaqësojnë islamin. Me një fjalë, është kusht që më parë ata të tregojnë islamin me mënyrën e tyre të jetesës. Mevlana i nderuar shprehet:

"Ai që këshillon me vepër, është më i mirë se ai që këshillon me fjalë." Me këtë shprehje, ai ka përmbledhur të fshehtë e begatisë së ndikimit në çështjen e thirrjes islame.

Në këshillën tjetër, Lukmani na tërheq vërejtjen në lidhje me durimin, i cili është edhe një nga temat më të prekura në Kuranin Kerim. Durimi, është ruajtja e ekuilibrit shpirtëror, përballë kushteve të ëmbla apo të hidhura të jetës dhe ruajtja e harmonisë së devotshmërisë dhe përpjekjes. Durimi ndaj sëmundjeve, varfërisë, fatkeqësive, katastrofave dhe në veçanti ndaj vështirësive dhe vuajtjeve me të cilat njeriu përballlet gjatë përpjekjeve për të përhapur fenë e Allahut, e bëjnë atë të fitojë kënaqësinë e Atij, i Cili ia dha këto sprova. Në të tilla raste, besimtari duhet të mundohet ta ruajë ekuilibrin shpirtëror, duke menduar gjithmonë sprovat dhe vuajtjet që kanë kaluar profetët e Allahut.

Mevlana i nderuar, në lidhje me durimin e madh që kërkojnë dy punët më të rëndësishme të profetëve, kumtimi dhe udhëzimi, shprehet:

"Shumica e fatkeqësive u kanë ardhur profetëve. Madje edhe udhëzimi në rrugë të drejtë i njerëzve të pagdhendur, është një vështirësi më vete."

Përsëri, Mevlana i nderuar, në lidhje me gradat e larta që fiton njeriu kur toleron dhe duron, thotë:

"Durimi që tregoi trëndafili ndaj gjembave, i fali atij aromën e këndshme."

Trëndafili edukohet dhe pastrohet, në sajë të durimit dhe tolerancës ndaj gjembave. Kushti më i rëndësishëm i përparimit shpirtëror të besimtarit, është kalimi nga

sita e durimit. Pra, të durojë vuajtjet dhe vështirësitë me të cilat përballlet në rrugë të Allahut, duke menduar për shpërblimin që do të ma-

"Pasuria e pakët, për të cilën mund të falënderosh, është më e mirë se pasuria e shumtë, për të cilën nuk do të mund të falënderosh..."

rrë në botën tjetër dhe duke i braktisur ankimet, revoltimet dhe qarjet.

Sa i rëndësishëm është durimi ndaj varfërisë, skamjes dhe fatkeqësive që e sflisin njeriun, po aq i rëndësishëm është edhe durimi ndaj pasurisë, rinisë, shëndetit dhe rehatisë, të cilat mund ta përkëdhelin nefsin (egon) dhe ta çojnë njeriun në kryeneçësi dhe arrogancë. Madje në këto raste, për shkak se nefsi është më i fuqishëm, është më e vështirë t'i pengosh lakmitë e tij të egra dhe ta frenosh atë përballë joshjes së gjynaheve në krahasim me rastet kur nefsi është i dobët në kohët e varfërisë, sëmundjes dhe pleqërisë. Prandaj, në çfarëdo lloj kushtesh që të ndodhet, besimtari duhet ta ruajë me durim të madh vullnetin për të bërë një jetë të pastër fetare.

Lokmani ka thënë:

"Nëse stomaku mbushet (tepër), meditimi bie në gjumë. Kurse gjymtyrët largohen nga adhurimi!"

Në tasavuf, tre parimet kryesore në edukimin e nefsit dhe futjen e shpirtit në rrugën e të fshehtave, janë:

- 1- Të hash pak,
- 2- Të flesh pak,
- 3- Të flasësh pak.

Ngrënia e pakët me të cilën Lukmani na këshillon,



është simboli i të gjithë profetëve, sahabëve, të dashurve të Allahut dhe robërve të devotshëm. Sot, grykësia përbën shkakun kryesor

“Nëse biri i njeriut do të kishte dy lugina me ar, do të dëshironte edhe të tretën. Syrin e tij e mbush vetëm dheu. Allahu Teala e pranon pendimin e atyre që pendohen.”

të shumë sëmundjeve dhe u hap rrugën shumë çrregullimeve dhe devijimeve. Shpërdorimi në ngrënie e pirje dhe konsumimi i çdo gjëje që ta do “shpirti”, është një lloj jete, të cilën robërit e devotshëm e të sinqertë nuk e kanë njohur kurrë.

Ushqimi i tepërt i trupit, ngurtëson botën shpirtërore të njeriut, ngathtëson zemrën, egjëron nefsën (egon), cenon shpirtin dhe dobëson mendimin. Për këtë arsye, Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

“...Ne jemi një popull që nuk hamë pa na marrë uria. Dhe kur hamë, nuk hamë aq sa të ngopemi.” (Halebi, Insanu'l-Ujun, III, 299.)

“Askush nuk mbush ndonjë enë më të rrezikshme se stomaku i vet. Njeriut i mjaftojnë disa kafshata që ta mbajnë në këmbë. Por nëse dikush duhet patjetër të hajë shumë, një të tretën e stomakut le ta ndajë për ushqimin, një të tretën për pijen dhe një të tretën për ajrin!” (Tirmidhi, Zuhd, 47.)

“Besimtari pi me një zorrë, kurse mohuesi me shtatë zorra.” (Muslim, Eshribe, 186.)

Të gjitha këto, na tregojnë se mosteprimi në ngrënie dhe pirje, është i domosdoshëm për një jetë të devotshme. Kjo, sepse me një stomak të tejmbushur, nuk është e mundur të kuptohen ashtu siç duhet dobësia,

nevoja, përlulja dhe skamja, të cilat përbëjnë thelbin e devotshmërisë ndaj Allahut. Gjithashtu, nuk është i mundur as kthimi nga dera hyjnore duke bartur ndjenjat e modestisë dhe përlulësisë e as të drithërohesh e të derdhësh lot prej frikë-respektit dhe dashurisë ndaj Allahut Teala.

Sado adhurime të bëhen, me një stomak të tejmbushur, ato gjithmonë kanë për të qenë të mangëta në përqendrim dhe në përfitim shpirtëror. Dhe kjo bëhet shkak që adhurimet të cilat në dukje janë të shumta, të jenë të zbrazta dhe të mangëta prej së vërtetës. Në bazë të kësaj, me qëllim që adhurimet të kryhen me përqendrim të thellë, duke u zhytur në meditime dhe të përfitohet shpirtërisht prej urtësive dhe mësimëve hyjnore, është kusht që të mjaftohesh me ushqim të pakët dhe hallall.

Sa bukur e ka shprehur Mevlana i nderuar këtë fakt:

“Mos u mendo ta zbukurosh lëkurën duke e ushqyer së tepërmi, sepse në fund të fundit, ajo është një kurban që do t'i jepet tokës. Më mirë mundohu të ushqesh zemrën, sepse ajo do të shkojë e do të nderohet në përjetësi.”

“Mos i jep trupit shumë yndyrna dhe ëmbëlsira, sepse kush e ushqen më shumë se sa duhet, në fund do të bëhet rob i dëshirave të nefsit dhe do të përfundojë i poshtëruar.”

Lukmani ka thënë:

“Biri im! Mos lejo që gjeli të jetë më i zgjuar se ti! Ai çdo mëngjes përkujton Allahun, ndërsa ti fle!”

Kjo këshillë e Lukmanit na tërheq vëmendjen në parimin e fjetjes së pakët.

Sa i mahnitshëm dhe mësimdhënës është fakti se Allahu Teala ka krijuar shumë kafshë të cilat, na zgjojnë në orët e natës që janë më të dobishmet për shpirtin tonë! Por sa i hidhur është fakti që njeriu, i cili është krijuar si më fisniku ndër të gjitha krijesat, është kaq i pakujdesshëm ndaj kësaj pjese të rëndësishme kohe!

Koha para agimit të ditës, është një kohë e veçantë, e cila ndikon shumë në pastërtinë e mendjes dhe zemrës, në mprehtësinë e kuptimit dhe shprehjes, në forcën e kujtesës dhe në përparimin e shpejtë në rrugën shpirtërore.

Allahu Teala, i jep më shumë vlerë dhikrit në kohën para agimit se sa dhikrit gjatë kohëve të tjera. Kjo, sepse të merresh me adhurime në një kohë kur shtrati e tërheq njeriun si me magnet, është më e vështirë në krahasim me kryerjen e adhurimeve në kohët e tjera. Prandaj mund të themi, se gjallërimi i kohës para agimit, është punë “burrash” dhe jo njerëzish të thjeshtë. Koha para agimit, është koha kur dilet në audiencën hyjnore duke e braktisur gjumin e ëmbël vetëm për hir të kënaqësisë së



Alla-
h u t
dhe dashu-
risë ndaj Tij. Kjo
shpreh qartë
ndjenjat e sin-
qerta të robit
ndaj Zotit të tij,

sepse nuk është e mundur të mendohet një besimtar, që e do Zotin e tij me gjithë kuptimin e fjalës, por fle derisa të lindë dielli, i zhytur në një shkujdesje të thellë.

Namazi, duaja, kërkimi i faljes, përsëritja e formulës së teuhidit, salavatet për Profetin (a.s.), meditimi rreth vdekjes dhe adhurimet e tjera që bëhen në kohën e para agimit, janë ushqimet më të dobishme për shpirtin e njeriut. Për ta ruajtur veten tonë nga shkujdesja, është e rëndësishme që çdo ditë të re ta fillojmë me këtë energji shpirtërore.

Padyshim se praktikimi i namazeve dhe dhikrit të natës, është në përpjesëtim të drejtë me nivelin e dashurisë për Allahun.

Një njeri, i thotë Ibrahim Bin Et'hemit:

"Nuk arrij të çohem në namazin e natës. Më jep një zgjidhje."

Ibrahim bin Et'hemi, i thotë:

"Mos u trego i pakujdesshëm ndaj Allahut gjatë ditës, që Ai të të marrë në audiencën e Vet gjatë natës. Të gjendesh në audiencën e Tij gjatë natës, është një nder shumë i madh. Dhe gjynahqarët nuk e meritojnë këtë nder!"

Robërit e devotshëm të cilët kanë arritur ta shijojnë ëmbëlsinë shpirtërore të adhurimit të natës, në sajë të ndjenjave që u ka dhënë thellimi në meditimin rreth vdekjes, kanë thënë: "Unë nuk kam frikë nga vdekja,

por kam frikë se ajo më gjen para se ta fali namazin e natës".

Vërtetë, që të merresh me adhurime kur të gjithë janë në gjumë, do të thotë të bëhesh prej robërve të zgjedhur, të cilët hyjnë në rrethin intim të dashurisë dhe njohjes shpirtërore të Zotit. Prandaj dhe për robërit e mirë të Allahut, nuk ka kohë më të vlefshme për shpirtin se sa koha para agimit. Në lidhje me këtë çështje, Allahu Teala shprehet:

"Në një pjesë të natës bëji sexhde Atij dhe, natën falju gjatë Atij. Vërtet që jobesimtarët e duan jetën e këtushme dhe nuk e përfillin Ditën e vështirë, që do t'u vijë." (el-Insan, 26-27.)

"Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne." (es-Sexhde, 16.)

"Ata flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu)." (edh-Dharijat, 17-18.)

Ndërsa Profeti ynë (a.s.), me qëllim që të mos privohemi prej ëmbëlsisë shpirtërore të kohës para agimit, na ka këshilluar me këto fjalë:

"Kujdesuni për adhurimin e natës! Sepse ai është tradita e njerëzve të sinqertë që kanë jetuar para jush. Padyshim se ngritja për të kryer adhurimet e natës, është shkak i afrimit me Allahun. Ai ju ruan prej gjynaheve, ju fshin gabimet dhe ju largon problemet e trupit." (Tirmidhi, Deauat, 101.)

Të mos merresh me adhurime gjatë kohës së para agimit, është një humbje shumë e madhe. Sa bukur e shpreh kjo ndodhi këtë fakt:

Abdullah bin Omeri (radijallahu anhum), ka thënë:

"Kur Profeti ishte ende gjallë, nëse dikush shihte ndonjë ëndërr, shkonte dhe ia tregonte atij. Edhe unë dëshiroja shumë të shihja ndonjë ëndërr dhe t'ia tregoja. Atë kohë isha një djalë beqar dhe flija në mesxhid.

Njëherë, pashë në ëndërr sikur dy melekë po më çonin në xhehenem. Vura re se ai (xhehenemi) ishte i ndërtuar me gurë si ndonjë pus uji dhe kishte dy shtylla njësoj si pusi. U habita shumë. Aty ndodheshin edhe disa njerëz, të cilët i njihja.

"Strehohem tek Allahu prej xhehenemit! Strehohem tek Allahu prej xhehenemit!", bërtita unë. Pastaj erdhi një melek dhe më tha:

"Mos ki frikë, ty nuk do të të ndodhë gjë!"

Ëndrrën ia tregova motrës sime Hafsës, kurse ajo ia kishte treguar Rasulallahut (a.s.), i cili i kishte thënë:

"Sa njeri i mirë është Abdullah! Sikur të falte edhe namaz nate, do të ishte më i mirë!.."

Që prej asaj dite, Abdullahu (radijallahu anhu), e kalonte një pjesë të madhe të natës me adhurime dhe flinte shumë pak. (Buhari, Ashabu'n-Nebi, 19.)

Nëse besimtari e kalon natën duke pasur parasysh këshillat dhe mësimet Allahut dhe të të Dërguarit të Tij, nata do t'i ndriçohet më shumë se dita. Një nga robërit e mirë të Allahut, Bajezid Bistami (Allahu e mëshiroftë), ka thënë: "Nuk më është zbuluar asnjë e fshehtë pa m'u bërë netët si ditë".

Lukmani ka thënë:

"Biri im! Nuk jam penduar kurrë prej heshtjes. Nëse fjala është argjend, heshtja është flori." (Ahmed, ez-Zühd, s. 44, no: 272.)

"Heshtja është urtësi, por janë të pakët ata që e praktikojnë." (Ahmed, ez-Zühd, s. 88, no: 545.)

Me këtë këshillë, Lukmani na tërheq vëmendjen në parimin e heshtjes.

Heshtja, është stolia e dijetarëve dhe mbulesa e të paditurve. Njeriu i cili futet nën strehën e heshtjes, është i ruajtur nga shumë rreziqe dhe në veçanti prej shikimeve të helmëta të smirëzinjve. Për këtë arsye, në vend që të flasë shumë, njeriu duhet të merret me vepra të mira duke bërë gjëra të bukura e të dobishme. Përndryshe nëse flet shumë, nuk do të ketë kohë për të bërë vepra të mira dhe do të zhytet në shkujdesje.

Heshtja, e cila arrihet duke frenuar nefsin, ndonjëherë është përgjigjja më e qartë që mund t'u jepet injorantëve. Dhe jo më kot, dijetarët e mëdhenj islamë kanë thënë: "Heshtja është përgjigjja më e mirë që mund t'i jepet mendjecekëtit". Kjo ndodhi, e shpreh më së miri këtë fakt:

Një ditë, kur Rasulallahu (a.s.), gjendej në mes të sahabëve fisnikë, erdhi një njeri dhe ofendoi Ebu Bekrin (radijallahu anhu). Ebu Bekri, heshti dhe nuk iu përgjigj. Por ai përsëri e ofendoi në të njëjtën mënyrë. Ebu Bekri përsëri heshti. Dhe kur njeriu e ofendoi për herë të tretë, Ebu Bekri (radijallahu anhu), nuk duroi dot më dhe i dha përgjigjen që meritonte. Pas kësaj ndodhie, Rasulallahu (a.s.), u çua dhe filloi të largohej. Ebu Bekri (radijallahu anhu), i shkoi pas dhe e pyeti:

"O Rasulallah! A mos u mërzitët me mua?" Rasulallahu (a.s.), tha:

"Jo, nuk u mërzita me ty. Por pashë se një melek kish zbritur nga qielli dhe po i përgënjeshtronte fjalët

që po të thoshte ai njeri duke iu përgjigjur në vendin tënd. Kur ti iu përgjigje dhe more hakun, meleku iku dhe në vend të tij erdhi shejtani. Dhe unë nuk qëndroj në një vend ku ndodhet shejtani!". (Ebu Daud, Edeb, 41/4896.)

E megjithatë, ka raste kur nuk duhet heshtur, sepse të heshtësh kur duhet të flasësh, është një gabim po aq i madh sa të flasësh kur duhet të heshtësh. Të mos ndërhysh dhe të heshtësh atëherë kur bëhet padrejtësi, bëhet shkak i ngarkimit tënd me gjynahe. Ebu Ali ed-Dekak, është shprehur:

"Ai që hesht kur duhet të thotë të vërtetën, është si një shejtan memec."

Si besimtarë që jemi, kriteri ynë kryesor që duhet të përvetësojmë në lidhje me të folurin dhe të heshturin, është kjo urdhëresë e Profetit tonë (a.s.):

"Ai që i beson Allahut dhe botës tjetër, ose të flasë mirë ose të heshtë!" (Buhârî, Edeb, 31, 85; Müslim, Îman, 74)

Nëse njeriut i duhet të flasë patjetër, duhet që fjalët e tij të kenë urtësi më të vlefshme se heshtja, të qetësojnë zemrat dhe të çlodhin shpirtat. Dhe për të folur me fjalë të tilla, më parë duhet të jetosh duke e brumosur shpirtin me ato fjalë. Allahu Teala, me qëllim që njeriu të dëgjojë shumë e të flasë pak, i ka dhënë atij dy veshë e një gojë. Nëse nuk bëhet kujdes ndaj këtyre të vërtetave do të vuajmë shumë prej fjalëve tona. Siç shprehet edhe Shejh Sadi

Shirazi:

"Fjalët e atij që flet pa menduar, në të shumtën e rasteve janë të gabuara."

Për këtë arsye, Ebu Bekri (radijallahu anhu), ka thënë:

"Mendo mirë se çfarë po thua, kujt po ia thua dhe kur po e thua!"

Për më tepër, zgjatja e fjalës më shumë se sa duhet, ia ul vlerën njeriut për një kohë shumë të shkurtër. Siç shprehet edhe Mevlana i nderuar: "Fjalën e zgjat ai që nuk arrin të shpjegojë qëllimin." Dhe ai që flet kaq gjatë, duhet dëgjuar shkurt.

Allahu Teala, e bëftë heshtjen tonë meditim, shikimin tonë mësim, dhe fjalën tonë urtësi. Gjithashtu na dhëntë urtësinë e duhur që ta përdorim jetën tonë në rrugën e Tij dhe në mënyrën më të dobishme.

Amin!..



QYTETËRIMI I DASHURISË DHE TOLERANCËS

Musa K. Jëllmaz

Fjala “muhabbet” në arabisht, të cilën e përdorim shumë edhe ne, ka kuptimin “dashuri”. “Dhembshuria/mëshira” (shefkat) është një fjalë tjetër e fuqishme, që rrjedh nga emrat e Allahut, “Rauf –Rahim”, e cila shpreh dashurinë e pakusht që Zoti u jep krijesave. Edhe “ashk” do të thotë “dashuri”, por, nuk është aq ndikuese dhe me potencë sa fjala mëshirë/dhembshuri, sepse fjala mëshirë është shumë më e gjerë dhe gjithëpërfshirëse. Një njeri, për arsye të dashurisë që ka për fëmijën e vet, ka mëshirë për të gjithë fëmijët e botës. Kurse një njeri që dashuron (ashk) një tjetër, mund të flijojë gjithë botën vetëm për të. Mund të thuhet se nuk ka njeri që nuk i përjeton këto ndjenja do apo nuk do, sepse *dashuria* është një ndjenjë që i është frymëzuar njeriut nga vetë Zoti qysh në ngjizje.

Dashuria ka një fuqi magjike, sepse ajo është shkaku i parë i vazhdimësisë së jetës dhe shpeshherë e shpëtimit të njeriut në prag të greminës. Gjëja e parë që kujton një njeri i falimentuar dhe që mendon t’i japë fund jetës, janë fëmijët, bashkëshortja dhe familja, të cilët i do aq shumë. Shpeshherë kjo dashuri e shpëton njeriun nga de-

presioni, sepse në një moment i kujtohet mëshira/dhembshuria/dashuria që ka për fëmijën e vet dhe nuk i jep fund jetës për të mos i mërzitur ata.

“Toleranca” është rrjedhojë e dashurisë, sepse ai që ia di vlerën dashurisë, dashuron. Ai që dashuron, natyrshëm është edhe tolerant ndaj të tjerëve. Toleranca është një nga parimet e qytetërimit të bekuar, që vetë Hz. Muhamedi (a.s.), ia mësoi njerëzimit. Një qytetërim që nuk ndërtohet mbi tolerancën, sado zgjerim të ketë në rruzullin tokësor, nuk mund të shkojë më tej sesa të bëhet kurth për shoqëritë që ka nën ndikim, sepse i mungon ndjenja e solidaritetit.

BURIMI I DASHURISË DHE TOLERANCËS

Besimi është burimi i dashurisë dhe prej dashurisë buron toleranca. Sakrifica më e madhe që mund t’u bëjë një njeri të ngjashmëve të vet, është toleranca, pasi toleranca i ka rrënjët në dashuri. Sikurse është një prej shkaqeve të krijimit të gjithësisë, dashuria është po ashtu edhe drita dhe jeta e gjithësisë. Ndaj dhe jeta është çështja më e rëndësishme e kësaj bote. Jeta është si dielli i kësaj gjithësie. Por dashuria është ajo që i jep jetë, jetës. Madje, mund të thuhet se është lidhja e dashurisë ajo që lidh të gjithë elementët e gjithësisë. Sikur të imagjinohet gjithësia si një pemë e madhe, njeriu do të ishte fruti i saj. Përderisa njeriu është fruti

i gjithësisë, në farën e frutit, që i takon të jetë zemra e njeriut, Allahu ka vendosur dashurinë e pakufijshme që mund të pushtojë të gjithë gjithësinë.

Po njeriu,
k u j t
po



ia drejton këtë dashuri të pakufishme? A thua çdo gjë e meriton këtë dashuri të pakufishme? Ja, kjo është çështja!

Një shpirt që beson, fillimisht dashuron Allahun ndër-sakrijesat i do për hir të Tij. Sikurse ka thënë edhe poeti i madh mistik, Junus Emre: "Të duash krijesat, për hir të Krijuesit."

Zemrat që nuk kanë besim dhe dashuri, Kurani Famë-lartë i përngjason me gurët. Madje edhe gurët i çon më lart se ato zemra, duke thënë: **"Por, pas kësaj, zemrat tuaja u forcuan e u bënë si guri, madje edhe më të forta. Në të vërtetë, ka gurë nga të cilët burojnë lumenj, ka të atillë që çahen e nga të cilët rrjedh uji, madje ka edhe syresh që rrëzohen nga frika e Allahut. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja."** (Bekare, 74) Ky ajet shpreh qartazi se një zemër që nuk ka brenda saj besim dhe dashuri, është më e sertë dhe më e pamëshirshme sesa një gur. Ndaj dhe toleranca, e cila ushqehet përmes besimit, dashurisë dhe mirësjelljes, përbën themelin e qytetë-rrimit islam. Mbi të gjitha, nuk është edhe aq e vështirë të duash të tjerët dhe të tregosh tolerancë ndaj tyre, sepse edhe të mirat edhe të ligat bëhen nga të njëjtat duar. Po ashtu edhe fjalët e bukura edhe të shëmtuarat dalin nga e njëjta gojë. Ashtu sikurse veprat e mira e ato të këqija bëhen nga të njëjtat organe. Kështu, duke pasur mundësinë për të vendosur besimin në zemër, e cila është pasqyra e Allahut, të zgjedhësh mohimin është një zgjedhje e paarsyeshme. Është njëllë si të përdorim fjalë të shëmtuara, kur duhet të përdorim të bukurat, apo të bëjmë keq kur kemi mundësi të bëjmë mirë. Prandaj, të duash njerëzit dhe t'u shprehësh atyre tolerancë është më se e logjikshme.

Mund të thuhet se toleranca është një dhuratë e madhe që Islami i solli njerëzimit, sepse toleranca është dashuri, është drejtësi dhe prirje drejt saj; është të zgjedhësh atë që është më e saktë dhe më e drejtë. Toleranca është të falësh, të mëshirosh, të vlerësosh njeriun që ke përballë. Toleranca është thelbi i dijes, kulturës dhe thirrjes fetare. Është përmbledhja e mirësjelljes, është thesari i çdo besimtarit të vërtetë.

MUNGESA E DASHURISË DHE INTOLERANCA

Të kundërtat e tolerancës janë fanatizmi dhe mungesa e dashurisë. Burimi i dashurisë dhe i tolerancës është besimi, kurse burimi i fanatizmit është injoranca. Atëherë, ajo çfarë duhet theksuar është kjo: aq larg sa është injoranca nga Islami, aq larg është edhe nga fanatizmi. Thënë ndryshe; bukuria, durimi, fjalët dhe sjelljet e bukura, guximi për të mbajtur problemet e të tjerëve, delikatesa, finesa dhe mëshira burojnë nga besimi, dituria dhe virtyti. Ndërsa, intoleranca, mos-

respektimi i mendimeve të të tjerëve, smira, inati, fanatizmi, sulmimi dhe dhuna rrjedhin nga injoranca dhe janë vese të këqija. Padyshim, asnjë nga këto vese, të cilat janë veçoritë kryesore të një sistemi të injorancës, nuk janë dhe nuk mund të jenë veçori të një myslimani. Kurani Famë-lartë, duke theksuar këtë mirësjellje të myslimanëve, thotë: **"Le të gëzohen ata që shmangen nga adhurimi i idhujve"** (tagut: shejtan, idhull dhe tiran) **dhe kthehen nga Allahu! Pra, jepu lajme të gëzueshme robërve të Mi, të cilët, pasi i dëgjojnë fjalët (që u thuhen), ndjekin atë që është më e mira prej tyre. Janë ata që Allahu i ka udhëzuar në rrugë të drejtë; këta janë mendarët."** (Zumer, 17 - 18) Në këtë ajet ka dy pika të rëndësishme:

E para: besimtarët e vërtetë nuk kërkojnë të arrijnë gjithçka; bashkë me këtë dëgjojnë fjalën e të gjithëve, e masin atë, e peshojnë dhe, kur besojnë se është e drejtë, e pranojnë dhe e ndjekin. Veçanërisht besimtarët, nuk mundohen t'u japin kuptim të gabuar atyre çfarë dëgjojnë. Përkundrazi, ata pranojnë anën e drejtë dhe të bukur të çdo fjale dhe mundohen të përfitojnë prej saj. Ndaj për besimtarët, ushqimi shpirtëror pas besimit është dashuria, bukuria dhe sakrifica.

E dyta: fjala *tagut* që kalon në Kuran, sado që cilëson ata që tejkalojnë kufijtë, në fakt më shumë shenjon ata që i kundërvihen Zotit dhe që e konsiderojnë veten sundues dhe zotër të shërbëtorëve, si dhe ata që i detyrojnë të tjerët t'u shërbejnë. Shejtani i pranon si *tagut*-ë ata lidërsipë, diktatorë fetarë apo politikë. Qëllimi i *tagut*-it është t'i shpjerë nga drita në errësirë ata që e ndjekin atë. Padyshim, në krye të këtyre *tagut*-ëve është shejtani, i cili bën që njeriu të bëjë shumë gjynahe, tamahu dhe nefsi i njeriut, që e bëjnë atë rob të dëshirave të tij. Sipas vendit edhe gruaja, fëmijët, armiqët, të afërmit, posti apo pasuria e njeriut, mund të kalojnë në vendin e *tagut*-it. Baza kryesore ushqimore e *tagut*-ëve dhe atyre që ndjekin *tagut*-in është mungesa e plotë e dashurisë dhe interesi.

Këtu duhet të theksojmë edhe diçka tjetër: Shpeshherë ngatërrohen me njëra-tjetrën fanatizmi dhe të qenët i lidhur me fenë. Duhet ndarë qartazi. Ai që është dashamirës dhe që ka njohuri rreth fesë, e di se mënyra e të jetuarit me fenë është dëshmimi: të jesh vetëm nën ndikimin e Zotit dhe të jetosh i lirë me Të. Në këtë kontekst mund të thuhet se adhurimi që i bëhet Zotit është hapi i parë drejt lirisë. Ata që refuzojnë të adhurojnë Allahun, duke vendosur lirinë e tyre si hipotekë, bien pre e shumë keqkuptimeve, të cilat i udhëheq shejtani dhe nefsi. Çdo njeri i beson diçkaje. Madje, faktori kryesor që e dallon njeriun nga kafsha është feja me të gjitha manifestimet e saj. Nuk duhet perceptuar si turp, e metë apo fanatizëm lidhja e njeriut me fenë e vet. Ndarja, armiqësia, urrejtja dhe fanatizmi nuk shkaktohen nga lidhja që ke me fenë, por me të

kundërtën e saj, injorancën. Kuptimi i gabuar i fesë apo përqafimi i disa bestytive pagane dhe shkëputja nga e vërteta, e çon njeriun në humbje, fanatizëm, devijim dhe injorancë.

TOLERANCA NDAJ PËRKATËSIVE TË NDRYSHME FETARE

Populli e quan “tolerant” atë që flet mirë për tjetrin. Kjo është vlera që populli i ka dhënë tolerancës. Ne dëshirojmë të ndalemi mbi lidhjen që toleranca ka me fenë. Besimtarët janë të detyruar të jenë tolerantë në këto dy mënyra: e para, toleranca që duhet të tregojnë ndaj përkatësive të tjera fetare dhe toleranca që duhet të tregojnë myslimanët ndaj njëri – tjetrit. Sjellja e myslimanit me respekt dhe tolerancë ndaj besimtarëve të feve të ndryshme buron nga fakti se feja islame është universale. Atëherë kur të krishterët fanatikë kishin pushtuar të gjithë botën, hebrenjtë nuk vlerësonin tjetër veç vetes dhe idhujtaria ishte në kulmin e saj, erdhi Islami. Vallë a mund të ishte zgjeruar kaq shumë Islami si fe, sikur tolerancën të mos e kishte parim të tij?

Të ndash Islamit nga toleranca, thënë ndryshe, të jesh i pamëshirshëm dhe i ashpër ndaj besimtarëve të feve të tjera, bie në kundërshtim me veçorinë islame të të qenit fe universale. Kur toleranca nuk është fryma e një feje, atëherë kjo fe nuk është universale, e shumta mund të jetë një fe primitive. Lidhur me tolerancën që duhet shfaqur ndaj besimtarëve të feve të tjera mund të radhisim këto:

1. Mbi të gjitha, Kurani Famëlartë pranon si një prej kryesore të jetës përbërjet e përkatësive të ndryshme fetare. Kurani Famëlartë thotë kështu: **“Sikur të kishte dashur Zoti yt, të gjithë njerëzit do t’i bashkonte në një bashkësi të vetme, por ata vazhdojnë të jenë të përçarë, përveç atyre, që i ka mëshiruar Zoti yt...”** (Hud, 118 - 119) Këto ajete shprehin se Allahu nuk do që të gjithë njerëzit të jenë pjesëtarë të një feje të vetme. Allahu do që njeriu të shkojë në rrugë të drejtë, por vullneti i Zotit është pranë lirisë së zgjedhjes së njeriut. Sikur Allahu të ndërhynte në zgjedhjet e tyre të lira, nëse do ta mbyllte tërësisht rrugën për në xhehenem, do të humbiste sekreti i provimit të madh.

2. Nuk ka dhunë në islam. Ajetet: **“Nuk ka dhunë në fe.”** (Bekare, 256) dhe **“Sikur të donte Zoti yt, do të besonin të gjithë ata që gjenden në tokë. Vallë, ti do t’i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?”** (Junus, 99), shprehin pikërisht këtë gjë. Pra, duke marrë përsipër përfundimin, njeriu me vullnetin e tij është i lirë të zgjedhë të besojë ose të mohojë. Në Kuran theksohet se detyra e profetëve është vetëm kumtimi. Ky është tregues i qartë i ekuilibrit të përsosur mes kumtesës dhe suksesit për të udhëzuar të tjerët në Islam.

3. Në Islam të gjitha faltoret pranohen si të shenjta. Ndaj dhe respekti që kanë treguar myslimanët ndaj faltoreve është bërë legjendë. Allahu thotë: **“Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t’u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkatërrohe-shin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut.”** (Haxh, 40) Allahu në këtë botë nuk i jep pushtet absolut vetëm një kombi apo populli. Sikur t’i jepte vetëm një kombi apo populli pushtet të vazhdueshëm, nuk do të ishin shkatërruar vetëm kështjellat, sarajet dhe qendrat tregtare; njëkohësisht do të tronditej edhe shenjtëria e objektit të kultit. Ashtu siç thuhet edhe në një ajet: **“Me ndihmën e Allahut, ata i thyen armiqtë dhe Dauti e vrau Xhalutin. Allahu i dha atij pushtetin dhe Profecinë dhe i mësoi dituritë që deshi. Sikur Allahu të mos i ndihmonte njerëzit e mirë kundër të këqinjve, bota do të ishte shkatërruar. Por Allahu është shumë Bujar me krijesat e Veta.”** (Bekare, 251)

4. I Dërguari i Zotit (a.s.), ishte shumë tolerant ndaj hebrevë dhe të krishterëve të Medinës. Por ka pasur edhe prej atyre që kanë abuzuar me këtë tolerancë të gjerë. Gjatë çlirimit të Hajberit, një grua hebreje me emrin Zejnep hedh helm në mishin e një deleje të pjekur për të helmuar të Dërguarin e Zotit (a.s.) dhe shokët e tij. Por as kjo ngjarje e asnjë tjetër, nuk bënë as Resullahun e as sahabët e tij të hiqnin dorë nga toleranca ndërfetare. Abdullah bin Omeri, kishte një komshi hebre. Ai e ndihmonte gjithnjë atë. I çonte dhurata dhe merrte dhurata prej tij.

5. Një herë, i bënë vizitë të Dashurit të Zotit një delegacion të krishterësh nexhrani nga Jemeni. Resullullahu i priti mysafirët në xhami. Madje, sipas Bejhakiut, në Xhaminë e Profetit ata u drejtuan nga lindja dhe bënë ritualin e tyre. Pa dyshim, kjo ngjarje është një shembull i tolerancës ndaj besimtarëve të feve të tjera. Edhe pas Resullahut ka vazhduar kjo traditë. Myslimanët që çliruan Spanjën, nuk i janë përzier asnjë besimtari të ndonjë feje tjetër e as që kanë dëmtuar ndonjë objekt kultit. Sulltan Fatih Mehmeti gjithashtu, nuk ka penguar asnjë lloj adhurimi e as nuk i ka prekur faltoret e tyre.

TOLERANCA QË DUHET TË TREGOJNË MYSLIMANËT NDAJ NJËRI - TJETRIT

Allahu në Kuran tregon se të gjithë besimtarët janë vëllezër. Ndaj, toleranca dhe dashuria e vëllait ndaj vëllait është urdhër i Allahut. Ajet: **“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.”** (Fussilet, 34), tregon se është një virtyt i madh dhe një shembull miqësie, të mbajturit e shqetësimeve të të tjerëve dhe të përgjigjurit e të këqijave më të mira. Besimtari është modest. Ai tregon tolerancë

edhe ndaj atyre që përpiqen ta përqeshin atë. Këto ajete urdhërojnë tolerancë: **“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: ‘Paqe qoftë!’** (Furkan, 63) **“Trego mëshirë, urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga të paditurit!”** (Araf, 199) Pasi toleranca, është të falësh, të urdhërosh për mirë dhe të mos ia vësh veshin injorantëve.

Feja islame urdhëron vëllazërinë dhe solidaritetin. Rasulullahu (s.a.s.), në një hadith të njohur thotë: *“Asnjëri prej jush nuk mund të bëhet besimtar i vërtetë pa dëshiruar për vëllain e vet besimtar atë që dëshiron për vete.”* Me këtë ka treguar se Islami është feja e të menduarit për tjetrin, ndaj dhe është shpjeguar haptazi se ata që nuk mendojnë për të tjerët nuk mund të jenë besimtarë të vërtetë. Në krahun tjetër, Hz. Muhamedi (a.s.), thotë: *“Njeriu më i mirë është ai që është i dobishëm për tjetrin”* (Munavi, Fejdu'l-Kadir Sherhu Xhami'i's-Sagir, III, 481, Bejrut). Me njerëzit mund të bëhesh i dobishëm vetëm atëherë kur përhap të drejtën dhe të mirën, sepse Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën ndaj të afërmit, ndërsa ndalon veprat e shëmtuara, imoralitetin dhe dhunën. (Nahl, 90) Allahu në këtë ajet urdhëron tre rregulla kryesore, që sjellin lumturi dhe harmoni në këtë botë, si dhe ndalon tri sjellje të shëmtuara, që prishin strukturën sociale dhe sjellin anarki. Ai që është i lidhur me fenë sillet me drejtësi; nuk bën padrejtësi dhe qëndron larg imoralitetit. Si një njeri i dobishëm për shoqërinë, fillimisht e do vëllain e tij mysliman, madje reagon me mirësjellje edhe ndaj të këqijave të tij.

Mirëpo, si çdo liri edhe toleranca e ka një kufi. Ata që presin tolerancë prej tjetrit, duhet ta respektojnë këtë kufi. Ai që i ka vënë këta kufij, është vetë Allahu. Ai thotë kështu: **“Nuk i takon asnjë besimtar apo besimtareje të vërtetë që, kur Allahu dhe i Dërguari i Tij vendosin për një çështje, ata të kenë të drejtë të zgjedhin në atë çështje të tyren. Kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai me siguri ka humbur.”** (Ahzab, 36) Ky ajet përkufizon shumë mirë tolerancën. Hz. Ebu Bekri, sapo u bë kalif, puna e parë që bëri ishte urdhërimi i ushtrisë së Usames për ekspeditë ndaj Bizantit, duke iu bindur urdhrat të Resulullahut. Mirëpo, shumë sahabë nisën t'i thoshin se dërgimi i ushtrisë për luftë do të ishte punë e mundimshme dhe e panevojshme, pasi tashmë kërcënimi prej tyre nuk ekzistonte më. Por Ebu Bekri (r.a.), u thotë atyre: *“Vallahi, sikur ta dija se do t'i vërsuleshin Medinës tigrat dhe do më shqyenin mua, unë prapë do ta dërgoja ushtrinë, sepse ky është një urdhër i Resulullahut.”* Dhe

e dërgoi ushtrinë. Kjo sjellje e Hz. Ebu Bekrit tregon se kur janë të qarta urdhëresat e Allahut dhe të Profetit, nuk mbetet gjë tjetër për të bërë.

Ne mund të presim nga fëmijët tanë dhe nga pjesëtarët e familjes që kemi përgjegjësi, të sillen në përshtatje me urdhëresat dhe ndalesat e Zotit dhe të Dërguarit të Tij (s.a.s). Kjo është e drejta jonë. Fjala vjen, të qortosh një të afërm apo shok që nuk fal namaz dhe që pi alkool, nuk bie në kundërshtim me tolerancën. Nëse këtë e pranojmë si një sjellje në kundërshtim me tolerancën, e zhveshim atë.

PËRFUNDIMI

Njeriu pikësëpari duhet të njohë dhe të dojë Krijuesin e vet. Fillimisht duhet ta drejtojë nga Allahu thesarin e dashurisë, që si mal, Ai e ka vendosur në zemrën tonë. Pas kësaj, na lind e drejta të duam gjithçka që Ai ka krijuar.

Një njeri që ka besim dhe fuqi të tillë dashurie, do t'i dashurojë krijesat për hir të Krijuesit. Në të njëjtën kohë, për arsye se dashurinë dhe tolerancën e pranon si një pjesë të jetës, vijon një jetë pa shqetësime, pa frikë dhe me pak probleme. Qytetërimi islam, i cili ka ndikuar në shumë zona të botës dhe efektet e tij shihen haptazi sot në qytetërimin perëndimor, bazohet në tolerancë. Pikërisht se Hz. Muhamedi ishte i mëshirshëm, falës dhe tolerant; nuk ishte i vrazhdë, i ashpër dhe me zemër të ngurtë, kjo solli që një pjesë e madhe e botës të përqafojë Islam. Allahu i drejtohet të Dërguarit të Tij në këtë mënyrë: **“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj faljua atyre gabimin, kërkoji falje Allahut për ta dhe këshillohu me ta për çështje të ndryshme.”** (Al' Imran, 159)

Botëkuptimi i Hz. Muhamedit ka ndriçuar qytetërimin e krijuar në kontinente të ndryshme nga myslimanët dhe në çdo fazë është marrë për bazë toleranca.

Hz. Muhamedi (a.s.), urdhëroi të mbroheshin të krishterët. Kjo urdhëresë kishte katër pika:

- a) Asnjë kishë nuk duhet të priset.
- b) Nuk duhet të ndërhyhet në jetën rituale të klerikëve të krishterë.
- c) Asnjë i krishterë nuk do të detyrohet të hyjë në Islam.
- d) Marrëdhëniet fqinjësore me të krishterët do të vazhdojnë në mënyrë normale, si më parë. (Bejhaki, Delailu'n-Nubuvve, V, 383)





MBI LIGJËRIMIN POLITIK

Edlson Çeraj

Hyrje

Shtrohet pyetja: pse ligjërimi politik?

Duke qenë se sot gati në çdo vend të botës ligjërimi politik është përgjithësisht ai lloj ligjërimi, i cili zë më shumë vend se çdo ligjërim tjetër, atëherë edhe vëmendja ndaj tij është dhe duhet të jetë më e madhe, për faktin e vështirë për t'u provuar se ky ligjërim na drejtohet të gjithëve, mësyn drejt nesh. Por nuk është kjo arsyeja kryesore, pasi hapësira e madhe që zë një dukuri a një gjë e caktuar, jo me patjetër duhet të meritojë edhe vëmendjen më të madhe. Ajo që sipas mendimit tim e imponon këtë vëmendje ndaj këtij ligjërimi është ndikimi që ai ka te tjetri dhe më pas te njerëzit në përgjithësi. I jap përparësi fjalës **njerëz**, sepse fjalë si: masë, turmë, popull, grumbull, konsumatorë, madje dhe qytetarë, i ka fabrikuar pushteti, në mos pastaj, ka blerë copyright-in mbi to.

Ligjërimi politik na *in-formon*, pra na jep formë, sipas kuptimit literal të fjalës (është një ushqim i llojit të vet) për atë që ka ndodhur, për atë që ndodh dhe mbi të gjitha, përqendrohet fort rreth asaj që do të ndodhë. Ka një prirje për ta pronësuar të ardhmen, në mënyrë që të tregojë se e zotëron atë dhe kështu shkaktohet varësia ndaj pushtetit, gjë që kryen funksionin e zemrës në trupin e pushtetit.

Pra, posaçërisht e ardhmja shkakton më shumë varësi te ne ndaj këtij ligjërimi.

Edhe unë bëj pjesë tek ata që u ka shkaktuar varësi, prandaj dhe i hyra kësaj trajtесе.

In media res

Nuk pretendoj dhe as që marr përsipër të jap një përgjigje për këtë fenomen, aq më pak pastaj ta zgjidh atë, të paktën tani për tani; dua vetëm ta shtroj atë, ta bashkëndaj me ju, pasi shtrimi i një problemi të caktuar, shpeshherë është më i rëndësishëm në vetvete se zgjidhja e tij, ngaqë një zgjidhje e beftë që nuk i paraprin një parashtrim, një

bashkërendim, rrezikon të jetë e gjymtë dhe paradoksale (dukuri të cilën e hasim rëndom në ushtrimin e pushtetit, kur ky i fundit merr nisma dhe vendime), ndërsa një parashtrim i mirëkonceptuar dhe i matur, edhe nëse nuk ofron një zgjidhje të menjëhershme, na ndërgjegjëson për problemin.

Po e them shkoqur: çfarë fshihet dhe çfarë rri në gati-shmëri pas ligjërimin politik, përveçse vullnetit për pushtet dhe prirjes së papërmbajtshme për të kontrolluar. Megjithëse për disa kjo as që diskutohet, mendoj se ka akoma vend për diskutim, sepse kur bëhet fjalë për eksponentë apo vullnete të caktuara, nuk mund t'i fusim të gjithë në një thes dhe kështu, ata të cilët nuk janë të ngjuar vetëm te vullneti për pushtet si qëllim në vetvete, por synojnë rendin e drejtësisë (sido që të konceptohet, mjafton synimi drejt saj), do jenë të hapur, në një mënyrë apo në një tjetër, për të dëgjuar dhe për të lexuar se çfarë thuhet në adresë të tyre apo të rendit ku ata bëjnë pjesë. Pra, te **vullneti për pushtet** mund të gjendet edhe **vullneti për drejtësi**, sepse, në fakt, drejtësia nuk mund të ushtrohet pa pushtet. Drejtësia lipset ta ketë "hijen e rëndë" dhe për këtë i duhet një fuqi e caktuar, përndryshe ajo mbetet vetëm një ëndërr e bukur.

Kur hedhim vështrimin nga e kaluara e disa popujve apo në ndonjë rast edhe te e tashmja e tyre, duke admiruar një pushtet të caktuar për arritjet që ka pasur, nuk duhet të anashkalojmë faktin se kjo është pasojë e pushtetit të ushtruar, sepse si mund të bëheshin realitet arritjet, nëse nuk do përktheheshin në një organizëm që synon t'i jetësojë ato!

Edhe **vullneti për drejtësi** ka ligjërimin e vet, por ndryshimi ndërmjet ligjërimin për drejtësi dhe ligjërimin për pushtet është shumë i madh, madje janë dy botë dhe dy rende krejt të ndryshme, sepse kanë synime të ndryshme. Ligjërimi i vullnetit për pushtet synon ta reduktojë tjetrin

në mjet për të arritur pushtetin, synon ta shndërrojë në instrument (një banor që banon diku, me një numër banese dhe një dokument identifikimi), funksioni i të cilit duhet të jetë vetëm prodhimi dhe legjitimimi i pushtetit që do ushtrohet mbi të. Ndërsa ligjërimi i vullnetit për drejtësi synon të vetëdijesojë tjetrin që drejtësia nis pikërisht nga ai dhe kështu tjetri nuk i shërben vetëm pushtetit që do ushtrohet mbi të, por mbi të gjitha drejtësisë dhe këtë e bën në bashkëpunim me atë pushtet që synon drejtësinë.

Nuk di të ketë ndonjë mënyrë tjetër për të mbërritur te drejtësia, gjithnjë duke marrë parasysh atë drejtësi e cila ngrihet në sistem dhe qëndron mbi palët, që u imponohet vazhdimisht palëve me autoritetin e saj, domethënë, me pushtetin e saj. Pra, në këtë rast, pushteti dhe tjetri synojnë të njëjtën gjë: drejtësinë.

Te ligjërimi i **vullnetit për pushtet**, tjetri nuk është kurrë qëllim, por mjet i pashmangshëm, i domosdoshëm për të prodhuar pushtet, i patjetërsueshëm si i tillë, por i tjetërsueshëm si person për pushtetin si qëllim në vetvete.

Mekanizmat që tjetërsojnë janë të domosdoshme për të arritur kontrollin.

Pushteti në vetvete nuk është ndonjë çudi magjike, as ndonjë mister pa origjinë; është një marrëdhënie mes individësh përmes një organizimi pothuaj të pavetëdijshëm, që krejt pa prituri, nga të qenët *njeri*, bëhesh *ai*.

Nëse tjetri nuk u nënshtrohet rregullave të lojës për pushtet - sepse ai bën pjesë në një lojë ku numri i lojtarëve duhet të jetë sa më i madh, për të shfaqur një spektakël sa më të madh, ku rezultati nuk është asnjëherë i rëndësishëm; mjafton loja dhe spektakli i saj - atëherë ndaj tij ushtrohet një formë tjetër ligjërimi, krejt e posaçme për shkeljen e tij. Kjo formë tjetër ligjërimi ka të njëjtën përmbajtje, sepse ka të njëjtin synim. Ajo tjetërsohet në formë për të dëshmuar se sa e madhërisht është dhe mbi të gjitha, sa gjithëpërfshirëse; pikërisht, përmes gjithëpërfshirjes ajo i tregon tjetrit të madhërishten (pushtetin) ku ai duhet të bëjë pjesë, ndaj së cilës ai duhet të nënshtrohet për të mirën dhe të ardhmen e vet, ngaqë ai nuk ka zgjidhje dhe as zgjedhje tjetër. Nëse edhe kësaj forme të posaçme nuk i nënshtrohet, atëherë pushteti, duke qenë gjithëpërfshirës, prodhon normën bashkë me hipotezën, dispozitën dhe sanksionin e saj. Kështu, tanimë tjetri i nënshtrohet rendit praktik të pushtetit, duke u klasifikuar si shkelës, për të bërë të mundur lindjen e burgut ose si i çmendur, për të bërë të mundur lindjen e psikiatrisë. Pushteti e ka gjithnjë aftësinë për të të treguar vendin.

Por edhe rendi praktik i pushtetit (disiplina, qytetaria, masat ndëshkimore etj.), bëhet i mundur, por sidomos dhe mbi të gjitha, legjitimohet me anë të ligjërimit. Ligjërimi është karburanti i tij.

Me lindjen ose me shpikjen e psikiatrisë dhe të burgut, masat që merr pushteti (pushteti që synon pushtet me çdo kusht), jo vetëm që e legjitimojnë këtë të fundit, por përherë e më shumë ia shtojnë fuqinë. Si e tillë, kjo është një qeverisje racionale, e cila duke u nisur nga struktura që ka ngritur dhe nga natyra e saj, ajo kërkon t'i sistemojë

shkelësit në një kohë të papërcaktuar, dhe siç e thamë, ia del mbanë këtij qëllimi vetëm duke shtuar fuqinë gjith-saherë e ushtron atë.

Kur fuqia ushtrohet duke qenë e ngritur në sistem, ajo vetëm shtohet, duke u bërë përherë e më shumë edhe më titanike dhe shtypëse, si në rastin e komunizmit apo nazizmit, ku individit i mohon edhe të drejtat më kryesore që e bëjnë të jetë individ; apo si në rastin e sistemeve pasardhëse që ia dolën të përshtaten në formë, pra në emër, ku këto të drejta bazike për njeriun dhe njerëzoren si të tillë, vërtet pohohen, por duke u kontrolluar përmes përmbushjeve të përcaktuara dhe të ngritura në sistem, gjë që mund të jetë shumë herë më e dëmshme nga pikëpamja ontologjike sesa e para.

Njerëzorja, liria dhe ligjërimi për pushtet

Nëse ka një gjë, të cilën përmes trashëgimisë e quajmë *dinjtet njerëzor*, thelbi i gjithë këtij dinjteti qëndron te liria.

Liria është një temë/botë (që në fakt nuk mund të emërohet si *temë*) shumë e gjerë dhe shumë e vështirë për ta përkufizuar, për të mos thënë e pamundur dhe me sa duket, kjo është më e drejta që mund të thuhet. Kanti pati thënë se liria nuk kuptohet, ajo vetëm jetohe. Është e vështirë edhe për arsyen, se pse, njerëz, botëkuptime, ideologji, fe dhe filozofi të ndryshme kanë pasur kuptime të ndryshme rreth saj. Meqenëse ajo është diçka bazike për njeriun, është gjithmonë i rëndësishëm qoftë edhe një minimum kuptimi (i përbashkët) i drejtë i saj, i rolit të saj në jetën e njeriut dhe sidomos raportit ndërmjet lirisë dhe vetëdijes së përmbushjes së ekzistencës.

(Pikërisht këtu ndërhyjnë pushteti, si gjithnjë duke hedhur hapin e parë përmes ligjërimit. Këtë prirje ontologjike të qenies drejt përmbushjes së saj, në një mënyrë apo në një tjetër, gjë e cila nuk mund të jetë **kurrë e përcaktuar**, tamam këtë kërkon të bëjë pushteti, qoftë edhe ai religjioz, duke përcaktuar mënyrën e përmbushjes, lëvizjen, mendimin, ndjenjat, në ndonjë rast deri dhe ëndrrat e njeriut. Kjo ndërhyrje nuk është vullnet për njohje; është vetëm për të kontrolluar me anë të përcaktimit, si për shembull, shpikja e qytetarit dhe qytetarisë, si modele/standarde që duhen ndjekur për të qenë i "denjë". Pa këtë sistem kufizimi, i cili përcakton pothuaj të gjithë sjelljen publike të individëve, të paktën atë aspekt që është më prodhimtar për pushtetin, nuk mund të bëjë dot asnjë pushtet. Këto janë rituale të mirëfillta, që ndryshe nga ritualet e religjionit, individët janë të detyruar t'i ndjekin me çdo kusht, pavarësisht nga fakti se sa janë dakord.)

Dinjteti njerëzor ngrihet pikërisht mbi lirinë e tij. Të gjitha arritjet më të larta njerëzore janë bërë nga mirëushtrimi i lirisë. Nga kequshtrimi i saj, tragjikisht janë bërë edhe fatkeqësitë më të mëdha të njerëzimit. Ajo është në themel të qenies njerëzore dhe ushtrimi i saj, për mirë apo për keq, ka pasur gjithmonë pasojat të jashtëzakonshme për njeriun. Meqë ekzistenca jonë përmbushet përmes ushtrimit të lirisë, atëherë mund të themi se liria është *condicio sine qua non* e njerëzores.

Pushteti, me anë të ligjërimit tipik të tij, siç e thamë

më lart, bën marrëveshje me individët (natyrisht edhe anasjelltas), dhe kështu mbërrihet deri te një pikë/rezultat, i cili që në çastin që përftohet, shkakton varësi gati të paimagiinueshme ndërmjet pushtetit dhe individëve. E gjithë marrëdhënia që përshkallëzohet në të ardhmen varet pikërisht nga varësi e ndërsjellë. Në pamje të parë, ata të cilët dëmtohen më shumë për sa i takon ushtrimin të lirisë janë individët, por nuk është kështu, sepse eksponentët që ushtrojnë pushtetin dhe e zgjatojnë atë, mendojnë se njëkohësisht po ushtrojnë edhe lirinë, duke qenë se shkojnë me idenë se janë ata që vendosin, ndërkohë që në thelb nuk kanë si të bëjnë ndryshe: ata duhet që gjithnjë të vendosin, për shkak se këtë ua kërkon pareshtur pushteti. Ata nuk i shërbejnë vetes, ose i shërbejnë për aq sa është diktuar paraprakisht dhe për aq sa diktohet në të ardhmen në lidhje me shtrirjen/zgjerimin e pushtetit. Me pak fjalë, për t'u shprehur me një metaforë të varfër, ata janë të kapur për t'i shërbyer lokomotivës e jo vetëm kaq; ata duhet të kujdesen edhe për numrin dhe gjendjen e vagonëve.

E sa u takon individëve të udhëhequr, të cilët prodhojnë pushtet, sigurisht që shumëçka e kanë të përcaktuar dhe liria e secilit kalon mbi këto përcaktime, por secili e ka mundësinë që një ditë të vetëdijësohet për diçka që nuk shkon tek eksponentët e pushtetit ose te vetë pushteti që kanë prodhuar. Ka mundësi që një ditë "të heqë dorë", të rebelohet, të çmendet (për aq sa është pa shkuar në psikiatri), meqë nuk ka asgjë për të humbur, përkundrazi, mund të rifitojë individualen që kishte bërë pakt dhe gjithaq, rasti i tij mund të shërbejë për shoqërinë, për të trandur sakaq ato ndërgegje të topitura. Domethënë, ky është një akt që shenjon dinjitetin e personit njerëzor, që siç pohonte Kanti, është qëllim e jo mjet. Besoj se këtu ka diçka nga liria, aq sa mund të ketë.

Ligjërimi për pushtet dhe dija si pushtet

Besoj se çdo pushtet i ka rrënjët në një dije/filozofi/botëkuptim të caktuar, në mos te një besim i caktuar, që gjithsesi e vetvetiu është i tillë, për aq sa mbështet te një botëkuptim; pra, mendoj se nuk ka dalje nga ky rreth vicioz.

Deri këtu, sigurisht që nuk ka asgjë të keqe, dhe mund të shprehem gjysmëfigurativisht me Nietzsche-n se çështja është "përtej së mirës dhe së keqes"; i gjithë problemi shfaqet në çastin kur një pushtet i caktuar rreh të monopolizojë kuptimin mbi të drejtën dhe të padrejtën, të ligshmen dhe të paligjshmen, normalen dhe anormalen, njeriun me 'aftësi të kufizuara' dhe atë me aftësi të pakufizuara (!) etj.

Më sipër pohova se pushteti nis me ligjërimin dhe vazhdon të shtrihet e të fuqizohet përmes tij, pra në varësi të dinamikës së tij. Po ashtu, thashë se ligjërimi ka instrumentet e tij kufizues dhe kontrollues apo më saktë, le ta rikompozoi këtu: ligjërimi kontrollohet dhe kufizohet gjithaq, kuptohet nga eksponentët të cilët e prodhojnë

dhe prodhohen prej tij. Ligjërimi për pushtet e fuqizon agjentin përdorues dhe njëkohësisht, vetë ligjërimi fuqizohet. Kështu, nga individ apo nga grupi që synon pushtet, ndërtohet një *status quo* e përcaktuar dhe e organizuar, e cila duke pasur veçantitë e saj të ngritura në një hierarki, mban dyert e mbyllura për çdokënd që synon të bëjë pjesë aty, përveçse në rastet kur kjo hierarki respektohet, pasi ajo është bërë e tillë, pra me pushtet, duke qenë e tillë. Arsyetimi është bindës, por i mbyllur: nuk pranon asnjë diskurs interpretues ose, në rastin më të mirë edhe kur e pranon nuk jep asnjë përgjigje, por e mënjanon duke e kaluar në heshtje. Është një nga ato raste ku heshtja nuk është pohim, por mohim i papërballueshëm.

Duke qenë se ai që synon të bëjë dhe të bëhet pjesë e një pushteti (rasti i partive politike), vjen me një apo disa propozime (duke lënë mënjanë propozimet shterpë që thurin lavde për kreun apo gjendjen ekzistuese), të cilat mbështeten te një dije e caktuar, te një filozofi e caktuar, natyrisht ky propozim, ky mendim tjetër, vjen përmes një ligjërimi tjetër, i cili nis të përballet me ligjërimin e suksesshëm ekzistues, pikërisht në këtë pikë nis edhe puna e organizuar e sistemit imunitar për të luftuar trupin e huaj ose duke ndërmarrë një përjashtim që ka të bëjë me aftësinë se sa është i gatshëm dhe i aftë ky trup i huaj të përshatet, në të kundërt ai luftohet derisa nxirret jashtë.

Pra dija mbetet një pushtet, fuqia e të cilit varet që nga forma e ligjërimit e deri te përkthimi i saj në një sistem.

Lufta që i bëhet trupit të huaj (pra, dijes tjetër ose të ripërtërirë) në rastin kur ai nuk përshatet, është tipike e pushteteve që kanë qëllim vetëm pushtetin, që synojnë një kontroll sa më të madh dhe sa më të përsosur, kryesisht duke ngritur dhunën në sistem, siç ndodhte dje në sistemet totalitare dhe siç ndodh sot me lojën e rrezikshme të ekonomisë së përqendruar (Banka Botërore dhe FMN-ja), duke e ngritur borxhin/kredinë në sistem, për të shkaktuar kështu një varësi e cila njih vetëm rritje dhe shtrirje në jetën e individit dhe rrjedhimisht edhe të popujve.

Nuk më duket dhe aq naiv një konstatim, të cilit nuk ia di burimin, ku thuhet se dikur (jo dhe aq *dikur*) punonte vetëm kryefamiljari dhe mjaftonte për të gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes, madje linte dhe trashëgimi, ndërsa sot punojnë të gjithë pjesëtarët e familjes dhe përherë e më shumë nuk mjafton, le pastaj për trashëgimi që nuk bëhet fjalë, por fëmijët me të hyrë në punë duhet të vazhdojnë të shlyejnë kreditë labirintike që u kanë lënë trashëgim prindërit.

(Mendoj se ky është rrafshi për të cilin lipset të shqetësohemi, pra është e domosdoshme një fenomenologji e ekonomisë, sepse përcapjet pafund nëpër labirintet e saj, duke e marrë si të mirëqenë dhe progres çdo rend të ri që hyn në fuqi, na shndërrojnë në konsumatorë të nënshtruar në vend që të jemi të vetëdijshëm për përdorimin racional të saj. Ky është rasti ku nënshtrimi dominon mbi

Ligjërimi që synon drejtësinë thërret natyrshëm edhe dijen mbi të, dhe në fakt, vetëm me këtë dije mund të arsyetohet dhe legjitimohet;

racionalen, dua të them mbi mendimin. "Mos mendo, sepse mendojmë ne për ju", thuhej dhe lexohej në një reklamë.)

Dita jonë është e mbërthyer fort nga kjo varësi e frikshme, që në një mënyrë apo në një tjetër, të jetuarit na kujton personazhet e Kafka-s dhe të Beckett-it, ku njëri arrestohet se me gjasë paskësh bërë një faj, tjetri nuk ka kohë, një tjetër është i detyruar të presë, sepse nuk ka zgjedhje tjetër etj.

Ligjërimi për drejtësi dhe domosdoshmëria e dijes

I gjithë reflektimi i Platonit pas dënimit me vdekje të Sokratit është mbi drejtësinë dhe dijen; mbi atë se si ishte e mundur të dënohej me vdekje njeriu që sipas Platonit, ishte më i drejti dhe më i dituri i kohës. Pa dyshim që diçka çalonte në qeverisjen e qytetit shtet. Pikërisht për këtë Platoni diskutoi gjatë në kuvendimet e tij.

Platoni nuk e konceptonte dot drejtësinë të pashoqëruar me dije, sepse drejtësia së pari është dije; ajo do përcaktuar dhe përkufizuar, do kuptuar, dhe më pas vjen aspekti po aq i rëndësishëm i saj - ai praktik, pra ushtrimi i saj; prandaj ajo nuk mund të ushtrohet ndryshe veçse duke e njohur, sepse një ushtrim i saj pa e njohur, pra pa dije, sjell tiraninë ose anarkinë.

Ligjërimi që synon drejtësinë thërret natyrshëm edhe dijen mbi të, dhe në fakt, vetëm me këtë dije mund të arsyetohet dhe legjitimohet; jo vetëm kaq, por përmes dijes fiton pushtetin si domosdoshmëri për të pasur fuqi dhe pavarësi mbi palët.

Çfarë mund të thuhet për kontekstin shqiptar?

Gjithë çfarë kam shkruar deri më tani, sipas mendimit tim vlen edhe për ligjërimin politik në kontekstin shqiptar, duke qenë se përpjekja ime është trajtimi, - dhe kuptimi aq sa është i mundur - i ligjërimin si të tillë, pavarësisht kohës dhe hapësirës ku paraqitet, madje e kam të vështirë ta besoj se ka ndonjë kohë apo hapësirë, ku ai të mos ketë qenë i pranishëm, mjaft që të jenë më shumë se dy vetë.

Një nga "avantazhet" tona si shoqëri në këtë drejtim është mësimi nga përvoja e kombeve dhe e shteteve më të hershme se ne për nga konsolidimi dhe zhvillimi i mekanizmave të ligjërimin për pushtet apo për drejtësi. Ne mund të mësojmë shumë nga individë dhe grupe të caktuara të këtyre shteteve, të cilët shquhen për një kuptimësi dhe një vetëdije mbi ligjërimin politik që ushtrohet, kuptimësi dhe vetëdije, e cila ka arritur rezultate të caktuara, dhe prandaj, në shumë raste, të tillë individë dhe grupe janë shpallur *non grata* nga pushteti apo nga qarqe institucionale (kryesisht akademike, studimore, kërkimore etj.) të cilat ushqehen nga qeveritë.

Shumë studiues, analistë dhe aktivistë, mendojnë dhe ngulmojnë se ndërgjegjja e njerëzve është e topitur për shkak të pasivitetit dhe prandaj kësaj gjendjeje i përgjigjet ky lloj diskursi politik dhe kjo formë e të bërit politikë, pavarësisht disa shenjave që herë ndizen e herë shuhen, të cilat tregojnë njëfarë pjekurie, edhe kjo shumë e diskutueshme, por megjithatë ekziston.

Mendoj se dalja nga pasiviteti nuk vjen duke vepruar me çdo kusht, për të treguar se jam edhe unë, por për t'iu rikthyer asaj që sapo theksova më lart, duke kaluar së pari

nga një kuptimësi dhe vetëdije mbi atë që ndodh, për të pasur kështu një motivim të qenësishëm, i cili e mbron njeriun nga kompromisi apo përdorimi që mund t'i bëhet/ ofrohet gjatë rrugës.

Me fort të ngjarë, ky është dhe një nga shkaqet kryesore që njerëzit e kanë humbur besimin te përfaqësuesit e tyre në Parlament, saqë kanë pranuar në mënyrë thuajse fatale se është normale që politikanët të ndjekin interesat e tyre, pavarësisht ligjërimin dhe se mbrojtja e interesave të njerëzve është më tepër një instrument marketingu, ose nganjëherë edhe thjesht një aksident politik.

Nga e kaluara jonë komuniste, gati pesëdhjetëvjeçare, duhet të kishim mësuar më shumë; nuk mjaftojnë vetëm rrëfimet për atë periudhë, të cilat zënë një hapësirë të madhe në mediat tona elektronike dhe të shkruara, sepse rrëfimi pa vështrimin analitik merr statusin e një narrative, dhe duke pësuar këtë shndërrim, shkakton njëfarë ndjenje nostalgjje, e cila paralizon të menduarit dhe arsyetimin mbi atë që është reale, dhe si e tillë e jetuar, duke u kthyer kështu në një lexim, i cili shërben vetëm për të shuar kërshtërinë e manipuluar.

Duhet të mësojmë nga ajo periudhë, sepse ligjërimi politik ishte maksimalisht i njësuar dhe i lexueshëm, i zhveshur, pa asnjë rrobë, domethënë ai i përcaktonte haptazi armiq të tij dhe në fakt këtu qëndron e mira e vetme që i bënte njerëzve, sepse u tregonte hapur se me kë kishin të bënin, pasi armiku më i rrezikshëm i njeriut nuk është armiku (që e shfaq haptazi armiqësinë), por ai që duket si mik.

Konkluzion

Do të doja të zgjatesha më shumë, sepse problematika paraqitet me shumë kahe dhe secili kah ka karakteristikat e veta; unë u orvata të shtroj vetëm njërin syresh. Pra, qëllimi im nuk ishte të propozoja një zgjidhje apo një alternativë; doja vetëm ta shtroja për diskutim, duke pasur bindjen se kjo është një problematikë që kërkon një vëmendje të posaçme, ngaqë sikurse thotë Foucault-ja, "pushteti është marrëdhënie midis individëve", thënë me fjalë të tjera, jemi ne ata që e prodhojmë pushtetin, dhe më pas, aty për aty (aq beftë...), këtë prodhim e marrin disa prej nesh dhe bëhen ata që bëhen.

Nëse kjo është e vërtetë, atëherë ne jemi përgjegjës vetëm individualisht për atë që prodhojmë, por sidomos për mënyrën se si përdoret prodhimi ynë.

BURIMET

1. Hasimja, E. (2011) *Domethënia e sloganeve të fushatës*. Tiranë: Gazeta Panorama (30/3/2011)
2. Taylor, Ch. (2008) *Etika e autenticitetit*. Tiranë: ISP & Dita 2000.
3. Liotar, J.F. (1996) *Gjendja postmoderne - raport mbi dijen*. Pejë: Dukagjini.
4. Heidegger, M. (2010) *Letër mbi humanizmin*. Tiranë: Plejad.
5. Kajsio, B. (2005) *Ligjërime steril*. Tiranë: Revista Politika & shoqëria, vëll. 8, nr. 1 (15), 2005.
6. Foucault, M. (2009) *Pushteti dhe dija*. Tiranë: ISP & Dita 2000.
7. Monuier, E. (2006) *Personalizmi*. Tiranë: ISP & Dita 2000.
8. Platoni. (1999) *Republika*. Tiranë: Phoenix.

Te hexhudi, namazi i natës

Idris Arpat

Në natyrën e njeriut ekziston gjithmonë dëshira për të shprehur dashurinë, respektin dhe devotshmërinë ndaj Allahut. Për këtë arsye, njeriu përpigjet t'afrohet Allahut nëpërmejt mendimeve, ndjenjave dhe sjelljeve të ndryshme. Në këtë mënyrë, çdo veprim që kryhet për hir të Tij, është ibadet. Çdo fe ka ritet e saj karakteristike. Në këtë shkrim do të trajtojmë namazin e tehexhudit, namazin më të rëndësishëm pas namazeve obligative. Koha, forma dhe mënyra e kryerjes së tehexhudit është e ndryshme nga namazet e tjera. Veçanërisht, ky namaz kryhet në një mjedis të qetë, larg zhurmës dhe larg syfaqësisë. Kurani lajmëron se namazi ka qenë një ibadet i detyrueshëm edhe për pejgamberët e popujt para Islamit. **“Ne i bëmë ata udhëheqës, që udhëzonin sipas urdhrin Tonë dhe i frymëzuam të bënin vepra të mira, të kryenin faljet dhe të jepnin zeqatin, dhe ata vetëm Ne na adhuruan.”** (Enbija, 73)

Në disa ajete është vënë theksi mbi shtyllat e namazit, siç është rukuja dhe sexhdeja, kurse disa ajete të tjera shprehin ndikimin e madh që ka namazi mbi individin, duke e mbrojtur nga rënia në mëkate dhe inkurajuar për punë të mira. **“Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur ty prej Librit (Kurani) dhe fale namazin! Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar dhe vërtet që përmendja e Allahut është më e madhe! Allahu di gjithçka që ju bëni.”** (Ankebut, 45)

Njeriu, siç e ka të nevojshme të ushqehet nga fizikja për të mbajtur trupin gjallë, e ka të nevojshme të ushqehet nga metafizikja për të mbajtur shpirtin gjallë. Namazi është “buka” e përditshme e shpirtit. Namazi nuk ndikon vetëm jetën shpirtërore, por ndikon edhe në mjedisin rrethues, duke e futur në disiplinë jetën materiale dhe sociale. Nga ky këndvështrim, namazi është i gjithi pastërti, bukuri, hijeshi dhe lumturi. Pejgamberi (a.s.), duke dashur ta përjetonte shpesh këtë kënaqësi, kur afronte koha e namazit i drejtohej me dëshirë dhe mall, Bilalit (r.a.): **“O Bilal, çohu thirre ezanin që të qetësohemi”**.

Pejgamberi (a.s.), e ka konsideruar veçanërisht namazin si shtyllën e fesë, miraxhin dhe dritën e besimtarit. Ndërsa kryerjen e namazit në kohën e caktuar, e ka konsideruar si veprën më të mirë (Buhari, Evkatus-Salat, 8/5) Në një hadith tjetër e ka përngjasuar namazin me një lumë që rrjedh para shtëpisë. Ashtu si një njeriu që lahet pesë herë në ditë në lumë, nuk i mbetet asnjë papastërti në trup edhe njeriut që kryen pesë namazet e ditës, pastrohet nga gjithë mëkatet. (Buhari, Evkatus-Salat, 8/6). Selman Farisiu transmeton një ngjarje interesante nga Pejgamberi (a.s.): Një ditë ishim ulur me Pejgamberin (a.s.), nën hijen e një peme, kur Ai (a.s.), mori në dorë një degë peme të thatë

dhe e shkundi deri sa i ranë të gjitha gjethet. Pastaj tha: "O Selman! A e di përse veprova kështu? Kur e pyeta, m'u përgjigj: "Kur një mysliman merr abdest në mënyrë korrekte dhe fal pesë namazet, atij i bien mëkatet porsì gjethet e kësaj dege." Pastaj këndoi ajetin kuranor: **"Fale namazin në mëngjes e mbrëmje dhe në një kohë të natës, sepse veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija. Kjo këshillë vlen për ata që i pranojnë këshillat."** (Hud,114)

Njeriu përmes namazit gjen rastin të lidhet dhe t'i lutet drejtpërdrejt Allahut. Në këtë mënyrë fiton imunitet kundrejt vështirësive dhe shqetësimeve të kësaj bote. Ndikimin e fuqisë së namazit mbi jetën e njeriut, Dr Alexis Carrel e shpjegon kështu: "Mund të them pa frikë se namazi është nga burimet më të mëdha të fuqisë dhe forcës që njohim. Unë personalisht si doktor, jam dëshmitar i shumë e shumë rasteve të ndikimit të namazit mbi pacientët e mi. Jam përballur me shumë pacientë, me të cilët kam mbetur i pafuqishëm për t'i kuruar, por namazi ka ndërhyrë në jetën e tyre duke u bërë një burim i pashtershëm energjie." (Jusuf el Kardavi, Ibadet, 314)

Fjala tehexhud, në gjuhën arabe vjen në kuptimin: u zgjua nga gjumi, kurse, kur kalon në Kuran dhe hadith, është në kuptimin: u zgjua natën për të lexuar Kuran apo falur namaz. Në këtë mënyrë, tehexhudi shpreh namazin që falet natën, ndryshe quhet edhe namaz nate. Ky namaz kryhet në një të tretën e fundit të natës dhe vazhdon deri në agim. Namazi i tehexhudit falet si të gjithë namazet e tjera. Minimumi i rekateve që duhen falur është dy, por mund të falen edhe më shumë sipas dëshirës. Transmetohet se Pejgamberi (a.s.), ka falur dy, deri në dymbëdhjetë rekate namaz nate. Ky namaz ka qenë obligim vetëm për Pejgamberin (a.s.), kurse për umetin e tij është namaz vullnetar. Pejgamberi (a.s.), namazin e natës e falte të zgjatur, gjatë qëndrimit në këmbë këndonte sure të gjata, gjatë rukusë dhe sexhdes lutej gjatë. Nga disa hadithe informohemi se kishte raste që Pejgamberit (a.s.), i enjteshin këmbët nga qëndrimi i gjatë në namaz. Ky është një tregues i rëndësisë së namazit të natës. Pejgamberi (a.s.), për të shprehur dashurinë për këtë namaz, në çdo rast thoshte: "Dy rekate namaz nate për mua janë më të vlefshme se mirësitë e gjithë botës." (Buhari, Iman, 39) Në një hadith tjetër, kur u pyet për namazin më të mirë pas farzeve, tha: "Namazi i natës." (Muslim, Sijam, 203)

Ajeti kuranor: **"Padyshim që adhurimi natën vepron më fuqishëm dhe fjala është më shprehëse."** (Muzzemmil, 6), aludon për ndikimin që ka ibadeti dhe

lutja në ato momente të qeta të natës mbi shpirtin e besimtarit. Pra, ibadeti i natës i jep një qetësi krejt të veçantë shpirtit.

Jeta jonë rrethohet nga dy segmente kohore, dita dhe nata. Dita i shërben njeriut për veprimarinë e tij jetësore, kurse nata i shërben për të pushuar, menduar dhe vlerësuar të shkuarën. Çdo njeri ka nevojë për këtë mjedis të qetë të paqte. Sepse nata është burimi kryesor i mendimit dhe reflektimit. Kur vlerësohet siç duhet, ushqen shpresë për rininë dhe qetësi për të moshuarit.

Namazi i natës është një moment dliresie, purifikimi dhe qartësimi për çdo njeri dhe për çdo kohë. Miqtë dhe të dashurit e Allahut e kalojnë një pjesë të natës patjetër në namaz, sepse koha e seherit' është burim ibadeti dhe mëshire. Kurani nxit besimtarët për lutje dhe namaz nate. Dhe kush i përgjigjet kësaj thirrjeje, do të ketë falje e amnisti nga Allahu. **"Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe**

japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne." (Es-sexhde, 16) **"Allahu i vrojton robërit e vet, që thonë: 'Zoti ynë! Me të vërtetë kemi besuar, andaj na i fal mëkatet tona dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit, që janë të duruar, të sinqertë, të devotshëm në adhurimin e Allahut, që japin lëmoshë dhe kërkojnë faljen e mëkateve para agimit."** (Al'Imran,16-17)

Duke iu dhimbsur Pejgamberi për këmbënguljen dhe lodhjen e Tij gjatë namazit të natës, besimtarët i thanë për t'ia kujtuar: "A nuk je i falur Ti nga Allahu?" Ai dha këtë përgjigje mbresëlënëse për gjithë njerëzimin: "Pse të mos jem një rob që falënderon Allahun?" (Buhari, Tehexhud, 6)

Pejgamberi (a.s.), akoma pa iu zbuluar shpallja kuratore, kishte dëshirë të qëndronte vetëm dhe të mendonte për Krijuesin. Për këtë qëllim, kishte zgjedhur shpellën Hira. E gjitha kjo ishte një përgatitje për punën dhe përgjegjësinë e madhe që e priste.

Fatkeqësisht, sot jetojmë një jetë të zhurmshme, ku njeriu kthehet i lodhur në shtëpi, ku hipokrizia, syfaqësia, gënjeshtria, dredhia janë shndërruar në profesione. Hallalli, harami pothuajse janë fshirë nga kujtesa. Stresi, brengat, hidhërimet po e mbysin njerëzimin. Përballë këtij realiteti, i vetmi moment qetësimi dhe shpëtimi nga shqetësimet e kësaj bote është namazi i natës. Sa mirë për ata që e shfrytëzojnë si duhet këtë thesar!



1. Një e treta e fundit e natës.

Ngrihu dhe paralajmëro

Në suren el-Muddeththir (1-7) thuhet kështu: **“O ti i mbështjellë (o Muhamed)! Ngrihu dhe paralajmëro (njerëzit)! Madhëroje Zotin tënd! Pastroji rrobat e tua! Largohu nga ndyrësia (adhurimi i idhujve)! Mos u mburr me atë që jep e të duket shumë dhe duro për hir të Zotit tënd!”**

Këto ajete kanë zbritur në fillim të periudhës së Mekës, pas ndërprerjes së shpalljes. Sipas asaj që thuhet në tefsir, kur i Dërguari i Allahut (s.a.s.), po qëndronte vetëm në shpellën Hira, dëgjoji një zë. Shikoi rreth e rrotull, por nuk pa gjë. Kur ngriti kokën e tij të bekuar, pa Xhebrailin, alejhîs-selam, që qëndronte ndërmjet qiellit dhe tokës. Kur shkoi në shtëpi, tha: **“Më mbuloni!”**

Ja, pas kësaj kanë zbritur shtatë ajetet e para të suren el-Muddeththir. Emocioni që fillonte me urdhrin hyjnor: **“Lexo!”**, tashmë u rinovua me urdhrin tjetër: **“Ngrihu dhe paralajmëro (njerëzit!)”**

Tashmë, duke i radhitur me tema urdhrat që i janë dhënë të Nderuarit tonë (a.s.), dëshirojmë t’i japim përgjigje pyetjes: **“A mund ta mbartim një hap më përpara pishtarin, i cili është ndezur me duart e tij?”**

“Ngrihu dhe paralajmëro (njerëzit!)” Ky ajet shpjegohet kështu në tefsir: **“Ty të është dhënë një detyrë e madhe. Paralajmëroji ata që ndodhen përreth teje para se t’i kaplojë një ndëshkim i papërballueshëm. Qortoji ata në lidhje me të ardhmen e tmerrshme, me të cilën një ditë patjetër do të takohen. Thuaju atyre:**

“Ju nuk jetoni në sulltanetin e sulltanit të shurdhër e memec. Bëni çfarë të dëshironi, por mos harroni se nuk jeni në një vend ku nuk do të merreni në llogari!”

Ne duhet ta mbajmë të gjallë dhe ta kujtojmë aq

sa të kemi mundësi ndjenjën “një ditë do të jap llogari”, sepse gabimet e njerëzve në përgjithësi burojnë nga fakti se ata e harrojnë të vërtetën “që do t’i japin llogari të Plotfuqishmit, i Cili shikon dhe di çdo gjë, në çdo moment”...

“Madhëroje Zotin tënd!” Kuptimi i këtij urdhri hyjnor, i cili zbriti në një mjedis ku të gjithë ishin politeistë, duhet të jetë kështu: Nëse ti thua të vërtetën, Allahu, xhelle xhelaluh, do të të ndihmojë patjetër. Atëherë nuk ka rëndësi nëse e gjithë bota do të mbajë pozicion kundër kësaj.

Të njohim madhështinë e Allahut, t’ua mësojmë atë të tjerëve dhe të themi se këtë madhësi nuk e meriton askush përveç Allahut, përbën misionin tonë të vërtetë dhe të vetëm.

“Pastroji rrobat e tua!” Pastroji rrobat nga papastërtitë dhe mbaji të pastra, sepse pastërtia e trupit dhe e rrobave sjell pastërtinë shpirtërore. Një shpirt i pastër nuk mund të jetë rehat në një trup dhe në një rrobë të papastër. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ua ka mësuar njerëzve të gjitha detajet në lidhje me pastrimin e trupit dhe të rrobave.

Në të njëjtën kohë, këtë urdhër mund ta kuptojmë si pastrim të rrobave edhe nga imoraliteti. Rroba e myslimanit duhet të jetë e pastër, e rregullt dhe larg papastërtive shpirtërore, si shtirja dhe syfaqësia.

“Largohu nga ndyrësia (adhurimi i idhujve!)” Fjala “ruxhz” në ajetin fîsnik, e cila është përkthyer si “ndyrësi”, përfshin çdo gjë të shëmtuar dhe të papastër. Këtu përfshihet çdo gjë e keqe që mund të gjendet në akide (doktrinë), mendim, moral, vepër dhe trup. Atëherë myslimani duhet të qëndrojë larg çdo lloj ndyrësie, edhe nëse është përhapur shumë

apo është bërë imponuese dhe duhet të përpiqet të jetë i pastër.

“Mos u mburr me atë që jep e të duket shumë!”

Kuptimi i kësaj është ky: Bëj të mira, ji bujar dhe zemërgjerë, por të gjitha këto le të jenë vetëm për hir të Allahut. Kur të bësh një punë për hir të Allahut, kurrë mos thuaj: “Unë kam bërë këtë.”

Nga të gjitha këto që thamë më sipër, kuptojmë se ka shumë njerëz që flasin keq për ata që dalin në rrugë për të ftuar njerëzit në rrugë të Allahut, por një njeri që mundohet ta jetojë Islamin dhe ta përhapë atë, duhet të durojë për hir të Allahut ndaj të gjitha vështirësive që i dalin përpara. Asnjë pengesë nuk duhet ta ndalojë të thotë ashtu siç e di atë gjë që e di si të vërtetë...

Suret el-Muzemmil dhe el-Muddeththir kanë zbritur në një kohë të afërt me njëra-tjetrën. Njëra urdhëron *kijamin* natën për të qëndruar në audiencën e Zotit, ndërsa tjetra *kijamin* ditën, për të predikuar Islamin. Kështu që, nëse i vlerësojmë bashkë ajetet e para të tyre, në lidhje me ajetet që përbëjnë temën tonë, mund të themi:

Ajetet e sures el-Muzemmil e ngritën në këmbë të Dërguarin e Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, për të shpallur madhështinë e Allahut. Ai i njohti njerëzit me Islamin, duke filluar nga më të afërmit, si Hazreti Hatixhja (r.a.) dhe Hazreti Aliu (r.a.). Pastaj e zgjati dorën e tij të bekuar deri te Selmani, Suhejbi etj. Kështu prej qindra vitesh e deri sot Profeti (a.s.) vazhdon të thërrasë besimtarët, të cilët i quan “vëllezërit e mi”...

Për këtë arsye, vetes sonë mund t’i bëjmë këto pyetje: Me çfarë ndjenjash i lexojmë ajetet që e kanë entuziazmuar të Dërguarin e Allahut (s.a.s.)? Sa i harxhojmë mundësitë dhe kohën tonë për ta gdhendur nëpër zemra fjalën “Allahu ekber”? Sa na lë pa gjumë fakti që njerëzit përpëliten në mohim dhe skamje?

Sa e kemi parasysh mirësjelljen dhe politesën që Islami i jep përparësi në të folurit dhe në të qëndruarit tonë si një mysliman? A mund të themi se i kemi zbatuar me plot kuptimin e tyre ajetet që përbëjnë temën tonë, përderisa nuk i gdhendim në zemër këto pyetje dhe të tjera të ngjashme me to?

Lexo, Mendo

Cilit grup i përket?

Në suren el-Fatir, thuhet: **“Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të zgjedhur (nga ndjekësit e Muhamedit a.s.). Disa prej tyre i bëjnë padrejtësi vetes (duke bërë vepra të ndaluara), disa janë në rrugë të mesme (duke kryer detyrimet dhe duke shmangur të ndaluarat), ndërsa disa, me lejen e Allahut, garojnë në të mira (përtej detyrimeve); kjo është dhuntia e madhe.”** (Sureja el-Fatir, 32)

Këtu bëhet fjalë për tri gjendjet e atyre që janë bërë trashëgimtarë të fjalës së Allahut: ata që i bëjnë padrejtësi vetes, ata që janë në rrugë të mesme dhe ata që garojnë në të mira...

Ata që i bëjnë padrejtësi vetes, janë besimtarët mëkatarë, sepse ata i bëjnë padrejtësi vetes duke bërë mëkate.

Megjithatë, ata nuk janë nxjerrë jashtë trashëgimisë së librit të Allahut.

Ata që janë në rrugë të mesme, janë besimtarët që i zbatojnë mangët kushtet për të qenë trashëgimtarë të Librit. Këta nganjëherë bëjnë mëkate duke toleruar, edhe pse përpiqen t’i zbatojnë urdhrat e Allahut. Ata janë më pak se grupi i parë dhe më shumë se grupi i tretë në numër.

Ata që garojnë në të mira me lejen e Allahut vijjnë në krye të trashëgimtarëve, sepse i zbatojnë kushtet e Islamit. Jetojnë brenda kornizave të Islamit dhe i predikojnë ato gjëra që i dinë. Përpiqen të jenë të parët në mirësi, nuk bëjnë mëkate me dijeni dhe, kur bëjnë ndonjë gabim, pendohen menjëherë. Këta janë përmendur më në fund, për shkak se janë më pak në numër nga grupi i parë dhe i dytë.

Për t’u bërë prej atyre të paktëve të të paktëve, duhet të shikojmë patjetër se cilit prej tre grupeve që përmenden në ajetin fisnik i qëndrojmë më afër.



Librari Progresi

Libraria Progresi prezanton librin

Titulli: Vargu i Profetëve

Autor: Osman Nuri Topbash

Botues: Shtëpia botuese Progresi



Vepra "Vargu i Profetëve" (ndarë në katër libra), fillon me njeriun dhe profetin e parë Ademin (a.s.) e me radhë në kronologji kohore me Idrisin (a.s.), Nuhun (a.s.), Hudin (a.s.), Salihun (a.s.), Ibrahimin (a.s.), Ismailin (a.s.), Is'hakun (a.s.), Lutin (a.s.), Dhulkarnejnin (a.s.), Jakubin (a.s.), Jusufin (a.s.), Shuajbin (a.s.), Musain (a.s.), Dautin (a.s.), Sulejmanin (a.s.), Ejubin (a.s.), Junusin (a.s.), Iljasin (a.s.), Eljesin (a.s.), Dhulkiflin (a.s.), Lukmanin (a.s.), Zekerian (a.s.), Jahjan (a.s.), Isain (a.s.) dhe mbaron me Profetin Muhamed Mustafa, sallallahu alejhi ve sel-lem, hallka e parë dhe e fundit e vargut të profetëve, zotëria i dy botëve, Profeti i njerëzve dhe i xhindeve, imami i imamëve, drita e ekzistencës, profeti i dërguar si mëshirë për botët.

Për secilin nga profetët del në pah roli, personaliteti, profesioni, detyra, grada, mrekullia dhe dialogu me parinë e popullit ku u dërguan. Aty shohim cilësitë që Zoti u ka rezervuar profetëve qysh në krijimin e shpirtave e më vonë edhe në jetën tokësore. Për shkak të detyrës së vështirë që kanë patur Allahu i Lartmadhëruar u ka dhënë pamje e urtësi, që t'u flasin popujve të tyre për të Vërtetën. Të gjithë ishin njerëz siç jemi edhe ne sot, por depërtimi i tyre në realitetet e Zotit dhe të botës ka qenë sigurisht shumë i veçantë, i pajisur me udhëzim, de-

vot-shmëri,
besnikëri
dhe bindje të lartë ndaj
Krijuesit. Siç shprehet shejkh Osmani:
"Allahu i Lartë i ka dërguar profetët si qendër shërimi prej plagëve shoqërore të hapura prej dëshirave egoistike. Ata që janë mashtruar prej stolive të rreme të kësaj bote, janë ndarë prej horizonteve të ndritshme të hapura prej profetëve, duke u shndërruar në gërmalla të frikshme të fatkeqësisë së amshuar."

Një udhëtim i mrekullueshëm në historinë e profetëve prej krijimit të Ademit (a.s.), e deri te Muhamedi (a.s.), nën dritën e Kur'anit Famëlartë. Shejkh Osman Nuri Topbash, me një gjuhë të ëmbël dhe plot urtësi na e afron shikimin në kohë të largëta. Kështu falë stilit të ngrohtë, lexuesi bëhet dëshmitar i skenës ku ndodhin ngjarje të rëndësishme dhe veprojne njerëz të veçantë,

të cilët Zoti i Lartmadhëruar, përkujton me dashuri si njerëzit e Tij të zgjedhur. Ngjarjet na tregojnë se pse Zoti sjell profetë dhe u jep atyre dije dhe mrekulli (siç shprehet në libër autori: Zoti është "Shkaku i shkaqeve" ose "Shkaku i parë". *Kur Ai dëshiron, Ai e vë në zbatim urdhrin e Tij (vendimin e Tij) edhe jashtë ligjeve natyrore në fuqi.* I bën profetët lajmëtarë dhe paralajmëruet të njerëzimit që shmangjet prej udhëzimit e shkon mbas dëshirave të veta, duke harruar lumturinë e vërtetë, Mbrojtësin dhe Krijuesin dhe duke humbur kështu në errësirat e injorancës dhe fatkeqësisë.

Duke dëshmuar "La ilahe il'lallah" (Jo, nuk ka zot, përveç Zotit), profetët u kujtojnë njerëzve pikërisht Njeshmërinë e Zotit dhe njëkohësisht rrafshojnë çdo sajim që i vihet përkrah Krijuesit të Vetëm e të Pashoq. Favori që u bën Zoti Profetëve duke u dhënë shpallje është njëkohësisht edhe sprovë për njerëzit që dëgjojnë thirrësin në të mirë dhe drejtësi. Të bindurit dhe ata që mendojnë gjithnjë shpëtohen, kurse arrogantët shkatërrohen. Zoti në Kuran tregon dhe gëzon besimtarët se Ai është afër dhe me anë të profetëve, orienton dhe drejton botët. Në librin *Vargu i Profetëve*, hirësia e tij, Osman Nuri Topbash, bën rrefimtarin dhe interpretuesin e figurave të profetëve që përmenden në Kuranin Famëlartë. Duke ia rikujtuar njeriut përgjegjësinë e të qenit përfaqësues i vullnetit Hyjnor në Tokë, i tregohet grada të Krijuesi dhe fakti se për Të nuk ka gjë më të rëndësishme në krijimin e Tij, se sa njeriu. Ai ka premtuar se nuk do ta lërë në humbje krijesën e Vet. Nëpërmjet profetëve Ai sjell udhëzimin. Nëse njeriu do të shfaqë devocion dhe durim, për hir të Zotit, në këtë botë të varfër, do të shpërblehet me thesaret e fshehta të Zotit, e nëse zhytet në vorbullën e harresës, do të humbë dhe do të ndëshkohet, në të dyja botët.

Libri është plot rrëfime dhe histori të bazuara në ajete kuranore dhe hadithe të Profetit Muhamed (Paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të), si i Parëkrijuar, por i zbritur i fundit në vargun e profetëve, duke qenë edhe Vula e Profetësisë, profeti të cilit iu besua shpallja fisnike Kurani, i zbritur nga Zoti si dhunti për njerëzimin, prej engjëllit besnik, Xhebrail (a.s.), të Dashuri i Zotit. Ruajtja e dijes dhe kujtesa e Njeshmërisë së Zotit ka kaluar në rrugë të vështira. Ndaj dhe libri me një gjuhë të thjeshtë fokusohet në dritën që Zoti ua jep të urtëve, që shërbejnë si interpretues të Fjalëve të Tij, në mënyrë që njeriu të bëhet falënderues dhe përkujtues, duke kryer kështu amanetin e marrë në paktin e Elestit, ku njeriu e mori përsipër detyrën që e refuzuan të gjitha krjesat e tjera, ta njohë dhe ta përkujtojë Zotin, si të Vetmin Krijues. Në libër del qartë se profetët kanë pasur barrë të rëndë, pasi janë dërguar si shembuj të pastër në shoqëri të degraduara, ku morali i pastër u dukej si diçka e huaj dhe shpesh çmenduri. Por Zoti i forcoi zemrat

e profetëve dhe i nxori ata fitimtarë (duke i ndihmuar me mrekulli dhe engjëj). Emrat e tyre mbahen në gojë nga miliona besimtarë për shkak të përkujtimit që Zoti i bën të Zgjedhurve të Tij në Kuran. Siç shprehet shejkh Osmani: "Ai, Krijuesi i Lartë, kë të dojë e bën të ecë mbi ujë, të ftuturojë pa krahë në ajër! Anullon shikimin e syrit dhe zemrën e bën si sy dhe i jep mundësinë për të parë gjëra që syri nuk i sheh."

Kur udhëton nëpër historinë e Vargut të Profetëve, mendimi të ndalet në shoqëritë ku jetojmë dhe shumë nga situatat që tregohen në libër janë sot të dukshme, pa iu futur hetimit të hollësishëm. Idhujtaria në ditët e sotme është e ndryshme prej atyre kohëve të dikurshme, por rezultati që ajo sjell është i njëjtë, humbje e sigurtë, çoroditje, ankth, anarki dhe pasiguri. Prandaj, Kurani është libri që i sqaron të gjitha çështjet në të gjitha kohët, e shembulli i profetëve është i qartë për ata që reflektojnë. Kur u flasin popujve të tyre në fakt ata po na flasin edhe neve. Zoti ka premtuar se zëri i Profetësisë do të shtrihet në të gjitha kohët. Ademi (a.s.), e ndërtoi Shtëpinë e Zotit në Mekë, aty u kthye Ibrahim (a.s.), për ta rindërtuar Shtëpinë e Besëlidhjes, e po aty u dërgua Profeti Muhamed, si Vula e Vargut të Profetësisë (Paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të), me Kuranin si Nur dhe udhëzim për brezat e ardhshëm. Jehona e këtyre zërave të mrekullueshëm na vjen prej Kuranit dhe të gjithë librave që shkruhen nën dritën e tij, siç është ky libër i dashur që po jua rekomandojmë.

Përveç historive të profetëve, shejkh Osmani flet në disa kapituj edhe për cilësitë morale akohore që në islam janë shtysa të forta në afrimin me Zotin, si: pendesa, zbutja e zemrës me përkujtimin e Allahut, durimi, dorëzimi e nënshtrimi ndaj Tij, që në fakt janë fjalë që përmenden shpesh në Kuran. Por, po ashtu në disa kapituj flitet edhe për cilësitë negative që vijnë prej egos, si: lakmia, epshi, smira dhe mizoria, cilësi që e largojnë njeriun nga Zoti dhe e ulin atë në një gradë me kafshët, biles edhe më poshtë.

Megjithatë, rruga drejt pastrimit është e hapur dhe Zoti i fton njerëzit të shpëtojnë shpirtat duke u pastruar nga e keqja, siç shprehet edhe ajeti: "**Pasha Diellin dhe shkëlqimin e tij! Pasha Hënë të që e përcjell atë! Pasha ditën që ia zbulon shkëlqimin atij (diellit) dhe për natën kur e mbulon atë! Pasha qiellin dhe për Atë që e ka ndërtuar! Pasha Tokën dhe për Atë që e ka shtruar! Pasha shpirtin dhe për Atë që e ka përsosur, duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën! Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë.**" (esh Shems, 1-10)

Përgatiti: A. Brahusa



Lutbe të zgjedhura

Ferid Piku

Besimi në Zot

BURIM SHPRESE

Zoti ynë në Kuranin famëlargët thotë: **“Mos u ligështoni dhe mos u pikëlloni, sepse ju, gjithsesi jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë.”** (Al’Imran, 139)

Shpresa është ajo, që shtyn bujkun të lodhet gjatë gjithë vitit, sepse pret që të korrë mundin dhe përplekjet e tij.

Shpresa është ajo, që shtyn tregtarin të bëjë udhëtime të largëta, që disa herë ngjajnë si aventura, pasi ai pret të fitojë nga tregtia e tij.

Shpresa është ajo, që e shtyn të sëmurin që të provojë ilaç pas ilaçi, idhtësi pas idhtësie, sepse shpreson se do të shërohet.

Shpresa është ajo forcë, që e hap kraharorin, pas shtërngimit. Shpresa është ajo dritë, që ta largon errësirën dhe frikën.

Sikur të mos ishte shpresa, sot nuk do të kishte zbulime të cilat kanë lehtësuar jetën e njeriut. Para se të bëhet një zbulim, ka dështime të shumta dhe sikur të mos ishte shpresa, nuk do të kishte arritje, sepse nuk ka arritje pa dështime. Po të mos ishte shpresa, nuk do të kishte shërim, sepse nuk ka sëmundje pa dhimbje. Po të mos ekzistonte shpresa, nuk do të kishte jetë me plot kuptimin e kësaj fjale, sepse nuk ka jetë pa vështirësi.

Prejkujt vjen vallë kjo shpresë, ky sekret që e mban njeriun gjallë në jetë, ky sekret që e bën njeriun gjithmonë të shikojë tek e ardhmja? Nga vjen shpresa dhe

kush janë njerëzit më me shpresë?

Shpresa vjen prej Zotit, prej burimit të vetëm të shpresës dhe njerëzit më me shpresë janë besimtarët e Allahut (xh.sh.), ata që besojnë tek i Plotfuqishmi, tek shpresa e të gjitha shpresave. Ndërsa për njerëzit, profetët e Zotit janë modelet që kurrë nuk e humbën shpresën, sepse ata u mbështetën plotësisht vetëm te Allahu (xh.sh.).

Zekerija (a.s.), ishte në një moshë shumë të thyer, kur sipas logjikës njeriu nuk mund të lindë fëmijë. Mirëpo ai iu lut Allahut (xh.sh) me këto fjalë: “O Zot! Mos më lër të vetëm, mos më lër pa trashëgimtar. Ti je Mëshiruesi i mëshiruesve”. Zekerija (a.s) e bënte këtë lutje, sepse besonte në fuqinë e Zotit dhe kishte shpresë të madhe tek Allahu (xh.sh.).

Junusi (a.s.) në barkun e balenës u lut me këto fjalë: **“La ilahe il la ente subhaneke, inni kuntu minedh-dhalimin** (I Lartësuar qofsh Ti o Zot, unë i bëra padrejtësi vetes sime)” (Enbija,

87), sepse kishte shpresë, se zëri i tij do të dëgjohej. Atë e dëgjoi Allahu (xh.sh) dhe ia pranoi lutjen.

Jakubi (a.s.) humbi djalin më të dashur për zemrën e tij, Jusufin (a.s.) dhe pak më vonë humbi edhe Beniaminin. Në këto momente kur njerëzit e këpusin shpresën, ai u tha fëmijëve të tjerë: **“O bijtë e mi, shkoni e kërkoni lajme për Jusufin dhe vëllain e tij dhe mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut. Shpresën në mëshirën e Allahut nuk e humb**

“Unë jam ashtu siç mendon robi për Mua. Nëse robi mendon mirë për Mua, do ta shohë mëshirën dhe faljen Time, që është shumë afër tij. Nëse robi mendon keq për Mua, ashtu do të sillem edhe Unë me atë njeri.”

askush, përveç jobesimtarëve". (Jusuf, 87)

Jakubi (a.s.) e dinte se pas vështirësisë vjen lehtësimi.

Modeli më i mirë për ne është njeriu më optimist, njeriu më me shpresë e ai është profeti **Muhamed (a.s.)**. Në sytë e tij ndriçonte shpresa dhe optimizmi. Në momentet më të vështira ai u jepte kurajo shokëve të tij. Ai (a.s.) vazhdon të ngjallë shpresë edhe në zemrat tona pas 1400 vjetësh. Kjo ndodhte, sepse ai kishte besim të madh tek Allahu (xh.sh.).

Kur dëgjonte se dikush kishte një emër që frymëzonte pesimizëm, ia ndërronte emrin menjëherë dhe i vinte një emër optimist.

Kur shkante për vizitë tek i sëmuri, i thoshte: *"Inshallah nuk ke gjë. Do të pastrohesh nga gjynahet e tua, do të bëhesh më mirë."* (Buhariu)

Kur nisej për një rrugë, merrte rrugën më të lehtë dhe nuk kishte frikë se ka rrugë ters apo ditë ters, por i mbështetej Allahut (xh.sh.) dhe gjithmonë shikonte me optimizëm.

Kur mbi shokët e tij ushtroheshin tortura, që nuk i imagjinon mendja, ai u jepte kurajo e shpresë dhe u thoshte: *"O vëllezër do të ndryshojë situata, do të ndryshojë jeta, do të triumfojë kjo fe e do të udhëtojë bariu nga Sana' aja në Hadramout dhe nuk do të ketë frikë askënd tjetër, përveç Allahut (xh.sh.) dhe ujkut se mos i ha delet e tij."* (Buhariu)

Profeti (a.s.) nuk e mallkoi popullin e Taifit, i cili e keqtrajtoi në formën më të keqe, por kishte shpresë se nga këta njerëz do të dalin besimtarë, që do të besojnë Zotin dhe nuk do t' i venë shok Atij.

Profeti (a.s.) në momentet më të vështira, kur po ikte nga Meka në Medine i tha Surakës, i cili po ndiqte për ta vararë: *"O Suraka! Kthehu se të premtoj byzyllykët e Kisras."* (Buhariu dhe Ahmedi)

Profeti (a.s.) besonte, se Zoti do t'ia merrte pasurinë Kisras e do t'ia jepte myslimanëve dhe ashtu ndodhi.

Në betejën e Hendekut kur shokët e tij ishin të frikësuar e të lodhur, saqë nuk kishin më fuqi të thyenin gurët, ai megjithëse ishte më i lodhur se ata, me çekiçin që godiste fort, nën dritën e shkëndijave thoshte: *"Allahu ekber, do të çlirohet Persia, do të çlirohet Bizanti."* (Ahmedi dhe Nesaiu) E gjitha kjo vinte nga besimi dhe shpresa, që ai kishte tek Allahu (xh.sh.). Të gjitha fjalët e tij u bënë realitet sa ishte gjallë dhe pasi ndërroi jetë.

Një besimtari që beson në Zot, nuk i ka hije të jetë pesimist, ta shikojë botën të zezë.



A e dini se kur ndizen qirinjtë? Ata ndizen kur nuk ka drita, sepse kur vijnë dritat nuk ka nevojë për dritën e qiriut.

Kur flitet për shpresën? Flitet kur ka pesimizëm, kur janë këputur shpresat për të ardhmen dhe fatkeqësisht gjendja dhe realiteti i myslimanëve sot në botë të fton në pesimizëm si brenda dhe jashtë Shqipërisë. Shpeshherë ndihemi të pafuqishëm, nuk kemi gjë në dorë, nuk dimë çfarë të bëjmë për ta ndryshuar gjendjen dhe ky është realiteti sot. Por besimi në Zot na fton në optimizëm. Varet vetëm se kujt i japim rëndësi, besimit në Zot apo aktualitetit.

Ne jemi myslimanë dhe si të tillë duhet të kemi shumë shpresë dhe besim te Allahu. Me lejen e Zotit, sado që të rritet e keqja, e mira kurrë nuk do të vdesë, sepse Profeti (a.s.) ka thënë: *"E mira është tek unë dhe tek umeti im sa të jetë kjo jetë deri në ditën e Kijametit"*.

Profeti (a.s.) na mësoi, se kush mendon mirë për Zotin, Zoti do të jetë i mirë me të dhe kush mendon keq për Zotin, ashtu ka për ta përjetuar besimin e tij. Në hadithin kudsî Zoti thotë: *"Unë jam ashtu siç mendon robi për Mua. Nëse robi mendon mirë për Mua, do ta shohë mëshirën dhe faljen Time, që është shumë afër tij. Nëse robi mendon keq për Mua, ashtu do të sillem edhe Unë me atë njeri."* (Buhariu, Muslimi dhe Ibn Hibani)

Ne besojmë shumë tek falja e Zotit. Besojmë se, Ai ka fuqi që t' i falë gjynahet tona dhe nuk pyet askënd për këtë.



Ne besojmë se Zoti fali atë që vrau 99 vetë. Profeti (a.s.) e tregoi këtë shembull, në mënyrë që të mos i këpusin shpresat të gjithë ata njerëz, që e kanë mbushur veten e tyre me gjynahe.

Ne besojmë se edhe vdekja do të vijë me shpresë dhe inshallah do të ringjallemi duke shpresuar tek Mëshira dhe Falja e Allahut (xh.sh.).

E lus Zotin e gjithësisë t'i mbushë zemrat tona me besim dhe shpresë. Na bëftë Zoti njerëz optimistë, njerëz që kur flasin me të tjerët përhapin optimizëm, sepse flasin për Atë që mjafton t'i thotë diçkaje: "Bëhu" dhe ajo bëhet.

Ne besojmë në një Zot, i Cili e shtrin dorën e tij ditën që të pendohen gjynahqarët e natës dhe natën që të pendohen gjynahqarët e ditës. Ne besojmë te ai Zot, që e shpërblen të mirën 1 me 10 dhe të keqen e dënon vetëm aq sa është.

Ne besojmë te ai Zot, që e zgjidh hallin e robit, që e di se çfarë do të thotë njeri dhe çfarë mban ai në zemrën e tij edhe nëse nuk flet.

Ne besojmë te një Zot, që është i Plotfuqishëm dhe shëron edhe sëmundjen, para së cilës dorëzohen të gjithë mjekët e botës.

Ne besojmë te një Zot, i Cili u ka premtuar fitoren besimtarëve. Besojmë tek ai Zot, që thotë: **"Ata duan ta shuajnë dritën e Allahut me gojën e tyre, po Allahu e plotëson (e përhap) dritën e Tij, edhe pse e urrejnë jobesimtarët"**. (Saff, 8)

Ne besojmë tek ai Zot, i Cili ka krijuar xhenetin në

formën më të bukur, e ka përgatitur këtë xhenet dhe aty do të hyjnë njerëz, që kanë besim të madh tek Zoti dhe inshallah jemi edhe ne prej atyre njerëzve, që shpresojnë tek mëshira e Zotit dhe tek xhenetet e Tij.

Por nga ana tjetër të shpresosh nuk do të thotë të shikosh ëndrra me sy hapur e ta marrësh këtë jetë me të lehtë. Unë nuk flas për atë shpresë, që është si gjilpëra, që lehtëson dhimbjet e sëmundja prapë vazhdon. Nuk është kjo shpresa për të cilën po flasim. Kësaj i thonë t'i ikësh realitetit, të bëhesh dembel e të mos e ndryshosh jetën.

Shpresa është forcë e madhe, është durim dhe besim tek Zoti. Është mbështetje tek forcat e tua të pakta dhe besim tek forca e pashtershme e Allahut (xh.sh.).

Shpresë do të thotë të derdhësh mundin tënd të vogël e ta shikosh se Zoti bën mrekulli me fuqinë e Tij të pakufishme.

Shpresa pra, është të punosh e të derdhësh djersën e në fund të shpresosh shumë tek Zoti i gjithësisë. Zoti e thotë diçka të tillë në Kuranin famëlartë në suren Kehf: **"Kush shpreson takimin me Zotin, le të bëjë vepra të mira e në adhurimin ndaj Zotit të mos i shoqërojë Atij asgjë"**. (Kehf, 110)

Le të bëjmë atë që kemi mundësi dhe do ta shohim se ndihma e Zotit është shumë afër.

Fatkeqësisht ne shpresojmë tek punët e mëdha, kurse punët e vogla i bëjnë vetëm pak njerëz, por dijeni se xheneti fitohet edhe me punë të vogla. Gjithashtu edhe xhehenemi fitohet me gjynahe të vogla.

E lus Zotin të na udhëzojë tek puna dhe tek besimi në madhësinë e Tij.

Zoti na i mbushtë zemrat me besim, na bëftë nga ata që jetën e jetojnë me optimizëm, shpirtin e japin me optimizëm dhe ringjallen me shpresën tek Falja e Zotit.

Na bëftë Zoti nga ata njerëz, që e largojnë sadopak pesimizmin nga zemrat e të tjerëve, njerëz që kur na shikojnë të tjerët, u shtohet besimi dhe shpresa tek Allahu (xh.sh.). Zoti na bëftë nga ata njerëz, që kur flasin, flasin për mëshirën e Zotit dhe kur punojnë, bëhen modele të gjalla për besimtarët e tjerë. Zoti na mundësoftë, që ta jetojmë jetën si myslimanë, ta japim shpirtin si besimtarë, dhe të na ringjallë në shoqërinë e profetit Muhamed (a.s.).

Amin!

Babai i Vesës është i trishtuar. U bënë disa ditë që nuk e zë gjumi. Edhe nëse fle, bën gjumë shumë të çrregullt. Zgjohet shpesh... Vetën e ndjen të pafuqishëm. Përgjatë gjithë jetës, është hera e parë që ai nuk mund të bëjë asgjë për vajzën e tij. Do të donte të bënte shumëçka për të, por nuk mundet.

Vesa është sëmurë. U bënë dy vjet që kurohet. Diagnoza e saj është kanceri i gjirit. Para gjashtë muajsh, qelizat e kancerit i ishin përhapur drejt mushkërisë së bardhë. Doktorët nuk japin shpresë, por nuk shprehen as pesimistë. Faktikisht, mjekët në përgjithësi kështu flasin. Ata ngurojnë të japin përgjigje të prera. Ndoshta këtë e bëjnë për të mbrojtur veten e tyre. Ata nuk japin garanci, sepse nëse ndodh e kundërta, kanë frikë se humbin besimin e pacientit.

Para dy muajsh pati probleme në mjekimin e Vesës. Gjendja e Vesës përkeqësohet. Babai i saj lutej akoma. Vesa shtrohet në spital, por ndërrohet jetë.

Lutjet e babait të Vesës, si duket nuk ishin pranuar. Krijuesi e di më mirë arsyen e kësaj ndodhie...

Vallë, kanë shkuar dëm lutjet që ai kishte bërë? Ku përfunduan ato?

Këto janë pyetje që shqetësojnë mendjen e shumë njerëzve, që nuk u pranohen lutjet ashtu siç ata kërkojnë. Shkaku i lindjes së këtyre pyetjeve lidhet me pritshmërinë tonë të ngutshme ndaj një rezultati të caktuar. Mirëpo tani me të drejtë shtrohet pyetja: mos lutja është një marrëdhënie interesi me Krijuesin?

Ndërsa babai i Vesës nuk ankohet për gjendjen...

Me ditë, me javë dhe me muaj të tërë ishte lutur e përgjyruar për shërimin e vajzës së tij. Ai dëshironte shumë që ajo të shërohej, kështu që i ishte drejtuar plotësisht vetëm Krijuesit. Sëmundja e rëndë e kishte dobësuar shumë vajzën dhe ai e kishte kuptuar se Krijuesi ishte pika e vetme ku mund të mbështetej. Sa herë që lutej, ndjente një qetësi shpirtërore të thellë, sepse përgjatë duarëve babai i Vesës ia kishte shprehur dhe parashtruar gjendjen e tij, Zgjidhësit. Ai kishte kuptuar kufijtë e realitetit të tij. Kur lutej, ai i përgjyruar Zotit: *"Ne nuk kemi mundësi të bëjmë çdo gjë. Ti je Krijuesi i çdo gjëje. Sëmundja dhe shërimi vjen nga Ti. Vajza ime është krijesa Jote e brishtë, Ti e do atë më shumë se sa unë. Ajo është amaneti që Ti ma besove mua, por unë e di se Ti je Amanetqari më i Madh. Tuajt jemi dhe te Ti do të kthehemi."*

Babai i Vesës besonte thellë në fjalët e duarëve të tij. Kjo ishte qartësia që fitoi ai nga lutjet që kishte bërë. Dorëzimi i vetes ndaj Allahut, përkujtimi dhe lavdërimi i Krijuesit, ishte fitimi i tij më i madh. Përgjatë lutjeve, kishte arritur një lidhje të fortë me Zotin. Lutja ishte bërë një stacion i veçantë mes tij dhe Krijuesit. Vakti i lutjes ishte kthyer në një kohë që ia kushtonte vetëm Atij, shpëruar nga kjo botë, mendonte vetëm për Të dhe ndihej më afër Tij.

Kur lutej, nuk kërkonte patjetër që Krijuesi t'ia shëronte vajzën. Ai e dinte se Krijuesi nuk ishte vetëm Shëruesi, por në të njëjtën kohë ishte edhe el-Hakim-i, domethënë, i Urti. Për këtë arsye, nuk e përjashtonte mundësinë e përkeqësimit të shëndetit të vajzës apo vdekjen e saj, e kishte pranuar këtë gjendje dhe duronte. Lutjen e shihte si një mënyrë lidhjeje me Krijuesin, si një mënyrë jetese dhe si një mundësi për të shfaqur gjendjen, prandaj as nuk i shkonte në mend ideja se lutja nuk i ishte pranuar.

Lutja është të shprehurit e vetes ndaj Krijuesit. Kur njeriu shpreh veten e tij, nga ana tjetër dëshmon vetë Krijuesin. Përfitimi nga lutja është vetë gjendja e lutjes...

Motivi i ekzistencës së njeriut

Dr. Mustafa Ulluso



MARTESA ÂSHT MÂ I VËRTETI SIGURIM NË BOTË

Perendija urdhnon e thot në një ajete:

(Venkihu'l-ejema minkum...)

Don me thanë: (Martonju, se me anën e martesës del një shoqni që ju shpeton nga vorfnija).

Kështu urdhnon dhe i madhi i jonë Pejgamberi me një hadithë:

(Martonju, shumonju që me një mend une të lavdrohëm ndaj ym-metet tjerë me jue).

Prap dhe me një hadithë tjetër:

(Mâ i keqi nder jue është beqari).

Të martuemit rrojnë mâ tepër se beqarët, dhe në saje të martesës shpetojn nga çmendja, vogabandazhi edhe nga e shkrryemja nderper burgje.

Një djallë i qytetnuem e i shekullit është ay që martohet. Martesa është faktorja mâ e gjallë që forcon vertytet e të rivet. Shkaku kryesues që sot të rrijët i largohen nga perbamja e rrethit familjar, është friga që ka kapërthye se nuk do mund të sigurojnë lumteriën ekonomike të familjes. Gruja e foshnjat janë detyra të ngarkueme në krahë të mashkullit. E dhanmja e jetës për tjetër kend, është një shtytje e madhe me mësuë mashkujt nder sakrifice.

Mbas hetimeve të bâme e statistikave që janë mbajtur deri më sot në Europë e në Amerikë, shumica e fajtorve që mbushin burgjet dhe të çmendunve që xânë çmendinat, perbâhen prej beqarve, e prandëj martesa është mjet më i sigurtë që shpeton të rrijtë mos me u shkrrye nder ksi institutesh e, në anë tjetër u siguron përfitime mâ të vlefshme se beqarja, një nga të cilat është shpetimi mos me u rropatë ndëper gjykatore e burgje; e dyta mos me u bâ për çmendinë, dh'e treta se të martuemit ruhen shumë mâ tepër nga abuzimi në shkrim t'epshëve se sa beqarët, dhe në ket mënyrë një djallë i martuem me ndermjetsi të familjes, mundet me sigurie vet-vehten dhe nga vdekja e pa kohë.

Disa thonë se martesa ka marrë udhën e falimentos, edhe se ndarja (talaku-divorci) është duke u shtue dita ditës. Për ket ide të gabueshme që është formue ndër disa u thomi se statistikave e mbajtura në popujt e qytetnuem tregojnë se nder vënde të tyne edhe pse ndarjet janë shpeshtue, martesa është gjithnjë në shtim, dhe po të llogariten në perqinde frymët, sigurisht të martuemit perbâjnë shumicën. Mbas pretezave të disa dijetarve shkolla dhe konkurrenca ekonomike sigurojnë shumzimin e martesave.

Djalëria që nëpër mjet të shkollës është pasunue me vertyte të shndoshta, për me muejtë me vijue një jetë të sigurtë, tregon nevojë për një fole, dhe familjen është dukë njëjftë si një vënd mbështetjeje shumë të ndershëm e të

shënjtë. Posë ktyne, shpenzimet e rânda me prishje të kota të beqaris, djalerien e shtyen me i a hye kurdisjes së familjes, e cila i siguron jeten me mënyra me të lira e të pastra.

Me marrjen pjesë të dy gjallnivet është themelue shoqnja e martesës. Lufta e jetës në krye të vet prej individvet don me thanë me hecë me një kambë në jetë, e familja pra siguron që lumtëria e ksajë jetë, t'arrihet me dy kambë e dy duer. Gruëja me dashtë të punoj në shpie ose perjashta, është një forcë që plotson jeten e mashkullit dhe që përgatitë ktij posibilitetet morale e materjale të veprimt.

Një jetë e qetsueshme në një shpië e sofer të paster, i ep forcë e gjallnim të posaçëm mashkullit me rrokë punen si duhet. Për një njeri në gjendjen natyrale, martesa është një gjâ krejt e natyrshme. Një burrë që martohet vënd në sigurimin mâ të vlefshëm tregtinë, pozitën shoqnore dhe shndetin e vet.

Mbas statistikave të mbajtura shkaqet që mâ tepër shtytjnë të rrijtë me vuetjë ndëper burgje janë: borxhi, shamata, rrahja dhe e fyemja; së dytit, vjedhja; së tredit, therja se së katërtit vrasja e cubnija. Sidomos shumica e krimeve bahen me gjaknxehtësië. Faktorët që çojnë në ket gradë të burgosurit mâ tepër mbështeten ndër shkaqe shoqnore e ekonomike. Mire po në tjetër anë statistikave e mbajtura në Amerikë vërtetojnë se vrasjetë presjet me gjaknxehtësië xanë një vend shumë të pakët. Do t'ishte një fushatë mjaft e vyeshme për specialistat psikologë me ba studime ndër neve, ku gjaknxehtësija zhvillohet mâ tepër. Nga statistikave e sipërthanuna kuptohet sidomos se beqarët 27 vjeç e teposhtë janë ata që bâjnë mâ tepër krimet, dhe se beqarja është udhëheqsja mâ e fortë që bahet faktor i gjallë me shtye të rrijtë ndër krime e fajë plot immoralitete.

Pse martesa pengon krimet? Gjegjen e ksaj është nevoja më kerkue vetëm duke pasë dije se çka i u ka ra mbi krye beqarve e të rrijvet, në prirjen e tyne kah shitja e burris dhe nga relacjonet e pakta sociale që kanë.

Një njeri beqar është një njeri që jeton për vehte apo një individue që lufton sall për vehte. Relacionet morale e sociale i ka shumë ma të pakta ndaj ata të martuemvet, se gratë e fëmija e një njeriut të martuem, janë një kapital përgjegjisje morale e socjale për të, sepse është i detyruem me fitue jetesen për grue e fëmijë e jo sallde për vehte. Kta relacione praj janë një mjet për të martuemin me pasë nën kontroll të kurdohershëm sjelljet e tija dhe me u bâ sundues' i vetvehtes. Njeriu i martuem respekton shumë mâ tepër zakonet e shoqniës, e pra ay njeri që edukon vertytet me nevoja të tilla sociale, mundet me rregullue vetvehten mos me dalë

jashta ligjve morale e sociale.

Diferenca e marrziës me nervozitet e melankolië është një diferencë gradet. Kta gradë duke marrë shtimin kah tatpjeta, në piken qi qindrojnë, mâ të shumten çfaqet marrzija. Njerziti qi janë kondend në jetesë shum rrallë mund të bahen nervoz e melankolikë per shkaqe tjera të vogla. Edhe statistikat e mbajtuna ndër çëmëndina, vertetojnë se shumicen e të çëmëndunëve e perbajnë beqarët. Gjithashtu pleqët qi mbahen për sevapë nder streha vofone ma e shumta nuk janë të martuem, por beqarë e pa qenë bâ ndo'i herë zot familjet e tue mos pasë vend se ku m'e kalue vërsen e pleqniës, bahen nevojtare me kërkue strehë ndër ksi institutesh, e prej se nuk zotnojnë rrethin familjarë e fëmiët qi me i këqyrë, i u mungon sigurimi me përballue voefniën e shkryemjen në ditët mâ të mbrame të jetës së tyne.

Dobit e martesës në shndede, janë fare të randësishme, e për kta flasin e vertetojnë gjithnji statistikat e studimet e bâme prej shkencëtarve të botës. Vdekja mbandej tregon një diferencë të konsiderueshme në mes të beqarëve e të martuemvet, dhe është për t'u vretjtë me çudië se vdekja është e tepërme në beqarë shtatdhet vjeç e poshtë.

Ka një diferencë fort të madhe vdekja në mes të moshave tridhet e pesdhet vjeçare të nartuem e beqarë, se në perjudhen e këtyne njizet vjetëve, beqarët vdesin mâ tepër se të martuemit, dhe prej kësaj rrjedhë se beqarët nuk kalojnë ndepër një jetë të paster e të rregullshme dhe nuk ruejn shndeden e tyne si e lypë nevoja.

Martesa në moshë të ré mâ tepër se nder mashkuj mjeshtrisht ngjanë në me të femnavet. Shkaqet e martesës së vajzavet në moshë të ré, mâ tepër se prej yrfit e zakonevet, rrjedhë se femnat plaken shpejt e se nuk dijnë e s'kanë për detyr me fitue jetesën e tyne.

Tue qenë detyra e mashkullit me i pregaditë e me i prue shuejtjen çerdhes, martesa në moshë të ré për mashkullin është një gjâ e pamundun, në vend qi një vajzës po sa t'i ndodhin kërkesa (tek neve t'i vejnë shkuesi) është gadi m'u martuem, makari me një plak ose me ndonji tuberkuloz e suphyllitik, dhe kështu të shumten e herës vajzat 15-20 vjeçare bijnë viktim i jetesës plot vuejtje e mjerime qi për rezultat doemos kanë dizarmoninë familjare dhe shoqnisë njerzore do t'i dhurojnë kreatyrë të bastardhueshme e me mungesa fizike. Në një të tillë gjendje pjesa femnore ka një herë shterngohet natyrisht me i u shtruve vullndesës së jashta ligjëshme e të pa dishrueshme, sepse i mungon kryekput mjetei mâ i nevojshëm me kënaqë shpirtin e sajë reciprocikisht.

Për këtë qëllim pra sot në boten e qytetnueme janë bâ ligjë të veçanta, në bazë të cilave sa një martesë nuk mund të bâhet pa qenë marrë mâ parë konsantiment' i plotë i vajzës për shokun e jetës qi do të marin, e pa qenë paraqitë në zyrën kompetente certifikata e mjekut përgjegjës mbi shëndetin e të dy palëve. Me shum mburje çfaqim në ket rasë se Sheriat' i Madhnueshëm të gjitha kta ligjë e rregullore qi në shekullin XX bota po mendon me i vûe në veprim si nevoja të domosdoshme, i ka parapa, e dispozitat e tij na kanë detyrue me veprue në mënyrën e dishrueshme në kohë të sodit qyshë 1300 e sa vjet mâ parë.

Për shembell qi dispozitat e Sheriatit shjhtë janë aplikue prej themeluesit të tij çë n'at kohë për sa i përket martesës, tregojmë se vetë i Madh' i ynë H. Hadixhen e ka marrë me marraveshtje të drejt për drejtshme e me konsantimentin e plotë të sajë. Në këtë mënyrë kanë veprue edhe H. Aliu

e Sahabet tjerë.

Martesa ndalon mashkullin prej përdorjes s'alkoholit dhe prej dameve qi bjen me vehte kjo perdorje. Pija per një burrë të rië është mâ i lehti mjet për me kalue kohen në vend qi një mashkull i martuem nuk ka nevojë per një të tillë mjet, se jeta shoqnore, në të cilen marrin pjesë grueja e çiliminjët e tij, mjafton me i sigurue kalim kohen.

Mâ e madhja dorzânjë qi u bâhet të rijvet me anë të martesës në fushatën e shndetsiës, është sigurim' i shpëtimit kundrejt smundjeve venerjane, edhe ky shpëtim nuk është vetëm per mashkullin qi martohet, por është një mjet luntërije me shum randië edhe per gjenaracionin qi do të përtrijnë, dhe për shoqniën.

Dy relacjone me randsië janë qi permbajnë martesën: Dashtunija e paraja. Dashtunija në mes të burrit e grues; pa mos qenë paraja qi siguron jeten ekonomike, vashdim' i familjes bâhet i vështirë, e prandaj mâ të nevojshmet mbështetje të familjes janë dashtnija e paraja. Në një familje po të punojnë bashkarisht burri e grueja dhe po të mbretnojnë dashunija në mes të tyne, kurrnji rrezik nuk eksiston qi të trondisi at familje. Ndarja (devorci) ndër qytete bâhet mâ tepër se në katunde, e prej ksaj merret vesht se nuk mjaftohet me u sigurue lumtërija e familjes vetëm me mundin e mashkullit.

Sasija e grave të veja është mâ e tepërme se e meshkujve të vejë edhe kjo rrjedhë se mashkujt e vejë kuer martohen së dytit a së tretit, gjithmonë kqyrin me zgjedhë me vajza të reja, dhe me këtë shkak, tue u dalë fati me preferencë vajzave të reja, për gratë e veja martesa bâhet evshtirëshme.

Martesa mbandej lot rrolin mâ të madh në shtimin e popullsiës së vendit t'onë, ku mund të banojnë edhe kater herë kaq banorë sa jemi sot. Randsija qi ç'kah ditë i është dhanë veprimi e masave per shtimin e popullsiës per lumterinë e popujve, i ka dhanë shkas me i dhanë randsi shum mâ tepër familjes. Themel' i lumtërisë është vetëm e vetëm pra me mprojtë frymët e familjes; me sigurue gjendjen e mirë të tyne dhe me u mundue me ngjallë organizata shndetsore të nevojshme në vend t'onë për fëmi. Duhet dijtë mandej se frymët e teperme kurrnji herë nuk realizojnë shtimin e popullsiës, po s'u siguroen plotësisht lumtërija e shndedja e familjes.

Shkurt, martesa është mâ i sigurti institut qi të rijvet u siguron jetesen, shndeden dhe moralin.

Nuk mund të rriëm pa permendë në ket ratë se bota e qytetnueme tue i pasë dhanë randsinë e meritueshme martesës per arsyenat e çfaquna në këta radhë e per sa e sa tjera qi janë botuem në libra të veçantë, sot me ligjë të posaçme merr një takës bukur të mirë prej beqarit.

Pra me plot arsye rië-permendim se ardhë dita qi gjith ndalimet, premtimet e urdhnimet e Sher-i sherifit po vertetohen me punë e me fakte se janë qenë e kanë me qenë per të miren e të mbramen e njerziës.

Marrë nga revista "Zani i Nalte", nr: 9, fq. 259. Prillë 1927

KONSTATIMI DHE SHËRIMI I SHËNDETSHËM I ANEMISË

Anemia krijohet si rezultat i numrit të pamjaftueshëm të rruazave të kuqe të gjakut. Për këtë arsye, gjaku bartet me vështirësi deri te organet dhe indet në trup. Shkaqet më të shpeshta të anemisë janë sëmundjet e organeve të tjera, humbja e madhe e gjakut, ushqimi joadekuat i varfër me hekur dhe prodhimi shumë i vogël i eritrociteve. Supozohet që çdo e dhjeta femër në një moment të jetës së vet sëmurët nga anemia, ndërsa ajo prek edhe meshkujt dhe fëmijët, thonë ekspertët.

Simptomat e anemisë

Nëse jeni shpesh të lodhur, edhe pse flini mjaft, ju mungon energjia për aktivitetet e përditshme dhe ndjeni ndryshime të shpeshta të humorit, është e mundshme që vuani nga anemia. Simptomat e tjera të shpeshta përfshijnë të ndjerit të dobët, marramendjen, tonin e zbehtë, qarkullimin e keq, rrahjet e shpejta të zemrës dhe ndaljen e frymës. Mënyra e vetme e diagnostikimit është analiza e pasqyrës së gjakut, veçanërisht e numrit të eritrociteve, nivelit të hemoglobinës, sasisë së hekurit dhe madhësisë së eritrociteve.

Anemia te fëmijët

Çdo i shtati fëmijë në moshën prej dy vjeç ka ndonjë formë të anemisë për shkak të hekurit të pamjaftueshëm në ushqim. Njerëzit me mungesë kronike të hekurit mund të ndjejnë nxitje të çuditshme të hanë

dhë, baltë ose akull. Nëse nuk trajtohen, format më serioze të anemisë mund të çrregullojnë zhvillimin e trurit te fëmijët.


Faktorët e rrezikut për anemi

Njerëzit me sëmundje kronike janë më të prirur për anemi. Femrat pas cikleve të rënda menstruale, po ashtu mund të bëhen anemike, ndërsa edhe shtatzania mund të shkaktojë ndryshime në gjak, të cilat rezultojnë me anemi. Derisa pagjakësia mund të krijohet për shkak të sasisë të vogël të acidit folik, hekurit ose vitaminës B në ushqim, disa lloje të anemisë janë trashëguese, theksojnë ekspertët.

Shërimi

Ushqimi i pasur me hekur është ndihma e parë për të sëmurët nga anemia, ndërsa zgjidhja më e shëndetshme janë qulli i tërshërës, fasulja, panxhari, perimet e gjelbra, mishi dhe çokollata e zezë.

Disa nga ilaçet natyrore përfshijnë konsumimin e çajit të koprës dhe rrënjës së rrikës. Pasi që hekuri në organizëm absorbohet më lehtë me ndihmën e vitaminës C, mos harroni që në ushqim të përfshini portokall, grejp, boronica dhe lakrën turshi. Gjithashtu, çaji, kafa, kakaoja dhe pijet me gaz nuk duhen konsumuar shumë, sepse përmbajnë "tanin", i cili parandalon absorbimin e hekurit që ndodhet në ushqim.



ZBULOHEK ANA E ERRËT E TRURIT

Neurologu gjerman, Dr. Gerhard Roth, pohon që duke hulumtuar kriminelët e dhunshëm ka gjetur shtresën në pjesën qendrore të trurit, e cila është përgjegjëse për sjelljen e keqe të njerëzve. Për këtë hulumtim ishte angazhuar nga qeveria gjermane.

Gjatë hulumtimit, kriminelëve u janë treguar filma të shkurtër dhe u janë matur valët e trurit. Dr. Roth është çuditur nga fakti se të anketuarit nuk shfaqën emocione gjatë skenave brutale, më saktësisht, asgjë nuk ka ndodhur në pjesët e trurit përgjegjëse për pikëllim, empati apo ndjeshmëri.



Ai ka konstatuar se në pjesën e poshtme të lobit ballor të kriminelëve gjithmonë ekziston ndonjë e metë, por po kështu nuk ekzistojnë dy kriminelë të njëjtë, kështu që i ka ndarë në tri grupe.

Grupi i parë, janë njerëz të shëndetshëm psikikë, të cilët janë rritur në mjedis ku kanë mësuar që është normale të vidhet, të rrihet apo të vritet dikush.

Grupi i dytë, janë personat e sëmurë psikikë, për të cilët e tërë bota është kërcënim, mjafton një lëvizje ose shikim i gabuar për t'u shndërruar në vrasës.


Në grupin e tretë hyjnë psikopatët totalë si Stalini dhe Hitleri.

ÇIPI MË I VOGËL 128 GBIT

Micron Technology ka prezatuar çipin më të vogël NAND 128 Gbit që përdor teknologjinë e procesimit 20 nanometër dhe grupon tre bite të dhënash për çdo qelizë të çipit.

Teknologjisë së çipave 3-bitësh i referohemi ndryshe si teknologjia e qelizës me 3 nivele TLC (Triple Level Cell), një medium ruajtjeje tepër kompakt, krahasuar me çipat e zakonshëm 2-bitësh apo çipat NAND me qeliza me shumë nivele. Çipi më i shtrenjtë, që siguron performancën më të lartë dhe është më i qëndrueshëm është ai që ndërtohet prej qelizash me një nivel të vetëm SLC (Single-Level Cell).

Çipi më i ri i Micron ka përmasat 12 mm x 12 mm, që do të thotë se është 25% më i vogël se pajisja NAND me të njëjtin kapacitet, por që shfrytëzon qelizat me shumë nivele



MLC (Multi-Level Cell). Pajisja TLC cilësohet si ekonomike përsa i përket çmimit, krahasuar me pajisjet e tjera ruajtëse portative, si kartat flash apo USB-të.

Micron po e teston pajisjen TLC NAND 128 Gbit me disa klientë të përzgjedhur. Prodhimi i saj do të fillojë në tremujorin e dytë të vitit 2013.

“Ky është çipi më i vogël i memories NAND por njëkohësisht me kapacitetin më të lartë, që po i jep jetë krijimit të një grupi të ri aplikacionesh që konsumojnë shumë memorie,” tha Glen Hawk, zv.president i Micron’s NAND Solution Group.


Micron do ta prezantojë produktin TLC NAND 128 Gbit në konferencën e ardhshme ndërkombëtare Solid-State Circuits, në datë 19 shkurt në San Francisco.

“GRAPHENE”: MATERIALI MË I FORTË I ZBULUAR DERI TANI

Harrojini diamantet, “Graphene” tani është materiali më i fortë në botë. Dhe të gjitha kompanitë zhvilluese duan me shumë gjasa ta marrin në duart e tyre.

Por Nokia duket se kryeson lojën në këtë garë për “Graphene”. Kompania finlandeze e telefonave njoftoi se ajo ishte një nga përfitueset e një shume prej 1.35 miliardë dollarëve nga Bashkimi Evropian për të bërë kërkime dhe zhvillime në këtë supermaterial gjatë 10 viteve të ardhshme.

“Nokia është krenare që të jetë e përfshirë në këtë projekt dhe ne kemi rrënjë të thella në këtë fushë. Kemi filluar punën me Graphene tashmë në 2006, tha CTO i Nokia-s Henry Tirri në një deklaratë. “Që atëherë, ne kemi ardhur për të identifikuar fushat e



shumta se ku ky material mund të aplikohet në mjediset informatike moderne. Ne kemi bërë disa punë shumë premtuese deri tani, por unë besoj se risitë më të mëdha janë ende për t’u zbuluar.”

Përveç të qenit substanca më e fortë në botë – 300 herë më e fortë se çeliku – Graphene ka të gjitha llojet e cilësive të tjera të vlefshme. Ajo është gjithashtu objekti më i hollë, i marrë ndonjëherë nga njeriu. Ajo është bërë nga një kristal 2D dhe duket pak si shirit ngjitës, vetëm pafundësisht i hollë dhe është gjithashtu transparente. Nëse Nokia është e suksesshme në zhvillimin e këtij materiali, do të jetë në gjendje për të ndërtuar telefonat celularë që janë jashtëzakonisht të lehtë, të qëndrueshëm dhe më pak të ndjeshëm ndaj mbixehjes.

TELEFONI TRANSPARENT NË FUND TË VITIT 2013

Kompania Polytron në Tajvan ka bërë një hap shumë të madh në zhvillimin e teknologjisë celulare, duke premtuar një celular transparent deri në fund të vitit 2013.

Kompania tashmë ka filluar marketingun e një transparenti shumë-prekësh. Kompania përdor atë që e quajnë teknologji Switchable Glass. Ky është një përçues OLED që përdor molekulat e kristalit likuid për të shfaqur imazhe.

Kur telefoni është i fikur, molekulat formojnë një formë si qumësht, por kur ai është i ndezur ato rikonstruktohen për të formuar tekst,



ikona dhe imazhe të tjera. Për krijimin e këtij telefoni janë përdorur telat transparentë. “Kjo do të ndodhë në fund të vitit 2013. Më besoni mua”, tha menaxheri i përgjithshëm i Polytron, Sam Yu.

Pajisja ka ende disa pjesë që nuk janë transparente, duke përfshirë këtu një kartë SD dhe kartë SIM. Mikrofon, kamera dhe bateria janë gjithashtu të dukshme dhe do të jenë të fshehura prapa një mbulose xhami të errët.

PAPA BENEDIKTI XVI JEP DORËHEQJEN

Romë, 11 shkurt 2013, në orën 11.44, gjatë koncistorit për kanonizimin e martirëve të Otrantos, Papa Benedikti XVI ka dhënë personalisht lajmin e dorëheqjes së tij më 28 shkurt. "Pasi kam shqyrtuar vazhdimisht ndërjegjen time përballë Zotit, kam arritur në përfundimin që forcat fizike, për shkak të moshës së shkuar, nuk janë të përshtatshme për të ushtruar detyrën në mënyrën e duhur", është shprehur ai në latinisht. "Jam i vetëdijshëm që kjo detyrë, për thelbin shpirtëror, duhet mbuluar jo vetëm me vepra e fjalë, por edhe me vuajtje e lutje. Megjithatë, në botën e sotme, që ndryshon me shpejtësi dhe është e trazuar nga çështje të rëndësishme për besimin fetar, për të qeverisur barkën e Shën Pietrit dhe për të dhënë Vangjelin, është e nevojshme edhe forca shpirtërore edhe ajo trupore, forcë që gjatë muajve të fundit, është reduktuar shumë tek unë, aq sa duhet të njoh paaftësinë në administrimin e mirë të detyrës që më është besuar".

"I vetëdijshëm për rëndësinë e aktit tim, me liri të plotë, deklaroi se heq dorë nga detyra e lëshkmit të Romës, Pausës i Shën Pietrit, që m'u besua nga Kardinalët më 19 prill 2005. Nga data 28 shkurt 2013, në orën 20.00, froni do të jetë bosh e do të nevojitet të thirret Konklava për zgjedhjen e Papës së ri", ka përfunduar Papa lajmërimin e tij, që brenda pak minutash ka zënë faqet e para të mediave në mbarë botën.

Joseph Ratzingeri, cili u ngjit në fronin e Shën Pietrit më 19 prill 2005, pas vdekjes së Papës Gjon Pali II, është Papa i 265-të në historinë e Kishës dhe pontifikati i tij, deri më 28 shkurt 2013 zgjat 2872 ditë.

Liderët fetarë dhe krerët e shteteve nëpër botë përshëndetën Benediktin XVI, pas dhënies së vendimit për dorëheqjen si kreu i Kishës Katolike

Presidenti italian Giorgio Napolitano u shpreh shumë i habitur nga vendimi i Papa Benediktit XVI për dorëheqjen e tij nga detyra e kreut të lartë të Kishës Katolike.

"Papa Benedikti XVI ka shfaqur një kurajë të madhe në publikimin e largimit dhe dorëheqjes së tij nga kryesimi i Kishës Katolike në fund të këtij muaji", u shpreh presidenti italian

pas marrjes së njoftimit mbi largimin e klerikut të lartë katolik.

"Është një njoftim pak tronditës", deklaroi kancelarja gjermane, Angela Merkel, në komentin e saj mbi vendimin e Papës, ku shtoi se "ky hap kishte ngjallur respektin e saj më të thellë ndaj klerikut të lartë".

Presidenti francez, Francois Hollande u shpreh se vendimi i Papës "ngjallte një respekt të thellë dhe ishte shumë njerëzor".

Kryeministri britanik, James Cameron, i uroi Papës një jetë të gjatë dhe e përshëndeti për përpjekjet e tij të palohura në forcimin e marrëdhënieve mes Britanisë dhe Kishës Katolike.

Obama: "Falënderimet dhe lutjet tona për Shenjtërinë e Tij. Në emër të amerikanëve kudo në botë, unë dhe bashkeshortja ime, Michelle, dëshirojmë të shprehim falënderimet dhe lutjet tona për Shenjtërinë e Tij, Papa Benedikti XVI", deklaroi Obama.

Kryeimami i myslimanëve sunitë, Ahmadel Tayyeb, u shpreh "i tronditur nga njoftimi", pas përfundimit të një takimi me dyer të mbyllura në Kajro, për zgjedhjen e Myftiut të Lartë të Egjiptit.

Kryerabini i Izraelit, Yona Metzger, përshëndeti Papën Ratzinger për arritjen e "marrëdhënieve më të mira mes Rabinatit të Izraelit dhe Kishës Katolike" dhe po ashtu i uroi një jetë të gjatë dhe shëndet të plotë.

Kardinali Keith O'Brien, kreu i Kishës Katolike Skoceze, deklaroi se ishte "i tronditur" dhe po ashtu shprehu "keqardhje duke u kërkuar të gjitha famullive në Skoci të luteshin për Joseph Ratzingerin në këto momente të vështira për të".



CARLA DEL PONTE: TË HETOHEN NGJARJET NË SIRI



Inspektorët për të drejtat e njeriut pranë Kombeve të Bashkuara kanë publikuar raportet në lidhje me krimet e bëra në Siri. Delegacioni i paruar ka bërë propozimin që krimet e bëra në Siri të trajtohen nga Gjykata Penale Ndërkombëtare.

Në raport shkruhet se edhe forcat ushtarake të Esadit edhe grupet opozitare kanë kryer krime lufte, por ato të kryera nga opozitarët nuk janë po aq intensive dhe të përhapura sa ato të kryera nga njësitë ush-

tarake të Esadit.

Në raport theksohej se në Siri janë bërë vrasje, tortura dhe se në popull është përhapur frika dhe terrori, ndërkohë që të gjitha këto krime kanë mbetur pa u dënuar. Në raport gjithashtu thuhej se në listë krahas atyre që e kanë kryer krimin zënë vend edhe ata që kanë kërkuar ekzekutimin e krimit, si dhe nga ata që kanë dhënë urdhër në këtë drejtim.

Për moslejimin që këto krime të mbeten pa u dënuar raportuesit kanë këshilluar trajtimin e menjëhershëm të këtyre krimeve në Gjykatën Penale Ndërkombëtare. Edhe Inspektorja Carla Del Ponte ka vënë në dukje se ngjarjet e përjetuara në Siri duhen shpënë në Gjykatën Penale Ndërkombëtare. Raporti në fjalë mbarë informacione të ngjarjeve të përjetuara në Siri rreth 6 muajve të fundit.